

1 E mërkurë, 10 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,
6 ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
13 procesverbalin që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
14 sallë.

15 Përpara se të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
16 Prokurorisë W04752, ka një çështje paraprake të cilën Trupi
17 Gjykses dëshiron ta trajtojë.

18 Trupi Gjykses ju kujton se më 24 maj 2024 i ka informuar
19 palët dhe pjesëmarrësit që do të lëshonte një vendim
20 procedural mbi kërkesën e ZPS-së për të ndryshuar listën e
21 provave materiale që është me numër F2279 dhe mbi kërkesën e
22 Mbrojtjes së Thaçit për përjashtimin e materialeve *in limine*,
23 që është parashtrimi i protokolluar numër F02312, pasi Trupi i
24 Gjykatës së Apelit të kishte nxjerrë vendimin e vet mbi
25 çështjet që rridhnin nga vendimi i Gjykatës të Vetëm që

1 autorizonte masat hetimore.

2 Trupi Gjykses vëren se Paneli i Gjykatës së Apelit e ka
3 nxjerrë vendimin e vet më 4 korrik 2024.

4 Trupi Gjykses ju kujton se Mbrojtja e Selimit, Mbrojtja e
5 Krasniqit, Mbrojtja e Veselit kanë kërkuar një parashikim të
6 seancave informuese, përcaktuar, pra, seanca informuese për të
7 bërë parashtrimin sipas rregullës 138 në lidhje me materialin
8 në fjalë dhe me kërkesën e ZPS-së dhe me kërkesën e Mbrojtjes
9 së Thaçit.

10 Nëse Mbrojtja dëshiron që të parashtrijë parashtrimet e
11 veta lidhur me këtë vendim të Gjykatës së Apelit, Mbrojtja
12 urdhërohet që ta bëjë këtë jo më vonë se 16 korriku 2024. Çdo
13 përgjigje ndaj këtyre parashtrimeve duhet të bëhet nga ZPS-ja
14 më vonë se 22 korriku 2024 dhe kundërpërgjigjet e tjera nuk do
15 të pranohen.

16 Këtu mbyllet ky urdhër gojarisht.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, për një
18 sqarim, kjo përfshin edhe Mbrojtjen e Thaçit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, një
22 përditësim mbi kohën. Mendojmë që do të përfundojmë në një
23 moment gjatë gjysmës së dytë të seancës së dytë pak para
24 pushimit të drekës. Të shohim se si do shkojmë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

1 për përditësimin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
4 z. Zyrapi.

5 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj
7 edhe një herë që të përpiqeni t'u jepni përgjigje të shkurtra
8 pyetjeve. Nëse se kuptoni pyetjen, lirisht mund të kërkon
9 Avokatit që t'ua përsërisë pyetjen ose kërkon sqarime. Ju
10 lutem na sqaroni eshë bazën e dijenisë, fakteve dhe rrethanave
11 për të cilat do t'ju bëhen pyetje.

12 Ju lutem flisni afër me mikrofonin dhe prisni pesë
13 sekonda përpara se t'ju përgjigjeni pyetjes dhe flisni ngadalë
14 në mënyrë që përkthyesit të mund t'ju arrijnë.

15 Nëse keni nevojë për pushime, na e bëni me dije këtë dhe
16 do t'ju plotësohet kjo nevojë.

17 Ju rikujtoj se jeni ende nën detyrim për të thënë të
18 vërtetën siç keni thënë në betimin tuaj solemn. Ju rikujtoj
19 edhe një herë se nuk jeni të detyruar t'u përgjigjeni me
20 doemos një pyetjeje e cila ju fajëson me përjashtim të rasteve
21 kur Trupi Gjykses ju detyron që t'ju përgjigjeni asaj
22 pyetjeje, nëse lind një pyetje e tillë apo një çështje e
23 tillë, ju apo Avokati Kujdestar i juaji mund ta paraqisni këtë
24 çështje para Trupit Gjykses dhe pastaj Trupi Gjykses merr një
25 vendim lidhur me këtë.

1 Tani do të vijojmë me pyetje që do jua bëj Avokati i
2 Mbrojtjes së z. Selimi.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

4 DËSHMITARI: Bislime Zyrapi [Vijon]

5 Pyetjet të palës tjetër nga z. Roberts:

6 [Vazhdim]

7 Z. ROBERTS: [Përkthim]

8 PY. Mirëmëngjesi, z. Zyrapi. Shpresoj të keni pushuar mirë.

9 PË. Mirëmëngjesi. Po, faleminderit.

10 PY. Dëshiroj të kalojmë tani në Rahovec. Ju kujtohet që po
11 flisnim për Rahovecin. Ju keni folur gjerësisht për Rahovecin
12 në intervistën tuaj me ZPS-në besoj?

13 PË. Po.

14 PY. Keni qenë në Jabllanicë në momentin kur dëgjuat për
15 shpërthimin e këtyre luftimeve, apo në zonën e dukagjinit për
16 të qenë më konkret?

17 PË. Më konkret kam qenë në zonën e Dukagjinit, faktikisht në
18 territorin e Rekës kam qenë.

19 PY. Ju ka informuar për këto luftime Lahi Brahimaj, apo jo?

20 PË. Po. Lahi Brahimaj ka qenë që më ka marrë nga Jabllanica
21 për të më dërgue deri në Rahovec.

22 PY. Kjo ngaqë ishit në zonën prej së cilës vinte ai, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Sapo kishit marrë detyrën e shefit të drejtorisë së
25 operacioneve aso kohe dhe siç na thatë dhe ju deshën pak a

1 shumë dy ditë për t'ju afruar Rahovecit, kështu mund të themi?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe kjo për shkak të vështirësive për të anashkaluar
4 forcat serbe në atë zonë? Sepse nuk është ndonjë farë distance
5 e madhe kështu drejtpërdrejtë të themi?

6 PY. Domethënë, distanca nuk është e madhe. Po ishte në pjesë
7 e ndërprerë, nuk kishte kontrollin e UÇK-së të gjithë. Dhe u
8 duhke të kishim kujdes gjatë kalimit se kishte dhe forca
9 serbe.

10 PY. Po. Dhe sot, një udhëtim i tillë mund të zgjasë nja dy
11 orë mbase dhe më pak se dy orë?

12 PË. Po.

13 PY. Kur keni mbërrit, më duket i keni thënë ZPS-së, kur keni
14 mbërrit gjithçka kishte përfunduar në Rahovec. Është në
15 intervistën tuaj faqe 22, Pjesa e dytë e saj. Kështu?

16 PY. Po, kështu është.

17 PY. Keni dëgjuar se kishte luftime në Opterushë, por ju ishit
18 në një zonë tjetër aso kohe?

19 PË. Po në atë kohë unë isha, veç kur mbërri, isha në pjesën e
20 Rahovecit ose, domethënë, faktikisht në pjesën rrugës së
21 Rahovecit në Malishevë, kurse ajo ka ndodhë në anën tjetër.
22 Nuk e kam ditur menjëheri që ka ndodhur në atë drejtim se
23 meqenëse veç ishim në këtë pjesë duke formue vijën mbrojtëse
24 prej Rahovecit në drejtim të Malishevës. Dhe kështu që nuk
25 kishim kohë që të mendojmë për veprime tjera.

1 PY. Për të qenë të qartë ju Opterushës ju afruat jo më shumë
2 sesa dhjetë kilometra, nëse mund ta them kështu?

3 PË. Ne jo dhe më tepër pak.

4 PY. Ju jeni shumë i qartë në intervistën që i keni dhënë ZPS-
5 së se luftimet e Rahovecit -- për luftimet e Rahovecit nuk
6 është folur me ju paraprakisht? Është në Pjesën e Dytë të
7 intervistës tuaj me ZPS-në faqe 28.

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Dhe e njëjta vlen, me aq sa keni dijeni dhe, pra, për z.
10 Selimi, pra, as z. Selimi nuk kishe dijeni përpara këtyre
11 luftimeve, përpara fillimit të tyre?

12 PË. Po, saktë.

13 PY. I keni konfirmuar ZPS-së se janë bërë disa diskutime
14 përpara Rahovecit lidhur me mundësinë teorike të kryerjes së
15 një sulmi, kundër një sulmi nga forcat e UÇK-së por natyra dhe
16 objekti i këtyre diskutimeve nuk janë të qarta.

17 Po mesa e kuptoj unë këto diskutime teorike i keni bërë
18 brenda drejtorisë operative si pjesë e punës normale që
19 kryenit aty, apo jo?

20 PË. Po. Bisedime të tilla gjithnjë drejtoria operative i
21 shqyrton mundësitë si të Mbrojtjes dhe të sulmit normalisht që
22 drejtoria dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës caki i saj ka qenë
23 lirimi i territorit të Kosovës, kështu që edhe në këtë drejtim
24 është biseduar që të mendohet dhe të përgatiten njësitë derisa
25 të operacionizohen për këto veprime.

1 PY. Pra, një diskutim rutinë në të cilin mund të
2 shqyrtoheshin mundësi të ndryshme për një moment të caktuar të
3 së ardhmes, mund ta them kështu?

4 PË. Po. Jo vetëm ato po edhe veprime tjera.

5 PY. Sigurisht. Për të qenë të qartë, çdo plan konkret lidhur
6 me një qytet apo fshat të caktuar do të duhej që të merrte në
7 konsideratë shumë faktorë të tjerë të veçantë konkretë për atë
8 qytet, të themi siç është sasia e forcave kundërshtare që janë
9 të pranishme në atë qytet a zonë?

10 PË. Po. Kur marrim një operacion të tillë, po e shpjegoj në
11 pika të shkurtra, përveç asaj që merren forcat kundërshtare të
12 cilat janë në atë territor ose në atë fshat ose në atë qytet
13 llogariten forcat tua të cilat i ke, teknikën të cilën ke,
14 popullata cila është, mundësia e komunikimit, furnizimit dhe
15 mundësinë e kryerjes së detyrës operative të cilën i jep që sa
16 më pak me pasun në dëme gjatë këtij operacioni. Këto janë në
17 pika të shkurtra kur mirret ose mendohet për një operacion a
18 është mbrojtës apo është sulm.

19 PY. Po. Dhe kjo përfshin edhe topografinë e terrenit, mund të
20 jetë kodër, mund të jetë luginë, mund të jenë faktorë -- ka
21 shumë faktorë të ndryshëm të cilët janë të veçantë për një
22 vendndodhje të caktuar nëpër të cilën planifikohet zhvillimi i
23 një operacioni, apo jo?

24 PË. Po, saktë. Nuk është vetëm topografia, është pjesë edhe
25 klimës dhe ajo hynë pjesë e përgatitjes operationale se çfarë

1 klime është si duhet të mundësohen veprimet. Kështu që janë të
2 gjitha këto. Unë e thashë veç në pika të shkurtra të cilat
3 përfshijnë këto operacione.

4 PY. Çdo diskutim i përgjithshëm që mund të keni zhvilluar
5 lidhur me mundësinë teorike të fillimit të operacioneve ishte
6 shumë larg zhvillimit faktik të një operacioni aso kohe, a nuk
7 është kështu?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm apo të
10 drejtorisë operative i kishin të gjithë të së njëjtës
11 pikëpamje që kjo nuk ishte diçka të cilën UÇK-ja ishte në
12 gjendje ta bënte aso kohe?

13 PË. Po. E kam folur në bisedat që keni bë me drejtorinë
14 operative në atë kohë, ishte i njëjti mendim, njësitë nuk janë
15 hala të gatshme operative për këto veprime dhe duhet të
16 punohet në këtë drejtim.

17 PY. Ishte edhe mendimi i Selimit ky? A ju kujtohet?

18 PË. Po edhe i z. Selimi, z. Bashota, i imi, Agimit. Ne që
19 ishim në këtë drejtori, që punojshim së bashku.

20 PY. Kur thoni Agimi, besoj e keni fjalën për z. Qelaj?

21 PË. Po, po. Më falni.

22 PY. Faleminderit. Kur keni shkuar në Rahovec ju është thënë
23 nga shtabi lokal, njësitë e shtabit lokal se luftimet nuk
24 ishin filluar nga Shtabi i Përgjithshëm por ishin filluar nga
25 vetë shtabet lokale. Kjo është në ajo çka i keni thënë ZPS-së

1 në faqen 31 dhe ajo që është në provën materiale P1355.2, në
2 Pjesën e Dytë të intervistës tuaj. A nuk është kështu?
3 PË. Saktë, kështu është.

4 PY. Dhe e keni shpjeguar kështu si në vijim. Pra, që kështu
5 ju kanë thënë shtabet lokale se:

6 "Aksionet fillestare janë marrë ndërmarrë nga shtabi
7 lokal i Rahovecit. Zëvendëskomandant i këtij shtabi ishte një
8 person i quajtur me emrin 'Piktori', po emrin e vërtetë e
9 kishte Gëzim Muhabazi ... nuk më kujtohet mirë mbiemri tani.
10 Këtë më duket se ma kanë, pra, siç ma shpjeguan nga komanda ai
11 kishte hyrë me një grup ushtarësh në Rahovec për të vizituar
12 familjen apo të afërm. Janë zbulu nga forcat serbe të cilat
13 ishin në qytet i kanë rrethu. Dhe pastaj forcat e tjera të
14 shtabit lokal të Rahovecit morën pjesë në luftime. Po pastaj
15 këto luftime janë zgjeruar dhe kërkuan ndihmë nga njësite
16 tjera."

17 A ka pas ndonjë arsye për të dyshuar vërtetësinë e këtyre
18 fjalëve që ai jua ka thënë juve?

19 PË. Nga aspekti jem nuk kam mujt të dyshoj. Se unë kam pyet
20 komandën dhe manej kësej shtabit lokal që kanë qenë së bashku
21 me të, pastaj edhe këto kam vërtetu në bazë saj, këtyne
22 bisedave të këtyne kolegëve tjerë të këtij shtabi. Dhe kështu
23 që nuk dyshoj në të.

24 PY. Pra, ishte po e njëjta që ua kanë thënë të gjithëve që
25 kjo ishte arsyeja, që kështu kishte filluar ky luftim?

1 PË. Po, kështu ka fillu, kështu më kanë shpjegue anëtarët e
2 shtabit lokal të Rahovecit.

3 PY. Dhe gjatë këtyre 26 vjetëve thuajse prej atëherë, nuk
4 keni dëgjuar ndonjë informacion tjetër i cili do të binte
5 ndesh me këtë që jua kanë thënë?

6 PË. Po deri sa kam bisedu dhe të cilët janë gjallë të asaj
7 komande ende sot, të njëjta fjalë mi thonë, nuk më thonë diçka
8 ndryshe ose na një shpjegim ndryshe.

9 PY. Faleminderit. ZPS-së i keni thënë se kur keni mbërrit z.
10 Bashota ju informoi për ndihmën që Shtabi i Përgjithshëm ju
11 kishte kërkuar njësisive lokale, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, Shtabi i Përgjithshëm po kërkonte ndihmë njësisive
14 lokale, nuk është se po ju jepte urdhër njësisive lokale që të
15 bënte diçka?

16 PË. Po, në ato momente, ashtu është se ka kërkuar ndihmë nga
17 njësi tjera.

18 PY. Dhe ju i keni shpjeguar ZPS-së se z. Bashota ju ka
19 informuar për lëvizjen e popullatës civile. Që të jemi të
20 qartë, këta janë shqiptarë të Kosovës të cilët po dëboheshin -
21 - jo, që ishin të detyruar ta lëshonin Rahovecin për shkak të
22 granatimit nga artileria serbe, kështu?

23 PË. Po, kështu është.

24 PY. Dhe rezultati i kësaj është përshkruar edhe nga një
25 dëshmitar tjetër që ngjan me Vukovarin në luftën kroate.

1 Përputhet edhe kjo me atë çfarë ju kujtohet apo çka keni

2 dijeni se ka ndodhur në Rahovec?

3 PË. Po më kujtohet mirë edhe ndodhitë në Rahovec. Nuk mund të
4 them bash si Vukovari, se Vukovari është rrafshuar totalisht
5 si qytet, kurse Rahoveci ka pas dëme të mëdhaja. Është çka i
6 përket dëbimit, po, ose largimit të popullatës nga shtëpitë e
7 veta.

8 PY. Për të qenë i qartë, ishte një granatim shumë i
9 gjerësishëm serb kundër Rahovecit që e detyroi popullatën
10 shqiptare të Kosovës që ta lëshonte Rahovecin për shkak të
11 këtij zjarri artilerie, nëse mund ta them kështu?

12 PË. Po dhe zjarrit të artilerisë, po dhe sulmit të
13 këmbësorisë që e bënte forcat serbe në atë kohë.

14 PY. Pra, kishte forca serbe në terren në Rahovec?

15 PË. Po, jo pak po goxha shumë. kanë pas aty që kanë qenë të
16 Rahovecit dhe ato që kanë ardhë nga vende tjera, nga drejtime
17 tjera për t'i krye sulmin në Rahovec.

18 PY. Keni një dijeni kështu përafërsisht sesa forca serbi
19 ndodheshin në atë moment apo është e vështirë për të pasur një
20 vlerësim të tillë?

21 PË. Me qenë bash saktë nuk mundem m'i i bësh ato se lëviznin
22 në atë kohë. Përafërsisht ajo vetëm brenda për brenda para se
23 të fillon kjo i ka pasun diku afër 1.000 trupa brenda
24 Rahovecit afërsisht si komunë të armatosur njerëz. Dhe veprime
25 tjera të cilat njësitë kanë ardhur nga drejtimi i Gjakovës dhe

1 nga drejtimi i Prizrenit diku llogaritet që janë ata dhe kanë
2 ardhë dhe nja 1.000 tjera, domethënë, në përgjithësi janë kanë
3 2.000 trupa përafërsisht kanë qenë në drejtim të sulmit me
4 armë të tyre dhe përcjellun të artilerisë së rëndë ose armëve
5 të rënda që kanë përdorur në atë kohë.

6 PY. Keni shpjeguar se kur jeni takuar me z. Selimi rreth
7 Rahovecit apo brenda në Rahovec keni thënë se ai ju ka
8 informuar -- më falni, jo. Do ta them ndryshe pyetjen.

9 Keni shpjeguar se kur e patë z. Selimi, ai dhe z. Bashota
10 po ndihmonin në ngritjen e vijave të mbrojtjes, kështu?

11 PË. Po, kështu.

12 PY. Dhe më duket se keni thënë se ai ju ka informuar për këtë
13 se çfarë po bënin, çfarë po përpiqeshin të bënin në
14 bashkëpunim me njësitë lokale, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe kjo përputhet me rolin, siç shpjeguat ju, kishte z.
17 Selimi, po kryente z. Selimi së bashku me ju, ato gjashtë javë
18 të fundit pas mbërritjes suaj në Kosovë, pra, kjo që po
19 përpiqeshit që me i ndihmu këto njësi lokale për të ngritur
20 vijat e mbrojtjes, masat e mbrojtjes çfarëdolloj të ishin ato?

21 PË. Po.

22 PY. ZPS-së i keni thënë se ky aksion është kryer në këtë
23 mënyrë. Është Pjesa e Dytë e intervistës suaj në faqen 32,
24 pra, P1355.2. Pyetja që është bërë, pra:

25 "PY. Po i jepnit urdhra njësive lokale për të

1 bashkërenduar përpjekjet për mbrojtje?"

2 Përgjigja juaj ka qenë kjo:

3 "Po. Kishte njësi të ndryshme të cilat kishin ndihmuar.

4 Unë i kam ngarkuar detyrën për të shkuar në pjesë të ndryshme
5 të vijës së mbrojtjes. Dhe pasi i kam caktuar në këto vende të
6 ndryshme dhe i kam vënë që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën
7 operacioni, pastaj -- operacionin e mori përsipër komandanti i
8 zonës. Dhe arsyeja për këtë ishte se kishte dhe sulme të tjera
9 në territore të tjera kështu që duhet të shkoja dhe të
10 ndihmoja dhe komandantë të tjerë."

11 Ju kujtohet që ia keni thënë këtë ZPS-së?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, njësitë lokale ju kanë kërkuar ndihmë, juve jepnit
14 ndihmë dhe udhëzime dhe pastaj pak kohë pas kësaj e merrte
15 përsipër detyrën komandanti i zonës. Në këtë rast komandanti
16 zonë s ka qenë Musë Jashari apo dikush tjetër?

17 PË. Po, në këtë rast ka qenë komandant zone Musë Jashari.

18 PY. Sa kohë keni qëndruar në rrethinat e Rahovecit përpara se
19 të shkonit në territore tjera për të ndihmu komandantët e
20 atyre territoreve tjera, nëse ju kujtohet?

21 PY. S'muj me bash saktë ditë, po disa ditë kemi qenë aty
22 derisa kemi forcu vijën e mbrojtjes. Dhe derisa kemi,
23 faktikisht, tani kemi pas edhe katër apo pesë sulme të forcave
24 serbe që kanë tentu të depërtojnë këtë vijë fronti. Po muj me
25 thënë që nja katër ditë apo pesë të mira kemi qenë, mos edhe

1 më tepër.

2 PY. Gjatë intervistës suaj me ZPS-në ju ka treguar një raport
3 që pretendohet që e ka përgatitur Agim Çeku - më falni - Agim
4 Kuqi, kërkoj ndjesë, Agim Kuqi i datës 21 korrik 1999. Ju
5 kujtohet ky dokument?

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do ta nxjerrin në ekran është për
7 Sekretarinë, me numër U001-7877.

8 PY. Ta shohim në ekran në mënyrë që të familjarizoheni me
9 dokumentin.

10 Që të jemi të qartë, besoj se e keni konfirmuar në
11 intervistën tuaj me ZPS-në se nuk e kishit parë kurrë këtë
12 dokument më përpara, apo jo?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Në rreshtin e parë të dokumentin thuhet se:

15 "Më 20 korrik të vitit 1998 në orën 23.00, komandanti i
16 shtabit lokal të UÇK-së, Blerim Kuqi, me urdhër të Shtabit të
17 Përgjithshëm të UÇK-së, dha urdhër që të sulmohen fshatrat
18 Zaqishtë dhe Hoqë", ju kërkoj ndjesë për shqiptimin në qoftë
19 se s'e kam të saktë "të banuara me popullatë serbe".

20 Dhe ju kanë treguar në intervistë pikërisht këtë rresht
21 të parë dhe ju keni thënë kështu ZPS-së:

22 "Duhet ta pyesni atë për këtë sepse ... këtë s'e ka
23 diskutu me mu. Nuk ka kërku asgjë. Nuk e kam pas këtë
24 informacion aso kohe."

25 Që të jemi të qartë, ju po thoni se nuk i keni dhënë

1 urdhër që të sulmojë këto fshatra?

2 PË. Jo.

3 PY. Dhe askush tjetër nga Shtabi i Përgjithshëm për të cilën
4 ju keni dijeni nuk i ka dhënë një urdhër po kështu për këtë
5 gjë? Edhe kjo është e vërtetë?

6 PË. Ça kam unë dijeni, anëtarët e shtabit në atë kohë, do që
7 i kam pas afër, do s'i kam pas, kanë qenë dhe në territore
8 tjera, nuk e besoj që kanë mujt t'i jep dikush urdhër këtij
9 zotëriut që të bën sulme në këto fshatra, se po të ishte një
10 pi anëtarëve të shtabit do ta dijsa dhe unë. Qëta që e kanë
11 pas ngatë atyne, që ka qenë edhe Sokoli edhe Rexhepi kanë
12 qenë, po asnjëri prej tyre nuk ka dhënë urdhër, me dijeninë
13 time të asaj kohe.

14 PY. Faleminderit. Dhe rreshti i parë, në fakt, nuk na jep as
15 datën, as numrin, as përmbajtjen e asnjë informacion tjetër
16 për këtë urdhër të supozuar? Është e përgjithshme fraza nëse
17 mund ta them kështu?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. ZPS-së i keni thënë se nuk e dinit që ishin kapur civilë
20 serbë gjatë kësaj kohe sepse keni qenë në vijën e frontit dhe
21 nuk keni pasur kohë që t'i shikoni këto gjëra sepse ju është
22 dashur që të shkonit edhe në zona të tjera sikurse dhe në sapa
23 na e thatë dhe që e keni marrë vesh lidhur me këtë shumë më
24 vonë, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po, shumë e saktë.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Roberts, për cilën pjesë,
2 për çfarë faqe po flisni për intervistën e ZPS-së?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është faqja 3 e intervistës së
4 ZPS-së, domethënë, është prova materiale P1355.3, faqja 12.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në qoftë se doni mund t'jua lexoj.
7 Nuk është problem.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jo, është në rregull me kaq.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim]
10 PY. Tani që ta kuptoj drejt, nga këto vija fronti ju thoni,
11 pra, dëshmia juaj është që ju nuk do kishit mundësi që të
12 merrnit informacion edhe në qoftë se do të kapeshin të
13 burgosur ose në qoftë se do merreshin civilë, këtë po thoni,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, për atë kohë shumë të kjartë. Se nuk kemi pas kesi
16 lloj informacioni.

17 PY. Kjo është në pajtim me atë se çfarë na thatë ju dje,
18 domethënë, kjo është ajo çfarë na thatë dje që drejtorja
19 operative e operacioneve nuk është se kishte ndonjë rol ose
20 nuk kryente ndonjë funksion sa i takon të burgosurve dhe
21 ndalimeve gjatë operacioneve, kështu, Dëshmitar?

22 PË. Po, po, saktë.

23 PY. A është në përputhje kjo me njohuritë tuaja apo me
24 përvojën tuaj lidhur me z. Selimi, që z. Selimi i pëlqente më
25 shumë që të ishte në vijën e frontit gjatë konfliktit, apo jo?

1 PË. Po gjatë asaj kohës, sa ka qenë me mue, tanë kohën ka
2 qenë vetëm në front dhe çdo herë ka qenë te vija e frontit, ku
3 pas nevojë të ndihmohet normalisht.

4 PY. Kur i keni konfirmuar ZPS-së rrëmbimin e civilëve, që
5 rrëmbimi i civilëve mund të ishte njohuri e përgjithshme në
6 zonë dhe këtu i referohem konkretisht Pjesës 3 të intervistës
7 që i keni dhënë ZPS-së në faqen 13, do të lexoj citimin në
8 mënyrë që të dini ekzaktësisht se çfarë është thënë:

9 "PY. A është e drejtë të thuhet që rrëmbimi i dhjetëra
10 civilëve edhe zhdukja e tyre do të ishte diçka që dihej
11 gjerësisht në zonë?"

12 Përgjigja juaj është:

13 "... po."

14 Pyetja e parë që kam për juve është kjo, Dëshmitar: A ju
15 kujtohet t'ia keni thënë këtë ZPS-së?

16 PË. Po, normalisht e kam thënë.

17 PY. A kuptoj drejt që qëllimi ishte, domethënë, në përgjigjen
18 tuaj ju e keni fjalën që personat në zonën e Rahovecit kishin
19 njohuri dhe nuk e keni fjalën për Kosovën në përgjithësi kur e
20 jepni këtë përgjigje, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po pyetja ishte për konkret për q'atë kohë dhe q'atë
22 moment, jo për territorin e Kosovës në tërësi.

23 PY. I keni thënë ZPS-së që ju nuk keni pas dijeni në qoftë se
24 ka pasur përpjekje nga Shtabi i Përgjithshëm për të vendosur
25 në qoftë se ishin marrë të burgosurit e çfarë ju kishte

1 ndodhur atyre? A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, saktë. Ashtu kam thënë.

3 PY. Po ashtu ju i keni thënë më në përgjithësi ZPS-së i keni
4 treguar se çfarë detyrimesh kishte Shtabi i Përgjithshëm në
5 qoftë se ata do të merrnin informacion lidhur me marrjen ose
6 kapjen e civilëve. Më konkretisht kjo jepet në Pjesën 3 të
7 intervistës tuaj në faqen 16. Dëshmia juaj dhe për
8 procesverbal do t'jua lexoj.

9 "PY. Dhe ju thatë që ishin komandantët që merrnin vendim
10 në qoftë se do të kapeshin ose duhet të merreshin civilë apo
11 jo dhe çfarë ju ndodhte atyre më pas. A e kuptova siç duhet
12 këtë gjë?

13 "PË. Po, komandanti i zonës konkrete.

14 "PY. Dhe kujt i raportonin ata, kujt i jepnin llogari
15 ata?

16 "PË. Shtabit Qendror në atë kohë.

17 "PY. Dhe në qoftë se Shtabi i Përgjithshëm do merrte një
18 raport që thoshte që ishin kapur civilë, por nuk jepnin
19 informacion lidhur me fatin e këtyre personave, çfarë
20 përgjegjësie do kishte në këtë pikë Shtabi i Përgjithshëm?

21 "PË. Ata nuk kanë marrë asnjë dhe përgjegjësia i takonte
22 personit konkret që e kishte bërë këtë akt dhe në qoftë se
23 Shtabi i Përgjithshëm informohej dhe nuk kishte bërë asgjë
24 lidhur me këtë, ata duhet të jepnin një shpjegim se pse kishte
25 ndodhur kjo."

1 E di që citimi ishte goxha i gjatë, Dëshmitar, por do të
2 doja të na thonit në qoftë se i keni thënë këtë gjë ZPS-së,
3 është kjo dëshmia juaj dhe a i qëndroni kësaj dëshmie,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, plotësisht.

6 PY. Pra, dëshmia juaj është që ishte përgjegjësi ekskluzive e
7 komandantëve të zonës për të vendosur në qoftë se do të
8 merreshin civilë, apo jo, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po, në atë kohë q'ashtu ka qenë.

10 PY. Në qoftë se komandanti i zonës do ishte njoftuar se ishin
11 kapur civilë, domethënë, supozohej që komandanti i zonës t'i
12 raportonte Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

13 PË. Saktë. Po.

14 PY. Megjithatë brenda shtabit qendror ju varësit tërësisht
15 nga informacioni që iu jepte komandanti i zonës, domethënë, në
16 qoftë se komandanti i zonës ua raportonte këtë informacion apo
17 jo, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, e vërtetë është.

19 PY. Në qoftë se komandanti i zonës nuk merrte informacion nga
20 brigada e vet ose nga njësitë lokale sepse bëhet fjalë për
21 korrikun, pra, që ishin marrë civilë, atëherë nuk është se do
22 kishte ndonjë informacion të madh komandanti i zonës që t'i
23 raportonte shtabit qendror, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po, saktë është.

25 PY. Pra, dëshmia juaj që shtabi qendror duhej që t'i jepte

1 një shpjegim është e vërtetë vetëm në qoftë se informacioni i
2 jepej komandantit të zonës dhe në qoftë se në nivel të dytë
3 komandanti zonës i jepte Shtabit të Përgjithshëm dhe në qoftë
4 se nuk do ishte bërë asgjë. Domethënë, vetëm në këto rrethana
5 konkrete është i vlefshëm kjo përgjigje që keni dhënë ju, apo
6 jo, Dëshmitar?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Ju jeni shumë i qartë. Që mesa dini ju, nuk ju është
9 dhënë asnjë raport për mbajtjen e të burgosurve ose në atë
10 fazë ose më vonë, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po. As mue, po as nuk di që ia ka dhënë dhe dikujt ndonjë
12 anëtar të shtabit ose drejtorisë operative.

13 PY. Pas sulmit dhe pasojave negative të tij, juve iu kërkua,
14 juve ju bënë pyetje lidhur me një hetim sa i takon
15 përgjegjësisë lidhur me të. Dhe ju e shpjegoni në faqen 3 të
16 intervistës që i keni dhënë ZPS-së, që është në provën
17 materiale P1355.3, faqja 17 dhe keni thënë si më poshtë:

18 "Pozita ime ishte e tillë që unë kam qenë thjesht i
19 përfshirë për trajnimet dhe në aspektet operative. Nga ana
20 tjetër ka pasur persona të tjerë të cilët duhet të kishin
21 kryer hetime, por unë nuk e di se deri në çfarë mase anëtarët
22 e Shtabit të Përgjithshëm duhet të kenë qenë në gjendje për të
23 bërë hetime në atë kohë".

24 A ju kujtohet që t'ia keni thënë këtë ZPS-së dhe a i
25 qëndroni kësaj deklaratë sërish, Dëshmitar?

1 PË. Po, plotësisht.

2 PY. Pse thoni ju që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm nuk do
3 kenë pasur mundësi që të bëjnë hetime në atë kohë? Po flasim
4 këtu për korrikun dhe gushtin e 1998, pse e thoni këtë gjë,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po e them për arsye se edhe gjatë shpjegimit sesi ka qenë
7 e zhvilluar në atë kohë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe
8 Shtabi i Përgjithshëm, nuk ka pas mundësi as resurse as
9 sektorë të cilat ka mund të mirret me këto çështje. Me këto
10 çështje u dasht të ketë sektori juridik që në atë kohë hiç
11 fare nuk ka ekzistuar. Dhe të mund të hulumtohen ose të hetohen
12 këto rastet. Kështu që e pamundur ka qenë që të punohet në
13 këtë drejtim me hetime nga Shtabi i Përgjithshëm. Jo vetëm nga
14 Shtabi i Përgjithshëm, po dhe më poshtë te zonat nuk ka pas të
15 zhvilluar këto sektorë.

16 PY. Pra, ata nuk është se i kanë pasur as strukturat për të
17 bërë hetime, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Jo, as struktura. As struktura e shtabit s'ka qenë si
19 duhet, e le më struktura e hetimeve që thosh në atë kohë.

20 PY. E kuptojmë që ju jeni nisur për në Shqipëri nga mesi i
21 shtatorit dhe keni qëndruar aty deri nga mesi i nëntorit duke
22 u kthyer nga mesi i nëntorit, nga 12 nëntori. Mesa dini ju, a
23 ka pasur takime të Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë, ndërkohë
24 që ju nuk keni qenë në Kosovë, apo ju nuk keni njohuri lidhur
25 me këtë?

1 PË. Jo, nuk kam njohuri me atë.

2 PY. Megjithatë, po në Shqipëri, meqenëse ra fjala, keni pasur
3 takime të Shtabit të Përgjithshëm gjatë kësaj periudhe?

4 PË. Po aty s'kemi pas nevojë. Unë çdo herë jam kanë me
5 komandantin e përgjithshëm tanë kohën. Gjithçka që u dasht
6 është marrë me njeri drejtpërdrejt. Kështu që gjatë kohës sa
7 kam nejt në Shqipëri. Se reni mbasi kam dal në Shqipëri në
8 shtator, pak kam ndejt unë aty dhe kam dal jashtë në perëndim.
9 Dhe kur jam kthyer diku nga pjesa e dytë e tetorit kur kemi
10 fillu pastaj edhe bisedimet mes qeverisë së Bukoshit dhe ne.

11 PY. Në atë kohë këtu ka qenë vëmendja kryesore, apo jo? Tani
12 për të qenë të qartë, nuk është se ka pasur ndonjë bisedë me
13 ty lidhur me Rahovecin dhe me të burgosurit që ishin kapur në
14 Rahovec, që mbaheshin në Rahovec, a është e vërtetë kjo,
15 Dëshmitar?

16 PË. Sa më kujtohet mue, jo, fare.

17 PY. Tani, dëshiroj të kaloj në një temë tjetër në temën e
18 inspektorit të përgjithshëm dhe emërimin dhe rolin e z. Selimi
19 në atë pozitë. Lidhur me këtë ju bënë pyetje nga ZPS-ja lidhur
20 me rolin e z. Selimi si inspektor i përgjithshëm i UÇK-së.

21 Pikë së pari, ju bëhet pyetja nga ZPS-ja se kur e morët
22 rolin juve si shef i departamentit operativ dhe ju thatë që
23 këtë rol e keni marrë nga mesi i korrikut. Është e qartë se
24 nuk ka pasur pozicion të inspektorit të përgjithshëm në UÇK
25 përpara sesa të merrej ky rol nga z. Selimi, a është e vërtetë

1 kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. E kam të saktë që z. Selimi e ka marrë këtë rol diku pasi
4 ju morët rolin e Bashotës si shef i drejtorisë operative nga
5 mesi i korrikut. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Pikë të parit, kur e kam marrë unë detyrën nga z.
7 Bashota, këtë rolin e inspektorit nuk e di se nuk ka pas
8 strukturë ma atëherë. Ndoshta a kanë dhe nuk e kam njoft atë
9 strukturë ça ka qenë më herët dhe s'di në cilën detyrë e ka
10 marrë pastaj. Po e di që prej korrikut në këtë kohë ka qenë së
11 bashku me mu që më kanë ndihmuar për t'u njoftuar me njësitë
12 lokale dhe normalisht gjatë veprimit dhe operacioneve se s'ka
13 pas mundësi tjetër veprimi të bahet.

14 Se veç sulmet kanë fillu nga mesi i korrikut. E deri
15 thuaje kur kam dalë unë kemi pas sulme tanë kohën, në çdo herë
16 jam kanë në vijat e frontit, kështu që nuk kemi ushtru ndonjë
17 detyrë tjetër veçantë përveçse ndihmës së çështjeve operative
18 në zonat që kemi ofru dhe shtabet.

19 PY. Në rregull. Kjo ka vazhduar deri në kohën kur jeni
20 larguar për në Shqipëri, A është e saktë kjo, domethënë, e kam
21 fjalën këtu lidhur me detyrat tuaja dhe detyrat që ka pas z.
22 Selimi, mesa ju kujtohet juve, kjo ka vazhduar deri në
23 momentin kur jeni larguar për në Shqipëri?

24 PË. Po, deri në shtator kur jam largu për në Shqipëri.

25 PY. Nuk ka pasur ndonjë vendim zyrtar për caktimin e z.

1 Selimi si inspektor të përgjithshëm që ju mund ta keni parë,
2 apo jo, Dëshmitar?

3 PY. Jo, në atë kohë s'e kam pa. Si inspektor të përgjithshëm
4 e di që kur kemi fillu ristrukturimin e Shtabit të
5 Përgjithshëm, atëherë është shpalos se ka dhe si inspektor të
6 përgjithshëm dhe është vendosur z. Selimi.

7 PY. Po. Në rregull. Në shtator dhe në tetor ka pasur shumë
8 luftime që zhvilloheshin, sikurse na keni treguar dhe gjatë
9 ditëve më përpara, por ju gjatë asaj periudhe, domethënë, nga
10 mesi i shtatorit dhe në vijim keni qenë në Shqipëri, kështu që
11 nuk e dini konkretisht se çfarë ka bërë z. Selimi në atë
12 periudhë, a është e saktë të thuhet kështu, Dëshmitar?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Megjithatë, deri në momentin kur jeni larguar, ai ka bërë
15 të njëjta gjëra që kishte bërë dhe më herët, sa i takon
16 marrjes me operacionet e mbrojtjes por sa i takon tetorit kur
17 ka pasur armëpushim, a jeni në dijeni të rolit të z. Selimi sa
18 i takon ndihmimit të disa civilëve dhe ushtarëve të plagosur
19 për të larguar nga Kosova për në Shqipëri për trajtim
20 mjekësor? A keni dijeni për rolin e tij sa i takon këtij
21 aspekti? E kuptoj plotësisht që ju në atë kohë keni qenë në
22 Shqipëri dhe mbas nuk keni pasur fare informacion, po thjesht
23 dua t'ju pyes në qoftë se keni dijeni lidhur me rolin e tij
24 për këtë aspekt përfshirë këtu dhe Mujë Krasniqin dhe Beqir
25 Gashin që i kanë ndihmuar këta persona dhe të tjerë për të

1 shkuar dhe për t'u mjekuar dhe për t'u trajtuar në Shqipëri.

2 PË. Unë nuk e di. Nuk kam dijeni në ato. E di që Mujë

3 Krasniqi edhe grupi që kanë të plagosur ka dalë në Shqipëri

4 dhe ka qenë në Shqipëri dhe është shëru, por kush, qysh, si ka

5 ndodhë nuk e di se nuk kam qëndruar. Nuk mund të komentoj

6 këtë.

7 PY. E kuptoj. Megjithatë ju jeni në dijeni që gjatë

8 armëpushimit ka pasur një moment kur një numër i

9 konsiderueshëm personash u plagosën dhe evakuuan në Shqipëri

10 që të merrnin trajtim mjekësor të cilin nuk e kishin marrë dot

11 deri në atë pikë në Kosovë, besoj e dinit këtë gjë, Dëshmitar,

12 apo jo?

13 PË. Po, e saktë është. Nuk është vetëm në atë kohë, po

14 tërësisht çdo herë në kohë prej fillimit, domethënë, më

15 kujtohet të luftës, çdo herë të plagosurit rëndë nuk kemi mujt

16 t'i shërojmë brenda, u dasht t'i transportojmë jashtë, po

17 ashtu dhe në këtë periudhë. Sidomos prej shtatorit e tutje,

18 kemi dërguar çdo herë të plagosurit jashtë për t'u shëruar.

19 PY. Kemi diskutuar disa herë udhëtimin për në zonën e Llapit

20 nga mesi i gushtit, iu tregua një emërim formal i Kadri

21 Kastratit. Nuk e di në qoftë se e mbani mend që t'ju jetë

22 treguar ky dokument për emërimin formal të Kadri Kastratit më

23 17 gusht 1998. Jua ka treguar Prokuroria javën e shkuar besoj,

24 ju kujtohet, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Mund t'i kërkoj Sekretarit që ta paraqesë në ekran në
2 mënyrë që të mund ta shohim.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është prova materiale P1392. Do i
4 kërkoja Sekretarit që ta paraqesë në versionin në shqip dhe në
5 anglisht. Le të shikojmë fundin e faqes, nënshkrimin në fund
6 të faqes në dy versionet.

7 PY. Besoj se mund shohin që thuhet nënshkruhet nga Rexhep
8 Selimi po ndërkohë që nuk përmendet që Rexhep Selimi ka pas
9 postin e inspektorit të përgjithshëm. Pra, nuk thuhet këtu që
10 Rexhep Selimi, inspektor i përgjithshëm, a është e vërtetë
11 kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë është.

13 PY. Deri në atë pikë, deri në shtator ka pak të ngjarë që ai
14 ta ketë marrë këtë post deri nga nëntori, megjithatë, deri në
15 këtë fazë ai nuk e ka prezantuar veten si inspektor i
16 përgjithshëm ndërkohë që ka ndërvepruar, ka biseduar me juve
17 ose me persona të tjerë, ju nuk dini që ai të jetë prezantuar
18 si inspektor i përgjithshëm, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po, e saktë është.

20 PY. Mbase është një pyetje jo shumë e zgjuar, por megjithatë
21 mendoj që ju nuk keni parë ndonjë vulë të inspektorit të
22 përgjithshëm deri në atë fazë, madje dhe më vonë, më vonë keni
23 pa ndonjë vulë të inspektorit të përgjithshëm deri në atë pikë
24 apo dhe më vonë, Dëshmitar?

25 PË. Jo, asnjëherë s'ka qenë vulë veçantë e inspektorit të

1 përgjithshëm.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po ashtu në mënyrë të ngjashme
3 Sekretarit do i kërkoja të paraqiste në ekran për të njëjtën
4 temë dokumentin P920, flitet për emërimin zyrtar të Nasif
5 Ramabajës në zonën e Dukagjini. Ju lutem paraqisni të dyja
6 versionet në shqipe dhe anglisht në ekran.

7 PY. Përsëri pyetjet janë të së njëjtës natyrë që po bëja pak
8 më përpara. Pra, bëhet fjalë për dy javë më vonë në shtator.
9 Përsëri dokumenti në fund mban nënshkrimin e z. Selimi,
10 megjithatë as këtu nuk përmendet z. Selimi si inspektor i
11 përgjithshëm, nuk shkruhet inspektor i përgjithshëm Rexhep
12 Selimi, kështu Dëshmitar?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Ne biseduam dje lidhur me përvojën tuaj të zgjeruar në
15 armatën jugosllave, po gjithashtu edhe në ushtrinë boshnjake.
16 Pra, vendi ose posti i inspektorit të përgjithshëm nuk
17 ekzistonte as në armatën jugosllave, as në ushtrinë boshnjake,
18 apo jo, Dëshmitar, domethënë, pavarësisht që ekziston sot, ky
19 rol nuk është se ka ekzistuar përpara 1998, a është i saktë ky
20 informacion, Dëshmitar?

21 PË. Është e saktë që nuk ka ekzistue. Faktikisht në ish-
22 armatën jugosllave ka ekzistue sektori. Atij i kanë thënë
23 inspektori gjeneral i sekretariatit të mbrojtjes që është
24 mbajt faktikisht i njëjti në veprim të detyrës. Po në armatën
25 boshnjake s'ka ekzistue. Te ne nuk ka ekzistue në kohën në 1998,

1 domethënë, para se të ristrukturohet Shtabi i Përgjithshëm dhe
2 Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Me ristrukturimin e saj është
3 vendosë edhe të ketë edhe inspektorin e përgjithshëm çdo
4 ushtri që inspekton dhe kontrollon ushtrinë.

5 PY. Në rregull. Mendoj se e keni shpjeguar dhe nga fundi i
6 intervistës me ZPS-në se shumë ndryshime strukturore që kanë
7 ndodhur në periudhën nga gushti në nëntor brenda UÇK-së kanë
8 ndodhur për shkak të bisedimeve me ndërkombëtarët, pra, këtu e
9 përfundoj pyetjen, domethënë, ndryshimet strukturore kanë
10 ndodhur si rezultat i bisedave me ndërkombëtarët, a është e
11 saktë kjo, dëshmitar?

12 PË. Po. Na kanë mësu në atë kohë në biseda me ndërkombëtarëve
13 dhe armëpushimit të njëanshëm që ishte në atë kohë.

14 PY. Për të qenë të qartë, z. Selimi nuk ka propozuar
15 ndonjëherë ose nuk ka kërkuar ndonjëherë konkretisht për të
16 qenë inspektor i përgjithshëm. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, e saktë është.

18 PY. Në qoftë se unë do sugjeroja që ideja për këtë pozicion
19 ka ardhur kryesisht nga z. Çeku që ka sjellë një organigramë
20 të NATO-s në fund të gushtit, a është kjo diçka për të cilën
21 ju keni dijeni, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Nuk është saktë ashtu si po e thoni. Se organigrama dhe
23 strukturimi ka fillu qysh nga nëntori, dhjetori. Dhe e kam bë
24 unë. Dhe e kam bërë, z. Çeku më ka çu disa përkthime të
25 nevojave që kanë qenë por pjesën tjetër e kam përkthyer edhe

1 vetë me drejtorinë operative. Dhe kemi fillu t'i bëjmë
2 detyrat, përgjithësitë të drejtorive. Dhe prej asaj strukture
3 është nxjerrë dhe kemi inspektorin e përgjithshëm dhe në këtë
4 kontekst pastaj është përcaktu të është z. Rexhep Selimi në
5 këtë post. Faktikisht, ka qenë dhe propozimi im.
6 PY. Në rregull. Pra, ju keni marrë informacionin që keni
7 marrë nga jashtë shteti, përveç informacionit që ka sjellë z.
8 Çeku, po keni marrë dhe informacionin mbështetur në përvojën
9 tuaj në mënyrë të tillë që të kishit një strukturë të
10 reformuar ose të reformonit strukturën që ekzistonte ta
11 strukturonit atë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
12 PË. Po. E saktë është se të gjitha këto strukturat janë marrë
13 nga strukturat ekzistuese të asaj kohe dhe NATO-s dhe me
14 pretendime që do të zhvillojmë ushtrinë në këtë drejtim, dhe
15 normalisht ishte drejtimi ynë drejt pavarësisë dhe normalisht
16 edhe bashkëpunimin me NATO-n. Kështu që në këtë drejtim kemi
17 shku që kjo strukturë të fillon të ristrukturohet ushtria
18 Çlirimtare e Kosovës me ato mundësitë që kemi pasur, me
19 faktikisht strukturat bazë të cilat mund të fillojnë të
20 ristrukturohet kjo ushtri.
21 PY. Dua të pyes pse keni marrë si bazë strukturat e NATO-s?
22 Pse keni kopjuar ose pse jeni frymëzuar do ta thosha më mirë
23 nga strukturat e NATO-s, pse, Dëshmitar?
24 PË. Po është frymëzimi, veç e ceka dhe parë që thashë edhe si
25 mbas asaj që të zhvillohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe

1 pretendimi ynë edhe çlirimi i Kosovës, po dhe ne të ashtu dhe
2 pastaj të inkuadrohet në kuadër të forcave të NATO-s dhe të
3 është e drejtuar në drejtim të perëndimit e jo lindjes.

4 PY. Kjo kërkonte goxha ndryshime në aspekte të ndryshme, apo
5 jo, Dëshmitar, sepse shumë persona që kishin përvojë, kishin
6 përvojë lindore dhe kam përshtypjen që e keni fjalën që kishin
7 përvojë nga stili i armatës jugosllave, a kam të drejtë në
8 këtë, Dëshmitar, është e saktë kjo?

9 PË. Është e saktë që shumica e kanë pas këtë drejtim, mirëpo
10 fort kyçen dhe disa eprorë që ishin të kyçur në Ushtrinë
11 Çlirimtare të Kosovë kemi pas edhe përvojën e forcave të NATO-
12 s, faktikisht edhe sistemet e NATO-s dhe normalisht që kemi
13 shku në këtë drejtim. Po qëllimi ynë ka qenë kjo drejtimi,
14 drejtim ka perëndimi jo nga lindja.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani ka
17 ardhur koha që ndoshta të bëjmë një pushim të shkurtër sepse
18 tema që do të hap është një temë e re.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Dëshmitar, do bëjmë një pushim prej dhjetë minutash. Do
21 ju kërkoj atë mos flisnit me askënd lidhur me dëshminë tuaj
22 jashtë sallës së gjyqit, do shihemi përsëri këtu për dhjetë
23 minuta, Dëshmitar.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

1 pushim për dhjetë minuta.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 09.58

3 --- Seanca rifillon në orën 10.10

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Asistente
5 e sallës, shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë, ju lutem.

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë
7 me pyetjet e z. Roberts.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim]

9 PY. Përshëndetje sërish, z. Zyrapi. Po fillonim të flisnim
10 për detyrat dhe përgjegjësitë e z. Selimi si inspektori i
11 përgjithshëm.

12 Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së në Pjesën 7,
13 P1355.7, faqe 23, ju është bërë kjo pyetje se:

14 "Çfarë do të thoshte ky rol?"

15 Po flasim për rolin e z. Selimi si inspektor i
16 përgjithshëm.

17 "Çfarë përfshinte ky rol? Çfarë bënte ai në atë post apo
18 cilat ishin përgjegjësitë e tij?"

19 Dhe përgjigja juaj ishte kështu:

20 "Përgjegjësitë e tij si inspektor i përgjithshëm ishte që
21 të inspektonte njësitë, gatishmërinë e tyre dhe ç'nivel
22 operativ kishin arritur. Nëse kishte mungesë disipline,
23 informonte komandantin dhe kishte edhe shumë detyra të tjera
24 të cilat s'po më kujtohen."

25 Pastaj keni shpjeguar në faqen 24 në anglisht, në faqen

1 25 në shqip, për z. Selimi që:

2 "Shkonte dhe vinte në jetë urdhrat për të vizituar
3 njësitë në zinxhirin e komandimit për të parë se si
4 zbatoheshin rregullat në terren apo i përmbushnin apo zbatonin
5 detyrat të cilat u ngarkoheshin. Pra këto ishin detyrat e tij
6 kryesore, se s'po më kujtohen të gjitha me rend."

7 A ju kujtohet që i keni thënë kështu ZPS-së?

8 PË. Po.

9 PY. Megjithëse keni shpjeguar se kishte edhe detyra të tjera,
10 e kam kuptuar qartë se këto -- se siç e kuptonit ju, ky ishte
11 roli i tij në përgjithësi.

12 PË. Po, në pika të shkurtra e kam spjegum, se s'mund t'i
13 shpjegosh krejtësisht çdo pikë aty. S'më bien ndër mend të
14 gjitha.

15 PY. Patjetër. Patjetër. E kam kuptuar saktë se disa prej
16 këtyre detyrave mbivendosen pjesërisht me atë që ai kishte
17 bërë edhe më përpara në korrik, gusht dhe në shtator, si pjesë
18 e drejtorisë operative e kam fjalën?

19 PË. Pjesë e drejtorisë operative, po, ka qenë. Po si detyra
20 kanë qenë të drejtorisë operative në atë kohë. Normalisht në
21 atë kohë ka mujt edhe drejtoria operative me i kry disa
22 veprime me pas si po -- me inspektue njësitë sa janë të
23 përgatitur, por në atë kohë nuk ka mujt të jenë se s'ka qenë
24 sistemi i organizimit i tillë, i arritur për me mujt me kry
25 këto veprime.

1 PY. Por kishte disa ngjashmëri sa i takon asaj se çfarë duhej
2 të bënte. Pra, duhej që të shkonte të vizitonte disa prej
3 këtyre njësive çfarë kishin në dispozicion, çfarë mungonte në
4 aspektin logjistik, e kështu me radhë.

5 PË. Po. Nga aspekti i disiplinës e të gjitha këto, po, ka. Ka
6 ngjashmëri me to.

7 PY. Do të kaloj pak më vonë tek disiplina. Sa i takon zyrave
8 apo shërbimeve që ekzistojnë, e kam kuptuar saktë se nuk
9 kishte zyrë inspektorati i përgjithshëm në Divjakë, sepse e
10 dini, ju kanë treguar fotografi të ndërtesave të ndryshme në
11 Divjakë. Pra, nuk është se kishte ndonjë kompleks zyrash që
12 ishte në dispozicion të inspektorit i përgjithshëm, apo jo?

13 PË. Po, e saktë është. Nuk ka pas zyrë të veçantë për shkak
14 se, domethënë, e kam spjeguar se cilat zyra kanë pasur dhe ku
15 kanë qenur, se nuk kemi pas edhe q'atq shumë objekte që mund
16 t'i vendosim që çdo sektor ta ketë zyrën veçantë ose shtëpinë
17 veçantë për t'i zhvilluar këtë sektor. Kështu që në shumë
18 vende ka lëviz inspektori, por ma së shumti ka qenë herë në
19 Lladrovç, herë në Bjeshkët e Berishës, në Fshatin e Ri,
20 varësisht prej mundësitë ku ka mujt ta takojmë edhe ku e kam
21 pa.

22 PY. Po. Shumë qartë i keni thënë ZPS-së se çdo individ që e
23 shoqëronin z. Selimi, kur ky udhëtonte, nuk ishin punonjës të
24 polici ushtarake, kështu është? Dhe për procesverbal kjo është
25 në Pjesën 7 të intervistës tuaj, në faqen 27.

1 PY. Keni cekur një individ në veçanti që ishe me z. Selimi,
2 Advi Reçi? Ju kujtohet që i keni thënë ZPS-së për këtë?

3 PË. Po, Avdi Rraci.

4 PY. Avdi Rraci nuk ishte inspektor që punonte pranë
5 inspektoratit të inspektorit të përgjithshëm, në thelb ishte
6 thjesht shofer i z. Selimi?

7 PË. Z. Rraci e ka përcjellë prej fillimit kur e kam njoft z.
8 Selimi, e kam njoft së bashku me to që e ka vozit e ka shku me
9 të gjatë -- pranë tij ka qenë.

10 PY. Por, me sa keni ju dijeni ai nuk kryente detyrë
11 inspektimi, vetë z. Rraci e përcillte z. Selimi kur udhëtonte,
12 siç e thatë?

13 PË. Po. Po, po, kjartë.

14 PY. Keni cekur edhe një individ me emrin Lush [Sipas
15 përkthimit] Agushi, i cili ishte i afërt me z. Selimi. Është
16 në Pjesën 7 të intervistës tuaj, në faqen 27.

17 Z. Agushi, për të qenë i qartë, nuk kishte ndonjë rol
18 zyrtar në drejtorinë e inspektorit të përgjithshëm, apo jo?

19 PË. Po, e saktë është.

20 PY. Dhe nuk kishte asnjë rol pranë Shtabit të Përgjithshëm,
21 apo jo?

22 PË. Jo.

23 PY. Dhe më duket se ka prova se bënte pjesë në Njësinë 192,
24 Mala.

25 PË. Po, bënte pjesë të brigadës e cila ishte veçantë, e cila

1 ishte nën mbikëqyrjen e Shtabit të Përgjithshëm.
2 PY. Cekët se z. Agushi kishte me vete 10 deri në 15 ushtarë.
3 Do të lexoj një pjesë të dëshmisë tuaj që i keni dhënë ZPS-së
4 që të jemi shumë të qartë. Është intervista juaj me ZPS-në,
5 Pjesa 7, faqja 27, që ka të bëjë me z. Agushi, dhe thuhet
6 kështu:

7 "Kishte edhe një tjetër i cili ishte shumë i afërt me
8 atë, që e përdorte ai, quhej Alush Agushi nga zona e
9 Dukagjinit. Ishte -- ky i mbante me vete rreth 10, 15
10 ushtarë."

11 Që ta përfundoj këtë që keni thënë.

12 "Nuk e di se me çfarë lloj lirie vepronte ky, por unë nuk
13 e di, nuk e di nëse ky grup ushtarësh ishte në komandën e tij,
14 apo jo."

15 Tani që të jemi të qartë, këta ushtarë të cilët e
16 shoqëronin z. Agushi nuk ishin nën komandën e z. Selimi, apo
17 jo?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Kur udhëtonte në terren sigurisht takohej me ushtarë në
20 front apo kur kryente vizitat, sigurisht shpesh gjendej në
21 shoqërinë e ushtarëve, apo jo?

22 PË. Shoqërinë e ushtarëve, eprorëve të cilët ishin në atë
23 zonë ose në atë shtab.

24 PY. Kështu që mund të linte përshtypjen se kishte një farë
25 autoriteti mbi ta, po këta ishin thjesht individë të cilët ai

- 1 thjesht po i vizitonte, pra, nuk ishin vartës së tij, apo jo?
- 2 PË. Asnjëherë s'kam thënë që janë vartës i tij, po që ka qenë
3 në kontroll dhe që janë njoft, edhe njoft përpara, po.
- 4 PY. Pra, ai shpesh shihej në shoqërinë e ushtarëve, pra, i
5 rrethuar nga ushtarë, por thjesht fakti se ndodhej pranë
6 këtyre ushtarëve nuk do të thotë se ai i kishte këta ushtarë
7 drejtpërdrejtë nën urdhra.
- 8 PË. Po, kjartë.
- 9 PY. Që të jem i qartë, kur themi "inspektor i përgjithshëm"
10 dhe "drejtori e inspektorit të përgjithshëm" apo çfarëdolloj
11 fraze, ky ishte vetëm z. Selimi, z. Selimi vetëm vepronte si
12 inspektor i përgjithshëm nuk është se ai kishte ndonjë
13 personel, ndonjë drejtori që vepronte nën urdhrat e tij?
- 14 PË. Në atë kohë, jo, nuk ka pas.
- 15 PY. Sa i takon autoritetit të tij, i keni dhënë dëshmi Trupit
16 Gjykues më datë 2 korrik, pra ditën e dytë të dëshmisë tuaj
17 këtu në sallë, kur jeni përgjigjur pyetjeve të Prokurorisë
18 lidhur me njësi speciale e cila vepronte pranë Shtabit të
19 Përgjithshëm dhe për urdhër apo udhëzim që ishte dhënë që ata
20 nuk kishin asnjë të drejtë të arrestonin askënd.
- 21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht nëse mund ta nxjerrim këtë
22 dokument është në lidhje me P901. Ju lutem ta nxjerrim në
23 ekran. U000-6954. Po të kalojmë me numër ERN U000-6967, besoj
24 edhe në anglisht edhe në shqip. Kaloni ju lutem në faqen e
25 mëpasshme në anglisht. Është anglishtja, po kështu edhe faqen

1 e barasvlershme në shqip, dhe ju kërkoj ndjesë, nuk e kam
2 referencën përpara. Po, kjo është.

3 PY. Kjo është ajo që i keni shkruar. Ky është shkrimi juaj,
4 apo jo?

5 PË. Nënshkrimi nuk është i jemi, po fjalët janë të miat.

6 PY. Në rregull. Por ju keni shpjeguar se arsyeja pse është
7 thënë kjo - është në faqen e transkriptit me numër --

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Pra, është në faqen e transkriptit T17442. Arsyeja për
10 këtë udhëzim ishte:

11 "... sepse përgjigja -- pra, njësia e ndërhyrjes së
12 shpejtë e zbulimit nuk është njësi e cila duhej të merrej me
13 arrestime. Ishte -- kjo është përdorur një herë nga inspektori
14 i përgjithshëm në një fshat në territorin e zonës së
15 Pashtrikut. Kjo është arsyeja pse është lëshuar ky urdhër.

16 "PY. Nga 'inspektor i përgjithshëm', e keni fjalën për z.
17 Rexhep Selimi?

18 "PË. Kishte njerëz të armatosur apo të paarmatosur të
19 cilët janë arrestuar?

20 "PY. Nuk janë arrestuar, por është marrë masë disiplinore
21 si pasojë e problemeve disiplinore të cilat kanë ndodhur në
22 fshat apo - më falni - rast në të cilin kjo njësi është
23 përdorur për ta vënë në zbatim këtë dhe nuk duhej të kishte
24 ndodhur kështu."

25 Ju kujtohet që keni thënë kështu?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Ju kujtohet se kur ka ndodhur kjo pak a shumë?

3 PË. Kjo ka ndodhur në vitin 1999, më kujtohet, diku ka qenë
4 marsi 1999 në Krushë e Madhe.

5 PY. Pra, siç e kuptoj unë këtë dokument, z. Selimi është
6 orvatur ta përdorë këtë njësi, se ai nuk kishte personel siç e
7 thamë, dhe ju ja keni ndaluar që ta përdorte këtë njësi për të
8 ndërmarre masa disiplinore. E kam kuptuar saktë dëshminë tuaj?

9 PË. Pikësëpari këtu është e vërtetë që z. Selimi nuk ka pas
10 njësi veçantë, e ka pas edhe të policisë ushtarake që ka mujt
11 e i ka përdorur, po edhe këtë njësi kur përdoret duhet me dit
12 komandanti. Në qoftë se komandanti e ka lejuar që të përdoret
13 kjo njësi, është diçka tjetër. Unë e kam spjegu vetëm në
14 aspektin ushtarak që kjo njësi nuk mund të përdoret për këto
15 nevoja, ajo është vetëm për nevojat e intervenimit në momentet
16 e dhura edhe për zbulimin, për vëzhgime, por jo për
17 arrestime. Meqenëse unë e kam spjegu që nuk ka bo z. Selimi
18 arrestime me këtë njësi në atë vend, por është përdorur. Se
19 ajo njësi duhet të jetë gjithnjë e gatshme për veprim. Në këtë
20 kontekst është thënë.

21 PY. Kur thoni që mund të përdorte policinë ushtarake e cekëm
22 edhe më përpara, ai nuk e kishte nën urdhrat e tij polici
23 ushtarake. Çdo kërkesë për ta përdorur policinë ushtarake
24 duhej t'i drejtohej komandantit të zonës, apo jo?

25 PË. Inspektor i përgjithshëm nuk i drejtohet komandantit të

1 zonës se ka mujt t'i drejtohet veç komandantit të përgjithshëm
2 t'i kërkon edhe policinë ushtarake që ka qenë pranë Shtabit të
3 Përgjithshëm dhe që e ka mujt të merr, ose me mungesë të tyre,
4 mund të marrë edhe nga zonat me komandantin e zonave që t'i
5 kërkohet që t'i përdorë këto njësi. Kurse njësitë vëzhguese
6 diversantë që kanë qenë në atë kohë, ato përdoren veç në
7 momentin kur në qoftë se grupet janë të armatosura dhe
8 kundërvihen me armë, atëherë përdoren këto njësi për t'i
9 eliminuar ato ose për t'i çarmatosur.

10 PY. Por, që të jemi të qartë, pra -- ai nuk mund t'i
11 drejtohej drejtpërdrejtë njësive të polici ushtarake se nuk e
12 kishte autoritetin apo jo?

13 PË. Po, saktë, as policisë ushtarake, as njësitë vëzhguese-
14 diversante.

15 PY. Keni shpjeguar siç e ceka më përpara lidhur me
16 autoritetin e tij, pjesërisht edhe lidhur me disiplinën, por
17 nuk ka ndonjë udhëzim specifik me aq sa dini ju se çfarë
18 përfshinte kjo apo nëse kishte autoritet specifik apo
19 përgjegjësi specifike për disiplinën?

20 PË. Si mendoni, edhe një herë? Pyetja nuk ishte e kuartë për
21 mua.

22 PË. Po, patjetër. E kuptoj. Nuk ishte shumë e drejtpërdrejtë.
23 Ajo që po përpiqem të them është kjo, dhe citova edhe një
24 pjesë të intervistës që ju i keni dhënë ZPS-së, ku keni thënë
25 që pjesërisht një pjesë e autoritet të z. Selimi ishte

1 disiplina, por ne nuk kemi parë asnjë dokument ku konkretisht
2 të thuhet kështu. Për këtë jeni në dijeni?

3 PË. Dokument mund të ketë edhe nëpër detyra përgjegjësi të
4 inspektorit të përgjithshëm, por dokumente të veçanta nuk janë
5 bërë, nuk kemi arrit t'i bëjmë në atë. Ça kemi mujt me arrit i
6 kemi do rregullore të brendshme aty brenda, ku spjegohen për
7 çdo sektor, pastaj detyrat, për shembull, të inspektorit, ose
8 detyrat e drejtorit operativ, ose të drejtorive të tjera, por
9 gjithnjë ka qenë në zhvillim e sipër.

10 Për të parë një sektor duhet goxha dokumente, rregullore
11 dhe udhëzime të bëhet. Ne nuk kemi arritur, kemi pasur ato
12 bazë të cilat i kanë si përgjegjësi që duhet t'i dinë dhe të
13 mund të zbatojnë. Por aq gjerësisht, jo.

14 PY. E kuptova.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nëse mund të shohim tani një prej
16 dokumenteve që ju kanë treguar në lidhje disiplinën. Është ajo
17 që pretendohet se është rregulloja e disiplinës së UÇK-së.
18 P715 është numri i dokumentit. Ju lutem, që ta nxjerrim në
19 ekran. Dhe nëse mund të kalojmë tek faqja UW - më falni, U0006
20 e më tej, 611 në anglisht dhe e njëjta në shqip.

21 PY. Në pjesën e sipërme majtas në qoshe, z. Zyrapi, shihni
22 paragraf numër 8. Unë do të lexoj pjesën në anglisht. Është
23 aty ku shpjegohen masat që supozohet se mund të merreshin. Aty
24 thuhet:

25 "Drejtorët e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-

1 së:

2 "a. Për ushtarakët e specialitetit të tyre kanë të
3 drejtën të Komandantit të Korpusit me përjashtim të shkronjës
4 "h", paragrafit 6, pra, kur duhet që të shkarkojnë dikë. Dhe:

5 "b. Kur drejtojnë ekupe kontrolli të Shtabit të
6 Përgjithshëm kanë të drejtat të Komandantit të Korpusit."

7 E shihni këtë paragraf?

8 PË. Po, po e shof.

9 PY. Sipas këtyre dispozitave, z. Selimi i cili nuk ishte
10 drejtor drejtorie, nuk e ka këtë autoritet disiplinor, apo jo?

11 PË. Është e saktë që nuk e ka. Si inspektor i përgjithshëm i
12 ka të kontrollon disiplinën.

13 PY. Po, por është e rëndësishme, besoj se e kuptoni, dhe
14 besoj se do pajtoheshit me mua që duhet të ketë autoritetin
15 konkretisht për të marrë një masë disiplinore se ndryshe nuk e
16 merr dot, sepse rrezikon që të marrësh një masë disiplinore
17 për të cilën nuk e ke pas autoritetin me e kry.

18 PË. Jo, është e saktë. Nuk e kanë pas ata, po as drejtorat
19 nuk e kanë, të tjerët. Këto e kanë vetëm komandantat e
20 brigadat e zonave dhe komandanti i përgjithshëm.

21 PY. Ju kuptova. I keni cekur ZPS-së se inspektori i
22 përgjithshëm z. Selimi, dhe kjo është në Pjesën 7, faqja 23
23 nuk ishte në të njëjtin nivel -- jo. Po e citoj plotësisht
24 faktikisht siç është thënë.

25 "PY. Pra, çfarë autoriteti kishte ai si inspektor i

1 përgjithshëm që e dallonte nga një njeri i zakonshëm Brenda
2 drejtorisë operative?"

3 Ju jeni përgjigjur kështu:

4 "Inspektori nuk ishte në të njëjtin nivel, ai nuk ishte i
5 barabartë me drejtoritë e tjera."

6 Dhe më duket se sugjeroni se ishte në nivel -- pra kjo
7 është në faqe 24:

8 "... ishte në nivel të komandantit të përgjithshëm. Që do
9 të thotë se ai merrte udhëzime nga komandanti i përgjithshëm
10 sa i takon kontrolleve dhe kryente detyrat të cilat ja
11 ngarkonte ai."

12 Ju kujtohet që kështu i keni thënë ZPS-së?

13 PË. Po, saktë. Ashtu është.

14 PY. Dhe komandanti i përgjithshëm ishte Azem Sylja, apo jo?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. I cili ishte i stacionuar në Shqipëri, thuajse për të
17 gjithë kohën përgjatë së cilës z. Selimi ka qenë sekretare --
18 ka qenë inspektor i përgjithshëm, deri në momentin kur u
19 emërua në Qeverinë e Përshoshëm, domethënë në periudhën nga
20 nëntori deri në prill. E kam më konkretisht fjalën për
21 nëntorin 1998 deri në prill 1999. E saktë është kjo,
22 Dëshmitar?

23 PË. E saktë.

24 PY. Pra, praktikisht do të kishte qenë disi e vështirë për të
25 raportuar apo për t'i komunikuar drejtpërdrejtë atij duke

1 pasur parasysh që ai ishte në Shqipëri dhe duke qenë që këta
2 të dy ishin në dy vende në ndryshme?

3 PË. Po, është e saktë. I ka pas dy zëvendësa brenda.

4 PY. Në rregull. Nuk është se ka ndonjë rast që ju keni parë
5 vetë ndonjë raport të shkruar të shkëmbyer ndërmjet z. Selimi,
6 ose që z. Selimi ja ka dërguar komandantit të përgjithshëm. A
7 është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoja
10 që të kalonim në seancë private, në seancë të mbyllur. Ju
11 kërkoj ndjesë por nuk ka mënyrë tjetër si mund ta bëj këtë
12 pyetje.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
14 në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vijoni, z. Roberts.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim]

17 PY. Më pas, domethënë nga nëntori e në vijim, z. Selimi ka
18 udhëtuar shpesh, siç e keni treguar edhe juve. Po ju nuk është
19 se e keni shoqëruar ose nuk është se e keni udhëtuar bashkë me
20 të, Dëshmitar. A është e saktë kjo?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Pra, sa i takon njohurive personale që keni ju,
23 domethënë, se çfarë ka bërë ai në terren, ju nuk mund të jepni
24 informacion lidhur me këtë, ndryshe nga periudha e korrikut
25 dhe e qershorit, apo jo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Ka disa shembuj të rolit të z. Selimi si inspektor i
3 përgjithshëm që dua t'i diskutoj me ju. Së pari, dua të
4 diskutoj lidhur me Brigadën 121. Një raport ose një dokument i
5 dërgohet Shaban Dragës.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe për procesverbal kjo është
7 prova materiale P1360. Do i kërkoja Sekretarit ta paraqesë në
8 ekran këtë dokument këtë në versionin në shqip dhe në
9 anglisht.

10 PY. Këtë dokument e keni parë edhe më përpara. Kështu i keni
11 thënë ZPS-së, domethënë e keni parë përpara sesa t'jua
12 tregonte ZPS-ja. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Ju është sugjeruar që ky është një dokument i cili ka --
15 domethënë kjo është një pasqyre e keqe e Brigade 121, gjë të
16 cilën juve e keni pranuar, Dëshmitar, apo jo?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Ky raport ka të bëjë me urdhër të dhënë gojarisht nga
19 shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, domethënë, ju
20 fillimisht e keni kërkuar këtë raport prej tij në lidhje me
21 luftimet përreth Raçakut në periudhën e vitit 1998 [Sipas
22 përkthimit], në janar 1998 [Sipas përkthimit]? A është e saktë
23 kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Ju i keni thënë shkruar drejtpërdrejtë z. Dragaj, jo

1 përmes komandant Drinit në këtë rast, i cili normalisht duhet
2 ta kishte ndarë këtë informacion ose do e kishte kërkuar këtë
3 informacion. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, është e saktë. Po ta shpjegoj pak ma shumë. Kjo është
5 e rastit të cilën nuk është në çështje veç raporti -
6 -

7 PY. Sigurisht, shpjegojeni.

8 PË. -- e përdorimit, kur i kam thënë, të përdorimit të
9 njësisë 121 kur e kanë përdorur për të luftuar ose për të
10 marrë pjesë në ndihmën e njësive të tjera për Reçan. Për këtë
11 është arsye. Kjo është ajo që ka shku ai urdhri
12 drejtpërdrejtë. Jo çështje veç të raportit si raport.

13 PY. Në rregull. Informacioni që është dhënë nga z. Dragaj sa
14 i takon Brigadës 121, nuk është informacion që është kërkuar
15 prej jush, po është informacion që ai vetë e ka dhënë përmes
16 këtij raporti. A është e saktë kjo?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Në intervistën me ZPS-së i keni thënë Prokurorit që
19 komandanti i brigadës dhe komandanti i zonës që ka qenë Haxhi
20 Shali, dhe komandant Drini, nëse nuk gabohem. Është e saktë
21 kjo, Dëshmitar?

22 PË. Saktë.

23 PY. A ju keni kërkuar tuaj që të hetoni lidhur me këtë
24 çështje ose që t'i trajtoni ato? Ose ndoshta do të ishte mirë
25 ta bëj ndryshe pyetjen. Çfarë i keni kërkuar atyre, Dëshmitar?

1 PË. Pas këtij raportit edhe bisedës me z. Dragaj, atëherë kam
2 kërku edhe prej komandantit të zonës, po edhe komandantit të
3 brigadës që të merren masa në këtë njësi, dhe të disiplinohet
4 kjo njësi. Edhe këto -- këta dy komandantë i kanë marrë pastaj
5 masën në këtë drejtim. E di që komandanti i batalionit është
6 shkarkue, i batalionit të parë, dhe kanë marrë masa të tjera
7 të cilat kanë disiplinuar këtë njësi.

8 PY. Në rregull. Pra, çështja u zgjidh ndërmjet jush dhe
9 komandantit të zonës dhe komandantit përkatës të brigadës,
10 kështu i takon apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Po, saktë.

12 PY. Sepse në intervistën e ZPS-së, ju keni sugjeruar që
13 inspektori i përgjithshëm, domethënë z. Selimi, ka qenë disi i
14 përfshirë. Megjithatë, duket sikur kjo është diçka që është
15 zgjidhur pa përfshirjen e tij fare. A është e saktë kjo,
16 Dëshmitar?

17 PË. Jo, ka qenë përfshirë edhe ai me i pa disa sene të cilat
18 ma lehtë, i është lehtësu pastaj marrja e një vendime për
19 masat adekuate që janë bë, në këtë njësi. Por drejtpërsëdrejti
20 nuk ka pas si detyrë veçantë të bën këtë.

21 PY. Në rregull. Së dyti, tema e dytë që ju ka treguar ZPS-ja,
22 ka të bëjë me rolin e z. Selimi në komisionin përkatës. Nuk e
23 di në qoftë se ju kujtohet që ju ka treguar një dokument ZPS-
24 ja dhe që e ka diskutuar këtë çështje me ju? Ju kujtohet kjo,
25 Dëshmitar? Komisioni për kufijtë.

1 PË. Ah, komisioni për përcaktimin e kufijve, po.

2 PY. Po, ky komision. Po.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
4 paraqesë në ekran dokumentin P623 në versionin në anglisht dhe
5 në shqip, në mënyrë që ta sqarojmë tërësisht temën për të
6 cilën po ju pyes. Është urdhëresa që cakton anëtarët e
7 komisionit.

8 PY. Së pari, në pikën 1 të urdhëresës thuhet që:

9 "Unë caktoj në Komisionin e Caktimit të Kufijve në zonën
10 operative në tërë Kosovë shtatë individët e mëposhtëm."

11 A e shikoni këtë, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Për të qenë të qartë, z. Selimi dhe të tjerë janë caktuar
14 këtu sipas kësaj urdhërese, megjithatë kjo nuk është se është
15 pjesë e kompetencave ose autoritetit të përgjithshëm të z.
16 Selimi. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe u mendua që ishte e nevojshme që të krijohet ky
19 komision në mënyrë të tillë që të mund të kryheshin këto
20 detyra. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Komisioni është formuar për arsye se është dashtë të
22 formohet nga të gjithë sektorët për të përcaktuar zonat e
23 përgjegjësisive të zonave operative për shkak të probleme që
24 kanë qenë edhe të mëhershme që edhe unë e kam shpjegu edhe
25 ditën e mëhershme.

1 PY. Po. Do të kalojmë tek një pikë e caktuar që lidhet me
2 këto çështje. Z. Selimi nuk është se ka pasur përgjegjësinë
3 apo autoritetin për ta bërë këtë gjë vetëm, apo jo? Edhe për
4 këtë arsye u mendua se ishte e nevojshme që të caktohej një
5 komision për ta bërë këtë gjë, pra, për përcaktimin e kufijve.

6 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Keni shpjeguar se kufijtë e zonave janë diskutuar dhe
9 janë caktuar më herët. Por, vetëm lidhur me çështje të
10 caktuara që mund të ngriheshin në kufij të këtyre u mendua se
11 ishte i nevojshëm që të formohej ky komision. A është e saktë
12 kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Kufijtë e zonave në përgjithësi ishin goxha të përcaktuar
15 mirë në këtë fazë, apo jo? Domethënë, në janar 1999 ishte
16 shumë e qartë se cilët ishin kufijtë e zonave, apo jo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Po, saktë, pas saj.

19 PY. Pra, të sugjerohet se përgjegjësia e komisionit ishte që
20 të shqyrtonte ose përcaktonte kufijtë operative në të gjithë
21 Kosovën është pak si ekzagjerim, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Nuk është e thashë që është ekzagjerim, unë e ceka në
23 qoftë se e keni përcjellë, kufijtë janë përcaktu nga drejtoria
24 operative ma herët, dhe ky komisioni është që i ka zgjidhë
25 problemet të cilat -- mes dy zonave ku ka lind dikund një

1 problem që mund të zgjidhin këtë problem. Por, këta në terren
2 kanë mujt veç ta lëvizin atë vijën të cilën është përcaktuar
3 ma herën nga drejtoria operative, që mund të thuhet për arsye
4 të nevojave, se njonën ose dytës palës që të rregullohet ajo
5 vijë përgjegjësie në këto -- mes dy zonave. Kjo ishte për
6 shkak që ishte më shumë ky komision që ka punuar.

7 PY. E kuptoj. E kuptoj juridiksionin në qoftë se ka kuptim
8 kjo për ju apo jo, domethënë që këta mund ta bënin, ky
9 komision mund ta bënte këtë gjë çfarë ju na shpjeguar.
10 Megjithatë, këtë gjë mund ta bënin vetëm në raste të caktuara
11 për shkak të faktit se përgjithësisht nuk është se kishte
12 probleme sa i takon caktimit të kufijve të këtyre zonave, se
13 këto kufij kishin kohë që ishin caktuar. A është e saktë kjo,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, e saktë.

16 PY. Të kalojmë tek raporti trajton, domethënë, e kam fjalën
17 për raportin që pamë edhe pak më herët.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për Sekretarin është prova
19 materiale P1108.

20 PY. Ky është i vetmi raport që ne kemi parë lidhur me punën e
21 këtij komisioni. Në këtë raport përshkruhet një zonë shumë
22 konkrete përreth Llanishtës, do të thoja unë, midis zonës së
23 Pashtrikut dhe zonës së Nerodimës. A është e saktë kjo,
24 Dëshmitar?

25 PË. Po, e saktë është.

1 PY. Kjo është një çështje shumë specifike që ka të bëjë me
2 njësitin Guri dhe faktit se nën cilën zonë ose nën cilin
3 territor bënte pjesë njësiti Guri. A është e saktë kjo,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, e saktë është.

6 PY. Me sa kam dijeni unë, nuk është se ka raporte të tjera që
7 ju keni parë lidhur me punën e komisioni për çështje të tjera
8 të ngjashme që është dashur që të zgjidhë ky komision. Ky
9 është i vetmi raport që kemi parë lidhur me këtë komision, apo
10 jo, Dëshmitar?

11 PË. Po, është e saktë.

12 PY. Do të doja t'ju tregoja një dokument të ri. Dua t'jua
13 tregoj së pari dhe pastaj të kërkoj që të jepni mendimin tuaj
14 lidhur me të, dhe në qoftë se do ju duhet pak kohë për të
15 menduar lidhur me të, mund të përdorni kohën e pushimit.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
17 SPOE00226769. Ju lutem paraqiteni në ekran dokumentin në
18 versionin në shqip dhe në anglisht.

19 PY. A e keni parë më herët këtë dokument, Dëshmitar?

20 PË. Jo.

21 PY. Tani dua t'ju bëj një përshkrim të këtij dokumenti, në
22 mënyrë të tillë që ju të mund të shikoni secilën prej faqeve
23 dhe t'ja u shpjegoj se për çfarë bën fjalë ky dokument për
24 procesverbal.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të kalojmë

1 tek faqja tjetër që është faqja SPOE00226771. Domethënë, faqja
2 pasardhëse.

3 PY. Në këtë faqe përshkruhet tema e këtij dokumenti
4 konceptual për kontroll dhe ndihmesë, që është:

5 "Kontrollimi i organizimit, funksionimit të gatishmërisë
6 luftarake, moralit, udhëheqjes dhe komandimit."

7 Po ashtu vijohet më tej dhe thuhet që:

8 "Qëllimi i këtij dokumenti është që të kontrollohen zonat
9 operative, shkalla e organizimit ushtar, sistematizimi i
10 kuadrove ushtarakë, aftësimi, morali ushtarak, gatishmëria,
11 organizimi i logjistikës, i mobilizimit si dhe
12 bashkëkoordinimi, bashkëveprimi i njësive fqinje, vartëse si
13 dhe me strukturat civile të përfshira në luftën çlirimtare."

14 Më poshtë në dokument renditet një numër i caktuar
15 pyetjesh dhe çështjesh. Për shembull: Aftësimi i komandës së
16 zonës operative, pastaj aftësimi i komandës së brigadës. Pra,
17 pika e parë është:

18 "Kontrollimi i gatishmërisë luftarake."

19 Dy është:

20 "Procesi i punës së komandave."

21 Pastaj 3 është:

22 "Moralit luftarak ..."

23 Numri 5:

24 "Mobilizimi."

25 Dhe bëhet një vlerësim i përgjithshëm i detyrave. Tani që

1 i hodhët një sy këtij dokumenti, a ju jep ndonjë informacion
2 të mëtejshëm ky dokument lidhur me faktin se çfarë mund të
3 përmbajë ai, ose nga ku e ka orgjinën ky dokument, Dëshmitar?
4 PË. Ky dokument është i përkthyer nga dokumentet që kanë
5 ardhur nga jashtë. Është konkretisht për detyrat dhe
6 përgjegjësitë e inspektorit, faktikisht të inspektoratit.

7 PY. Në qoftë se unë do thoja, do ju sugjeroja që ky është një
8 dokument i cili është dhënë nga fillimi i 1999, a do të ishte
9 kjo në përputhje me atë çfarë ju kujtohet ju, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë është se të gjitha këto dokumente janë bërë
11 më vonë, në 1998 nuk kemi pas kësij dokumente fare.

12 PY. Pra, kjo ka ndodhur disa muaj pasi z. Selimi është
13 caktuar si inspektor i përgjithshëm. Domethënë, këto dokumente
14 janë lëshuar disa muaj pasi është emëruar ai për të kuptuar
15 dhe për të paraqitur se çfarë roli duhet të kishte ai. A është
16 e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, e saktë është.

18 PY. Do ju kërkoja që ta shikonit dokumentin gjatë pushimit në
19 qoftë se do të jetë e nevojshme për juve. Megjithatë besoj që
20 është qartë për juve që nuk përmendet asnjë arrestim apo
21 ndalim i individëve në këtë dokument. Në qoftë se unë do ja u
22 thoja që në këtë dokument nuk flitet as për ndalim as për
23 arrestim të individëve, a do ju befasonte, do ju çudiste kjo,
24 Dëshmitar, ju?

25 PË. Jo, aspak, se inspektori nuk i bën këto veprime.

1 PY. Dhe nuk ka as ndonjë kërkesë specifike që lidh ndalimin e
2 personave, të burgosurve. Domethënë, në qoftë se unë do ju
3 thoja që nuk ka asnjë gjë lidhur me këto tema, kjo nuk do ju
4 befasonte sepse kjo nuk ka të bëjë me rolin e inspektorit të
5 përgjithshëm. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po, sipas detyrës dhe rolin që e ka inspektori.

7 PY. Do ju sugjeroja që një pjesë e mirë e këtyre çështjeve ka
8 të bëjë me kërkesa operative, ose pyetje, çështje operative si
9 për shembull morali i luftimeve, ose gjëra të tilla të
10 ngjashme. Domethënë, çështje të cilat kanë të bëjnë ngushtë me
11 punën e drejtorisë operative. Domethënë, ky është një lloj
12 operacioni për të cilin ju do të ishit i interesuar, do kishit
13 interes, Dëshmitar, apo jo?

14 PË. Kjo është në interes edhe të drejtorisë operative edhe në
15 interes, edhe përgjithësi edhe e shtabit se me këtë është që
16 bën kontrollin faktikisht shkurt thuhet ose kjartë sa është --
17 sa ka arritur ushtria në vjen në aspektin e operacionalizimit
18 të saj, cilin nivel ka arritur, ose ku është në për momentin.
19 Domethënë, kjo është më shumë që e mban atë pjesën përcaktimit
20 operacional të ushtrisë, arritjes së saj.

21 PY. Kjo do të sugjeronte po ashtu që nëse ky dokumentuar do
22 ishte ofruar, le të themi nga janari, shkurti 1999, pozicioni
23 i rolit konkret të inspektorit të përgjithshëm në atë kohë,
24 nuk ishte i qartë mjaftueshëm. A do ishte e drejtë të thuhej
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po. Deri në atë kohë nuk ka qenë, se kanë qenë disa pika
2 shumë të shkurtra që janë përcaktuar si detyrë që janë
3 përkthye, po me këtë dokument kjo janë precizuar të gjitha
4 detyrat e inspektorit të përgjithshëm në atë kohë, po edhe të
5 tanishme. Njëjtë janë.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
7 Mendoj që është momenti i përshtatshëm për të bërë pushimin.
8 Por përpara se të bënim pushimin do të kërkoja që të pranohej
9 dokumenti që sapo përdora.

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
11 kundërshtim?

12 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket se
14 dokumenti ka numrin e identifikimit SPOE00226769 deri në
15 SPOE00226772. Kërkoni që të gjitha këto faqe të pranohen si
16 prova, Avokat?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, por është një dokument me 5
18 faqe gjithsej. Domethënë, përfundon në 226775.

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] 775?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, është një dokument me gjashtë
21 ose shtatë faqe gjithsej.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet si
23 provë materiale.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 dokumenti SPOE00226769 deri në SPOE00226775 do të marrë numrin

1 e provës materiale 3D00027, dhe aktualisht është i klasifikuar
2 si dokument konfidencial.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime që të
4 klasifikohet si publik. Megjithatë do më duhet që ta konfirmoj
5 përfundimisht pas pushimit të kafes. Do ta kontrolloj gjatë
6 pushimit dhe do ju them pas pushimit të kafes.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim]

9 PY. Faleminderit, z. Zyrapi. Do të bëjmë një pushim tani dhe
10 do takohemi pas gjysmë ore. Kam pak a shumë një orë tjetër
11 pyetje për juve.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, do
13 të bëjmë pushimin prej 30 minutash tani. Do të mblidhemi
14 përsëri në sallën e gjyqit në orën 11.30. Ju lutem mos flisni
15 me askënd me dëshminë që po jepni përpara Trupit Gjykses
16 jashtë sallës së gjyqit.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

19 Misetiç.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dua të ngre një
21 çështje procedurale që e kam përmendur dhe dua që ta sjell në
22 vëmendje të Trupit Gjykses. Me 4 korrik, z. Roberts ka kërkuar
23 nga Trupi Gjykses që t'i japë ekipeve të Mbrojtjes -- që të
24 japë disa informacion sa i takon planit që ka Prokuroria deri
25 me datë 21 qershor.

1 Thjesht do të doja t'ju kërkoja në qoftë se keni ndonjë
2 informacion për të na dhënë.

3 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Akoma po e
4 shqyrtojmë. Do të marrim një vendim lidhur me këtë për pak
5 kohë.

6 Faleminderit, tani do të bëjmë pushim deri në orën 11.30.

7 --- Pauza fillon në orën 11.00

8 --- Seanca rifillon në orën 11.29

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
10 shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sa për të konfirmuar nuk kemi
12 ndonjë kundërshtim që prova e fundit e materialit të jetë
13 publike. Nuk e di Prokuroria ç'mendim ka.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Dokumenti i fundit 3D00027 --

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] --

19 riklasifikohet si publik.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
21 Gjykatës. E mbajtëm shënim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, do
23 të vijojmë me pyetjet që do jua bëjë Avokati i Z. Selimi.

24 Z. Roberts, keni fjalën.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

1 PY. Përshëndetje, sërish z. Zyrapi. Shpresoj që t'i përfundoj
2 pyetjet që unë i kam për ju, para pushimit të drekës nëse do
3 të mundemi.

4 Tani do të dëshiroj që të flasim për mbledhjet e Shtabit
5 të Përgjithshëm, duke filluar nga nëntori dhe dhjetori i '98-
6 s.

7 Jo, më herët do filloj. Ju keni konfirmuar më duket se
8 përpara 15 korrikut ju s'keni marrë pjesë në mbledhjet e
9 Shtabit të Përgjithshëm, sepse nuk ishit anëtar i Shtabit të
10 Përgjithshëm, apo jo?

11 PË. Po, saktë.

12 PY. Pra, nuk e dini se çfarë mbledhjesh janë zhvilluar, kush
13 merrte pjesë në to dhe ç'diskutime janë zhvilluar aty?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Dhe gjatë verës, dhe e di se e keni thënë disa herë,
16 kishte vështirësi për planifikimin e mbledhjeve të Shtabit të
17 Përgjithshëm dhe në pjesën e tretë të intervistës suaj, faqja
18 3, me numër P1355.3 keni thënë se:

19 "...kur e mora detyrën në këtë drejtori filluan këto
20 sulmet", pra, është korriku i '98-s, "Shtabi i Përgjithshëm
21 nuk pati mundësi të bënte mbledhje, sepse u shpërnda në të
22 gjitha territoret ku kishte sulme dhe lëvizje dhe e kishim të
23 vështirë që të mblidheshim e të diskutonim për këto probleme".

24 Pra, është e vërtetë që kishte vështirësi për të
25 planifikuar mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm që nga momenti

1 kur ju morët detyrën si drejtor i drejtorisë operative deri në
2 momentin kur ju keni dalë për në Shqipëri në mes të shtatorit.

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Dhe kur keni qenë në Shqipëri ju nuk e dini se çfarë
5 mbledhjesh janë zhvilluar apo nëse janë zhvilluar mbledhje të
6 tilla, siç ma konfirmuat edhe më herët sot?

7 PË. Po, saktë, nuk e di.

8 PY. Nuk keni parë kurrë një listë të mbledhjeve apo të
9 pjesëmarrësve të këtyre mbledhjeve; nuk ka një dokumentim të
10 këtyre mbledhjeve deri në momentin që ju jeni kthyer në
11 Kosovë.

12 PË. Po, saktë.

13 PY. Dhe kur jeni kthyer në Kosovë, ju asokohe në postin tuaj,
14 në fund të nëntorit përgjithësisht, a kishit përgjegjësinë për
15 të planifikuar mbledhjet e këtij Shtabi të Përgjithshëm në
16 rolin tuaj si shef i Shtabit të Përgjithshëm?

17 PË. Po, mbledhjet të cilat ishin për të brendshme të
18 drejtorisë edhe për t'i përgatitur mbledhjet edhe me
19 komandantët e zonave.

20 PY. Prandaj ju planifikoni datën, orën, vendin ku
21 zhvilloheshin këto mbledhje pak a shumë?

22 PË. Disa pjesë, jo -- po, por më shumë në konsultim me
23 komandantë ose zëvendësin se kur mund t'i mbajmë këto takime.

24 PY. Ndonjëherë këtë mund ta bënit pa -- domethënë aty për
25 aty, si të thuash. Po të shikojmë P66 [Sipas përkthimit] do ta

1 shikojmë me hollësi më pak -- pas pak - më falni - planifikimi
2 i një mbledhje për 29 dhjetorin dhe vendimi i planifikimit
3 doli më datë 28, pra, ishte vetëm një ditë kohë për zhvillimin
4 e mbledhjes. Pra, të mbledhjes, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Edhe po të ishte njeriu në Kosovë si anëtar i Shtabit të
7 Përgjithshëm, si z. Selimi, kjo nuk do të thotë se ai medoemos
8 do të ishte në gjendje që të merrte pjesë në të gjitha këto
9 mbledhje, apo jo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Dhe siç e keni konfirmuar disa herë shpesh udhëtonit
12 shkonit në vende të ndryshme, dhe siç e keni shpjeguar shpesh
13 duhej shumë kohë për të kaluar nga një pjesë e Kosovës në një
14 tjetër, pavarësisht nga distanca, relativisht e shkurtër
15 teorikisht të themi, midis atyre dy vendeve?

16 PË. Po, e sakë, ashtu është.

17 PY. Kemi shënimet që pretendohet se janë të një mbledhje të
18 Divjakës 29 dhjetor '98.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Me numër P1408. Ju lutem, t'i
20 nxirrni në ekran edhe në anglisht edhe në shqip.

21 PY. Kjo është mbledhja e 29 dhjetorit; është lista e
22 pjesëmarrësve, jeni ju vetë, z. Luzha, z. Grabovci, z. Limaj,
23 Ramë Buaj dhe Sali Veseli. E shihni këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Z. Selimi nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje, për

1 shembull, të 29 dhjetorit?

2 PË. Më duket se s'është këtu, sigurisht jo.

3 PY. Nuk ju kujtohet që ai të ketë qenë i pranishëm në atë
4 mbledhje?

5 PË. Jo, s'më kujtohet që ka qenë.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kalojmë tani në P621 që është
7 kërkesa juaj apo urdhri për zhvillimin e kësaj mbledhje -- për
8 thirrjen e kësaj mbledhjeje - më falni - ta vendosim në ekran.

9 PY. Ky mos është një model tip i urdhrave për thirrjen e
10 mbledhjeve që i keni pas përdorur ju?

11 PË. Kjo është një urdhër, faktikisht, se si raportohet në
12 Shtab të Përgjithshëm dhe çka kërkohet të raportohet. Ky është
13 një urdhër që është dhënë edhe drejtorive por dhe njëjtë kanë
14 pas edhe pos edhe ka dërgu edhe zonave.

15 PY. Jo, por në pikën 1 aty thuhet, për shembull:

16 "Më këtë datë, në orën 12.00 në selinë e SHP-së do të
17 mbahet referimi me kryeshefët e drejtorive të SHP-së të UÇK-
18 së."

19 E shihni në pikën 1?

20 PË. Po, saktë është.

21 PY. Dhe kur planifikohet kjo mbledhje, a mos ishte kjo fraza
22 standarde të cilën ju e përdornit për thirrjen e këtyre
23 mbledhjeve, planifikimin e tyre?

24 PË. Po, çdo herë.

25 PY. Kështu që këtu janë ftuar kryeshefët e të gjitha

1 drejtorive, por drejtoritë e inspektorit të përgjithshëm nuk
2 kishte, siç e diskutuam, apo jo?

3 PË. Po, saktë, nuk është në [E pakuptueshme] time, nuk ka
4 qenë inspektori dhe drejtoritë.

5 PY. Pra, zyrtarisht, ai nuk ishte i detyruar që të merrte
6 pjesë në mbledhje apo nuk ftohej që të merrte pjesë në këto
7 mbledhje sipas këtij urdhri?

8 PË. Po, saktë. Nuk ka pas, nuk ka pas detyrë të vinte në këtë
9 detyrë -- në këtë mbledhje.

10 PY. Dhe nëse ju keni përdorur të njëjtën terminologji në
11 thirrjen e të gjitha mbledhjeve kjo që thamë tani vllente për
12 të gjitha mbledhjet, pra, nga nëntori '98-s deri në prill të
13 '99-s, apo jo?

14 PË. Po, sa herë është thirrë drejtorat, po.

15 PY. Sa i takon mbledhjes së 12 apo 13 nëntorit të '98, kjo ka
16 qenë mbledhja e parë në të cilin ju keni para pjesë pasi jeni
17 kthyer në Kosovë?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Dhe keni filluar të diskutoni për ristrukturimin e UÇK-së
20 në atë mbledhje siç na treguat më 5 korrik?

21 PË. Po, saktë është.

22 PY. Dhe ishte -- ishin vetëm drejtoritë ekzistuese të cilat
23 merrnin pjesë në këto mbledhje, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Prandaj edhe, për shembull, z. Limaj nuk ishte aty, sepse

1 drejtoria e policisë ushtarake ende nuk ishte formuar në atë
2 moment?

3 PË. Po, ashtu është.

4 PY. Më duket -- siç më duket ju e keni konfirmuar, por
5 ristrukturimi është formalizuar nga fundi i nëntorit '98-s,
6 apo jo?

7 PË. Ashtu është.

8 PY. Sa u takon mbledhjeve të tjera në nëntor, ju kanë treguar
9 urdhrin për shfarosjen e fenomeneve negative dhe shpërdorimit
10 të pronës private.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më duket se është me numër 1D29.

12 PY. Ju kujtohet ky urdhër nga 28 nëntori '99-s? Dhe ju thatë
13 që në bazë të kësaj, pra, ishte pas diskutimeve që keni bërë
14 doli ky urdhër, apo jo? Kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Ju kërkoj ndjesë se nuk prita që të jepnit përgjigjen,
17 po. Këto diskutime, nëse ju kujtohet, janë zhvilluar ditën kur
18 e keni lëshuar këtë urdhër, më datë 28, kështu ka qenë?

19 PË. Po, diskutimet në faktikisht, kur ai urdhër është lëshu,
20 ka pas edhe kërkesa nga të gjithat zonat edhe më herët për
21 këto probleme, por edhe gjatë diskutimit, kemi diskutuar me
22 drejtorët, e kemi pas këtë problematikë dhe pastaj është, pas
23 kësaj është lëshuar ky urdhër.

24 PY. Por nuk e dini nëse arsyet kanë qenë diskutimet,
25 pikërisht më atë datë, më 28 nëntor, apo jo?

1 PË. Jo, veç në këtë takim, por edhe më herhëm. Unë e ceka
2 atë edhe më herët që ka pas edhe ankesa të tjera. Domethënë
3 nga komandantët më herët se të vinte deri te ky lëshimi i
4 këtij urdhri.

5 PY. Ju kanë treguar edhe një dokument që ka të bëjë me
6 mbledhjen e 29 nëntorit të '98-s në të cilin përshkruani se
7 keni mbajtur një prezantim të shkurtër mbi strukturën e
8 Shtabit të Përgjithshëm dhe funksionet e drejtorive të
9 ndryshme. Ju kujtohet që ju ka bërë këto pyetje Prokuroria më
10 datë 2 korrik?

11 PË. Po.

12 PY. Është mbledhja në të cilën z. Selimi nuk ishte i
13 pranishëm, sapo e diskutuam. Sepse kjo mbledhje është thirrur
14 veç në datë 28 dhjetor me urdhrin që ju e keni lëshuar dhe
15 emri i tij nuk ishte në listën e pjesëmarrësve të cilët kanë
16 marrë pjesë në atë mbledhje.

17 PË. Me siguri që s'është urdhri -- emri i tij aty edhe s'ka
18 qenë se veç drejtorat kanë qenë.

19 PY. Për të qenë të qartë në intervistën tuaj që i keni dhënë
20 ZPS-së, ju cekni edhe çështjen e -- se u diskutua, pra, për
21 çështjen e z. Kuqi, Bajram [Sipas përkthimit] Kuqi. Po
22 përpiqem tashi ta përcaktoj se kur ka qenë. Nëse unë do thosha
23 që është diskutuar për çështjen e tij në atë mbledhje, a
24 përputhet kjo me atë çka ju keni dijeni?

25 PË. Nuk e di a ka qenë bash në mbledhje saktë.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju lutem, që të vendosim në ekran
2 dokumentin numër P1104 në anglisht dhe në shqip. Jo, më falni,
3 kërkoj ndjesë. Në ekran të paraqesim dokumentin me numër 1109.
4 Të kalojmë me numër ERN-je U002-2865.

5 PY. Po të shohim diku nga gjysma e faqes duket se ka, pra, me
6 gjasë janë shënime të kësaj mbledhje të 29 --

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtojmë. Karakterizim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
9 kundërshtimi.

10 Mund të vazhdoni.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po e filloj prapë.

12 PY. Pra, më gjasë këto janë shënime të mbledhjes së 29
13 dhjetorit '98-s të Shtabit të Përgjithshëm për të cilin ne
14 sapo folëm, ku duket se përmendet si edhe çështja e z. Kuqi si
15 një nga pikat për të cilat është diskutuar në atë mbledhje, e
16 shihni?

17 PË. Po, ky veç ky nuk është ai takim ku biseduam më herët.

18 Këtë është 29-in, është takimi tjetër.

19 PY. Është një mbledhje tjetër?

20 PË. Po, nuk është i 28-it. [E pakuptueshme] për 28-in më
21 pyetët, tash po del 29-ti. Domethënë data është tjetër edhe
22 mundet me qenë takimi tjetër.

23 PY. Ju kërkoj ndjesë. Po, që të jem shumë i qartë. Urdhrin që
24 ju e lëshuat për të zhvilluar këtë mbledhje ka qenë më datë 28
25 dhjetor që njerëzit të merrni pjesë në një mbledhje më datë 29

1 dhjetor, pra, të nesërmen. Po të doni mund t'i kthehemi atij
2 dokumenti dhe ta shohim, por unë për këtë mbledhje e kam
3 fjalën, për mbledhjen e datës 29 dhjetor në të cilën nuk
4 merrte pjesë z. Selimi.

5 PË. Po.

6 PY. Pra, e pranoni se nëse ky rend dite është i saktë, ky
7 dokument është i saktë, këto janë ato për të cilat janë
8 diskutuar në atë mbledhje?

9 PË. Është e saktë që është diskutuar në këtë mbledhje.

10 PY. Por është shumë e qartë dhe dua që të konfirmoni se në
11 atë mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm nuk është marrë asnjë
12 vendim se çfarë do t'i ndodhte z. Kuqi, apo jo?

13 PË. Po, është e saktë.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do kërkoja tani -- një çast durim,
15 të nderuar Gjykatës, sa t'i hedh një sy. [Mikrofoni
16 çaktivizuar].

17 PY. Ju kërkoj ndjesë. Dëshiroj të kalojmë tani në mbledhjen e
18 5 janarit. Është tjetra për të cilën ju kanë bërë pyetje në
19 gjykatë. Është me numër P1352.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju lutem, ta nxjerrim në ekran.
21 Jo, kërkoj ndjesë -- po, po, jo. Mund ta shohim këtu -- jo,
22 është dokumenti i gabuar. Kërkoj ndjesë.

23 Kalojmë tani te dokumenti me SPO00226468. I kërkoj ndjesë
24 Sekretarit të Gjykatës.

25 PY. Po të shohim faqen e parë të këtij dokumenti, me gjasë

1 duket se është rendi i ditës për një mbledhje të 5 janarit

2 '99-s, Pika 1, por thuhet:

3 "Raporti i bujshëm dhe me aktivitete".

4 Ku raportojnë z. Limaj, Rexhep Selimi, Sokol Bashota,
5 Jakup Krasniqi, Adem Grabovci, ju vetë dhe Ramë Buja. E shihni
6 këtë pasazh?

7 PË. Po.

8 PY. Ka nja dy probleme këtu; janë bërë komente goxha,
9 domethënë, në Pikën 2, ku thuhet se:

10 "Drejtoritë të bëhen funksionale..."

11 Pra, është edhe një muaj, të themi, pas ristrukturimit,
12 pas përfundimit të ristrukturimit, por këtu prapë thuhet që
13 drejtoritë ende nuk ishin funksionale, kështu është?

14 PË. Po, kështu është.

15 PY. Më specifikisht thuhet që duhet të kenë stafin e duhur,
16 përfshirë administratën, shoferë dhe automjete. Kjo do të
17 thotë se kishte ende boshllëqe në logjistikën, në dispozicion
18 të këtyre drejtorive në atë moment?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe për të qenë shumë të qartë, kur thoni ristrukturim që
21 ka përfunduar në fund të nëntorit, ju e keni fjalën që krijimi
22 formal i këtyre posteve, por jo se medoemos këto e kishin
23 mundësinë që të ushtronin përgjegjësitë e tyre, është e saktë
24 nëse e them kështu?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Në gjithë pjesën tjetër të kësaj mbledhjeje --

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në fakt le të kalojmë në një
3 mbledhje tjetër të 14 janarit, në faqen 226470. Është dy faqe
4 më tutje.

5 PY. Edhe këtu duket se është, pra, në rreshtin e katërt nga
6 fundi, një tjetër ankohet se një "Drejtori Operative duhet
7 plotësuar me kuadër, me personel".

8 Pra, ju si shef shtabi, ishit -- i Shtabit të
9 Përgjithshëm, ishit në dijeni se drejtoria operative ende
10 kishte mangësi të rënda dhe kufizime në atë moment; është e
11 saktë nëse e them kështu?

12 PË. Po, është e saktë, jo veç drejtoria operative, por të
13 gjitha drejtoritë kanë pas mungesë.

14 PY. Dhe me gjasë kjo ka vazhduar edhe kohë mbas kësaj date?

15 PË. Po.

16 PY. Asokohe, kush ishte drejtues i drejtorisë operative?

17 PË. Nuk ka pas me u ushtru të dyja detyrat, edhe të
18 drejtorisë operative edhe shefit të shtabit. Se nuk kishte,
19 nuk kishim eprorë shumë, krejt nëpër andej kemi qenë në ato
20 kohë tre vetë. Më duket tash ngadaltë e bonë, pastaj kemi
21 arrit deri në mars t'i bëjmë diku gjashtë në drejtori. Kështu
22 që tërë kohën ka pas mungesë.

23 PY. Po, nëse mund ta krahasojmë këtë me ushtrinë e Bosnjës që
24 e krahasuat dje me 50 a 60 oficerë me goxha përvojë, është një
25 diferencë shumë e madhe me atë, e deri edhe në fund të marsit,

1 është e saktë kjo që them?

2 PË. Plotësisht e saktë.

3 PY. Këta të tre ishit ju vetë, Sali Veseli; kush ishte i
4 treti?

5 PË. Kishim edhe Naim Malokun në atë kohë. Pastaj më vonë në
6 maj më erdhi kemi pas Mensurin, pastaj më ka ardhë, kam pas
7 pastaj edhe më vonë ka qenë Dilaver Goxhaj, pastaj ka qenë
8 Bardhyl Tahiri.

9 PY. Pra, në thelb, për gjithë luftën nuk kishte më shumë,
10 sesa një grusht individësh, të them. Është e saktë kjo?

11 PË. Po, e saktë.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të kalojmë tani në një mbledhje të
13 21 janarit të '99-s, që është në faqen SPOE00226473.

14 PY. Duket se është një mbledhje ku kanë marrë pjesë disa prej
15 komandantëve të zonave. Ju kujtohet kjo mbledhje?

16 PË. Po.

17 PY. Keni marrë pjesë; keni qenë në atë mbledhje?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ka shumë ankesa të cilat janë bërë asokohe:

20 "Të zhvillohen më shpesh konsultime.

21 "Financat duhen të centralizohen.

22 "Edhe logjistika të centralizohet."

23 Dhe në fund fare:

24 "Disa prej komandantëve të zonave duhet të kenë një vend
25 në Shtabin e Përgjithshëm."

1 Besoj se e shihni në shënime.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Megjithëse duhet ta nxjerrim
3 pjesën e poshtme të shënimit në shqip që të jetë e dukshme.

4 DËSHMITARI: Po.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim]

6 PY. Pra, këtu thjesht regjistrohen mendimet e komandantëve të
7 zonave pa shprehur ndonjë koment për to.

8 PË. Po.

9 PY. Dhe qëllimi ishte, me sa mbani mend ju ishte qëllimi
10 ishte që ky informacion t'u transmetohej të tjerëve. Pra, për
11 të mbajtur, si të thuash, një procesverbal, pra, një
12 dokumentin faktik se cilat ishin mendimet e komandantëve të
13 zonave?

14 PË. Ashtu është.

15 PY. Nga atë sa ju kujtohet juve, ju nuk është se jeni përpjek
16 me debat me komandantët e zonave. Thjesht keni regjistruar,
17 keni dokumenti ato çka ata kanë thënë.

18 PË. Është -- shumicën nuk e kemi regjistruar ato kërkesat e
19 tyre dhe mendimet e tyre në fillim.

20 PY. Kishte edhe ankesa të tjera të cilat i kanë shprehur, pa i
21 shprehur me hollësi -- paska pasur edhe ankesa të tjera,
22 kështu?

23 PË. Po, logjistike, finance me plotësin të kuadrave edhe ato
24 kanë qenë.

25 PY. Edhe z. Selimi ka marrë pjesë në këtë mbledhje?

1 PË. Me siguri, nuk më kujtohet, me siguri po.

2 PY. Roli i tij siç e kuptuat ju asokohe, do të ishte e drejtë
3 të të thoshim se ai ishte si ndërlidhësi në njëfarë mënyre,
4 midis komandantëve të zonave dhe anëtarëve -- dhe personave të
5 tjerë në Shtabin e Përgjithshëm?

6 PË. Roli i kujt?

7 PY. Roli i z. Selimi, i Rexhep Selimit.

8 PË. Në qoftë se folim për këtë periudhë në atë kohë ka qenë
9 roli i tij inspektor i përgjithshëm.

10 PY. Ai ka qenë në Shtab të Përgjithshëm, ka qenë anëtar i
11 Shtabit të Përgjithshëm, por kishte marrëdhënie të mira edhe
12 me komandantët e zonave, në përgjithësi e kam fjalën, a është
13 e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Dhe kryesisht kjo ka ndodhur për të gjitha arsyet që ne
16 diskutuam dje në fillim të pyetjeve të mia për ju dje dhe
17 fakti që ai kishte ndërveprim të zakonshëm me ta që prej asaj
18 kohe, a është e saktë kjo?

19 PË. Po, e saktë.

20 PY. Pra, ata do i besonin z. Selimi për të trajtuar ankesat e
21 tyre ose të paktën për të dëgjuar ankesat e tyre dhe më pas të
22 bënte ndërlidhjen me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, a
23 është e drejtë të thuhet kështu?

24 PË. Po, e drejtë.

25 PY. Kam dhe disa tema të tjera për të diskutuar me juve. Janë

1 pak sa çështje ose tema pak më diskrete, njërin prej tyre e
2 keni trajtuar pjesërisht; është çështja që ka të bëjë me
3 drejtorinë e policisë ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të
4 UÇK-së.

5 ZPS-ja ju ka bërë pyetje lidhur me rolin e drejtorisë së
6 policisë ushtarake. Ju thatë që funksioni i kësaj drejtorie
7 ishte që të ofronte siguri për Shtabin e Përgjithshëm dhe të
8 shoqëronte anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm në lëvizjet që
9 bënin këta anëtarë nëpër Kosovë.

10 A ju kujtohet ta keni thënë këtë në përgjigje të pyetjeve
11 të Prokurores, Dëshmitar? Për transkript kjo jepet në faqen
12 T17436.

13 PË. Po, këtë e kam thënë për policinë ushtarake që ka qenë
14 pranë Shtabit të Përgjithshëm; kurse drejtorja ka pasur
15 detyrën që të zhvillojë politikat dhe trajnimet dhe t'iu
16 ofrojë sa më mirë njohuritë e policisë ushtarake në atë kohë.

17 PY. E kuptoj, faleminderit. Për të qenë të qartë, drejtorja e
18 policisë ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm nuk ka qenë një
19 drejtor që ka ekzistuar përpara ristrukturimit, apo jo?

20 Domethënë është një drejtor që është krijuar gjatë
21 ristrukturimit dhe është bërë funksionale nga fundi i

22 nëntorit, fillimi i dhjetorit, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Dua t'ju tregoj një deklaratë të 2016-s.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është dokumenti me numër reference

1 SPOE0067195.

2 PY. Besoj që kjo është dhënë për Prokurorinë e Kosovës. Do ju
3 lexoj atë çfarë keni thënë:

4 "Kur është krijuar Drejtoria e Policisë Ushtarake e UÇK-
5 së dhe çfarë kompetencash ka pasur kjo forcë policie?"

6 Përgjigja juaj është kjo:

7 "Drejtori e Policisë Ushtarake është formuar nga fundi i
8 nëntorit ose fillimi i dhjetorit të '98-s. Kjo polici ka pas
9 si detyrë trajnimin e policisë ushtarake dhe të mbikëqyrte
10 zhvillimet e saj."

11 Kjo është në përputhje me atë çfarë na thatë pak më
12 herët, apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Dhe që prej atëherë nuk është se ju ka ndryshuar ndonjë
15 gjë mendimin lidhur me krijimin e kësaj drejtorie dhe lidhur
16 me rolin që ka pasur ajo, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. E saktë.

18 PY. Dua t'ju tregoj një dokument që ka numrin e referencës
19 043672.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ta shohim teksa shfaqet në ekran,
21 Dëshmitar. Siç mund ta shikoni ka disa artikuj në këtë fletën
22 e gazetës që keni përpara, megjithatë unë jam i interesuar te
23 faqja tjetër në anglisht; ndërkohë që dokumenti në shqip duhet
24 të qëndrojë në faqen që e keni aktualisht përpara ekranit. Po,
25 te kjo faqja jam i interesuar në versionin në anglisht.

1 PY. A shikoni një artikull gazete që është një informatë nga
2 pjesa e sipërme në të djathtë?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është një kumtesë e Drejtorisë së
4 Policisë Ushtarake të UÇK-së. A e shikoni këtë artikull
5 gazete, Dëshmitar?

6 PY. Titulli është: "U arrestuan nga Policia Ushtarake e UÇK-
7 së dy funksionarë të LDK-së". E shihni besoj?

8 PË. Po, po e shoh.

9 PY. Faleminderit. Ju kanë bërë pyetje lidhur me këtë artikull
10 në vitin 2016. Do lexoj atë çfarë keni thënë në përgjigje të
11 pyetjeve të bëra me këtë artikull, Dëshmitar.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal, është
13 procesverbali i dëshmisë që keni dhënë ju më datë 21 shtator
14 2016 që mban numrin SPOE00067185 dhe pjesa që do të citoj
15 jepet në faqen SPOE00067188.

16 PY. Pra: "Dëshmitarit i është treguar një komunikatë nga Zëri
17 i Kosovës nga data 5 nëntor 1998. Dëshmitari pyetet në qoftë
18 se ka njohuri lidhur me këtë komunikatë edhe në qoftë se ka
19 pasur një Drejtor të Policisë Ushtarake në atë datë".

20 Përgjigja që keni dhënë është kjo:

21 "Së pari në datë 5 [Sipas përkthimit] nëntor 1998
22 Drejtoria e UÇK-së, pra, Drejtoria e Policisë Ushtarake e UÇK-
23 së nuk ka ekzistuar; nuk e kam parë këtë komunikatë në një
24 gazetë. Nuk e di se kush e ka botuar këtë komunikatë".

25 A ju kujtohet që t'i keni thënë kështu Prokurorisë së

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts (Vazhdim)

Faqe 75

1 Kosovës lidhur me këtë deklaratë për shtyp ose kumtesë,
2 komunikatë, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Kjo -- i qëndroni kësaj përgjigje? Kjo është përgjigja
5 juaj edhe sot e kësaj dite lidhur me këtë pyetje?

6 PË. Po.

7 PY. Edhe kur ekzistonte drejtorja e policisë ushtarake, ajo
8 asnjëherë nuk ka qenë e stacionuar në Prishtinë deri nga fundi
9 i luftës, sigurisht, domethënë, a është e saktë kjo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Në këtë dokument thuhet që personat janë ndaluar në
13 burgun hetimor numër 3. Ti nuk ke dëgjuar asnjëherë për këtë
14 burg, apo jo? Burgu Hetues numër 3; e keni dëgjuar ndonjëherë
15 këtë, Dëshmitar?

16 PË. Asnjëherë s'e kam dëgjuar.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Tani do të kalojmë, do të shohim
19 një dokument tjetër të ngjashëm që është kumtesa numër 3. Për
20 procesverbal është dokumenti me numër ERN-je 043858.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua
22 të sqaroj për procesverbal, numri ERN i dokumentit që përmendi
23 Avokati është pranuar si provë me numrin P00300. Faleminderit.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit shumë, z. Sekretar.
25 Besoj që duhet të jetë nga fundi i versionit në shqip.

1 PY. Po, në fakt në fund të faqes në të majtë kemi kumtesën
2 numër 3. Pra, kjo kumtesë ka të bëjë me një rast që ka ndodhur
3 më 18 tetor të atij viti [Sipas përkthimit] dhe sërish kjo
4 pretendohet që të jetë lëshuar në emër të Drejtorisë së
5 Policisë Ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mendoj
6 që data në Zërin e Kosovës kur është botuar kjo kumtesë është
7 29 tetor 1998.

8 Tani që të jemi të qartë, në qoftë se ju kam kuptuar siç
9 duhet, i takon që kjo të jetë një kumtesë e cila është botuar
10 përpara një muaji, sesa të krijohet drejtoria e policisë
11 ushtarake, a i qëndroni këtij fakti, Dëshmitar?

12 PË, Po, saktë.

13 PY. Sa i takon autoritetit ose kompetencave të z. Limaj,
14 domethënë nga momenti që është emëruar në vijim. Juve ju bënë
15 disa pyetje nga Prokuroria lidhur me këtë temë.

16 Për të qenë i qartë, ai e ka mbajtur këtë pozicion deri
17 në prill të '99-s, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Në intervistën që i keni dhënë Prokurorisë, keni qenë
20 shumë i qartë dhe thjesht dua t'ju rikujtoj atë çfarë keni
21 thënë lidhur me policinë ushtarake brenda zonës. Për
22 procesverbal kjo është Pjesa 5 e intervistës me ZPS-në që
23 është prova materiale P1355.5, në faqen 24:

24 "Për të qenë të qartë policia ushtarake në nivel zone,
25 ata nuk është se kanë pasur linjë të drejtpërdrejtë në

1 raportime me drejtorinë e policisë ushtarake?

2 "PË. Me sa di unë, sipas strukturës policia ushtarake e
3 zonës ka raportuar përpara komandantit të zonës.

4 "PY. Komandanti i zonës, a i ka raportuar policisë
5 ushtarake për -- ose me fjalë të tjera, komandanti i zonës, ai
6 i ka raportuar drejtorisë së policisë ushtarake?"

7 Dhe përgjigja që keni dhënë juve është:

8 "Jo, nuk i ka raportuar."

9 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. Pra, z. Limaj si drejtor i drejtorisë së ushtrisë --
12 policisë ushtarake nuk është lejuar që të nxjerrë ose të
13 lëshojë urdhra për njësitet e policisë ushtarake në nivel zone
14 ose nivel brigade në mënyrë të drejtpërdrejtë, a është e saktë
15 kjo, Dëshmitar?

16 PË. Është e saktë se tek policia ushtarake nëpër zona ose
17 brigada kanë qenë nën urdhrat e komandantëve të zonave dhe
18 brigadave. Dhe z. Limaj, ka mujt veç me i thirrë për trajnime,
19 për domethënë, ushtrime për këto njësi, dhe jo t'i japë
20 urdhër.

21 PY. Pra, roli i tij më tepër ka qenë i natyrës
22 administrative, në qoftë se mund të shprehem kështu, sa i
23 takon policisë ushtarake; domethënë nuk ka qenë thelbësor, nuk
24 ka qenë përmbajtësor, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po ka qenë edhe administrative edhe politike, politikat e

1 saj të zhvillimit të policisë dhe trajnimet.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju është treguar një dokument
3 tjetër. Do kërkoja që ky dokument të paraqitet në ekran. Mban
4 numrin P19 -- P9, - më falni - dhe ka të bëjë me listën e
5 policisë ushtarake dhe detyrat e saj. Domethënë rregullat e
6 përgjithshme të policisë ushtarake. Për procesverbal dokumenti
7 mban numrin ERN U000-3206.

8 Të presim derisa të shfaqet edhe dokumenti në shqip.

9 PY. Ju kujtohet që këtë dokument jua kanë treguar gjatë
10 intervistës tuaj, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Ju keni konfirmuar që këtë dokument nuk e keni parë më
13 herët edhe që nuk e njihni nënshkrimin.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal e keni thënë këtë
15 në intervistën me ZPS-në në Pjesën 6. Është prova P155 [Sipas
16 përkthimit], faqet 1 deri në 2 ose 1 deri në 3.

17 DËSHMITARI: Po.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim]

19 PY. Për të qenë të qartë ky është një dokument i cili nuk ka
20 vulë, nuk ka numër protokolli dhe nuk ka as datë, a është e
21 saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Nuk është urdhër, urdhëresë, udhëzim, apo jo? Nuk është
24 asnjë nga këto lloje materialesh apo dokumentesh; a është e
25 saktë kjo?

1 PË. Saktë. Kjo është një pjesë rregullore ku përcakton
2 detyrat e drejtorisë së policisë ushtarake. Në këtë kontekst
3 është ky dokument.

4 PY. Ju nuk e dini se kujt i është dërguar ky dokument; kur
5 është dërguar apo në qoftë se këtë dokument e ka marrë
6 ndonjëri që ka qenë pjesë e njësive të policisë ushtarake, a
7 është e saktë të thuhet kjo, Dëshmitar?

8 PË. E saktë është, nuk e kam parë këtë dhe nuk e di.

9 PY. Në rregull. Kam një pyetje që dua t'jua pyes, t'jua bëj,
10 dhe t'jua bëj vetëm një herë, në fakt. Dua që të shohim
11 paragrafin 9. Do doja që të rishikonim bashkë në versionin në
12 anglisht, paragrafin 9.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pra, edhe një herë është paragrafi
14 9, që është:

15 "Policia -- Sektori i Policisë Civile në Drejtorinë e
16 Policisë Ushtarake..."

17 A ka ekzistuar ky sektor, Dëshmitar?

18 PË. Jo, sa e di.

19 PY. Në rregull. Do të kalojmë në një temë të fundit dhe sa
20 për t'ju informuar kjo është tema e fundit që dua ta ezauroj
21 me juve; tema ka të bëjë me z. Kuqi, me Blerim Kuqin.

22 Z. Kuqi u largua nga Kosova në drejtim të Shqipërisë
23 rreth datës 10 shtator 1998. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Ju e keni parë atë në Shqipëri, sepse keni qenë edhe vetë

1 në Shqipëri, besoj rreth asaj kohe, a është kështu?

2 PË. Mbase kam dalë në Shqipëri.

3 PY. Kur keni folur me ZPS-në lidhur me këtë temë, ju keni
4 shpjeguar si më poshtë në intervistën tuaj.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal është në Pjesën
6 6, faqja 28.

7 PY. "... z. Blerim Kuqi në shtator, në fillim të shtatorit,
8 ishte komandanti i Brigadës 123 që u largua nga Kosova pa
9 njoftuar askënd, pa bërë organizmin ose pa zgjidhur çështjet
10 të njësitit të vet brenda Kosovës dhe pa kërkuar leje ose pa i
11 thënë askujt. Pra, u largua nga Kosova pa i thënë askujt dhe
12 pa kërkuar as leje dhe u largua nga Kosova në pikën më të
13 vështirë, ndërkohë që po zhvilloheshin luftimet. Ai u largua
14 nga Kosova pa kërkuar asnjë lloj leje nga askush."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë për ZPS-në, Dëshmitar?

16 PË. Po, ashtu është.

17 PY. Më vonë thoni, sa i takon z. Kuqi, për procesverbal keni
18 thënë këtë në faqen 29 dhe 30 në anglisht dhe 33 në shqip,
19 duke folur për arsyet që ka dhënë z. Kuqi për largimin e tij
20 ishin si më poshtë:

21 "... arsyeja ishte që ai kishte ndierë një lloj frike dhe
22 presioni nga popullata që popullata ishte larguar, ishte
23 tërhequr nga disa rajone, përshirë këtu edhe Pagarushën. Dhe
24 ndër arsyet e tjera që ai përmendi ishte që ai ishte larguar
25 për në Shqipëri për të marrë luftëtarë më profesionistë.

1 Këshillimi që i kisha dhënë atij ishte që këto janë arsye që
2 mund të ndodhin në çdo situatë lufte në botë; mund t'i ndodhin
3 dikujt që mund të ndihej i frikësuar dhe të ndiente presionin,
4 por për shkak të këtyre veprimeve ai duhej të ishte
5 zëvendësuar dhe duhej që të kishte njoftuar shtabin e zonës
6 operative dhe arsyet se pse do largohej nga Kosova."

7 A është e saktë të keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë.

9 PY. Pra, në atë kohë, sikurse na thatë, Musë Jashari ishte
10 komandanti i zonës së Pashtrikut, a është e saktë kjo?

11 PË. E saktë.

12 PY. Ai nuk mori autorizimin e z. Jashari përpara se sa të
13 largohej, sipas dëshmisë suaj. Domethënë, përpara se sa të
14 largohej për në Shqipëri nuk kërkoi leje nga z. Jashari,
15 kështu?

16 PË. E saktë.

17 PY. Ka dëshmi ose ne kemi dëgjuar që mendohej, mendohet që ai
18 të ketë marrë leje nga vartësit e tij. Megjithatë, si person
19 që keni përvojë në fushën ushtarake, juve besoj që pajtoheni
20 me mua që nuk kërkohet marrja e lejes nga vartësit që të kesh
21 mundësi që të largohesh në një situatë të tillë, apo jo,
22 Dëshmitar?

23 PË. Po, saktë. Duhet të kërkohet nga eprori.

24 PY. Z. Kuqi nuk kishte mundësi ose nuk ishte në gjendje që të
25 kontaktonte me juve që të merrte ose të kërkonte leje për t'u

1 larguar prej jush. Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi që z. Kuqi
2 është përpjekur për tri ditë për të kontaktuar.

3 Lidhur me këtë temë nga mesi i shtatorit të '98-s,
4 domethënë, në qoftë se ky informacion është i saktë, nuk ka
5 pasur mundësi, nuk ka qenë e mundur që z. Kuqi të ketë
6 komunikuar me juve në mënyrë të drejtpërdrejtë për t'ia u
7 kërkuar këtë leje për një temë shumë të rëndësishme. Është e
8 drejtë të thuhet kjo, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Mund të them drejtë; ta shpjegoj pse. Se bash në këtë
10 kohë [E pakuptueshme] në bazë të shpjegimit, në këtë kohë si
11 shtab, në pjesët e shtabit kemi qenë në zonën e Dukagjinit.
12 Është e vërtetë që nuk kemi qenë afër atij.

13 PY. Pra, fizikisht ju nuk ishit afër njëri-tjetrit, por ishte
14 e pamundur që ai të komunikonte me ju me mjete të informimit,
15 apo jo? Pra, edhe pse absolutisht shumë e rëndësishme për të
16 që të merrte lejen tuaj, nuk ishte kaq e thjeshtë që të
17 komunikonte ai me juve, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Po, me neve s'ka mund si shtab, por ka pas komandantin e
19 zonës që ka mund të komunikojë me të dhe prej tij merre leje
20 për të shkuar, jo prej nesh.

21 PY. Po. E dimë nga përgjigja juaj që ai nuk e bëri këtë gjë.
22 Dhe nuk e bëri as në lidhje me z. Jashari.

23 Si oficer ushtarak me shumë përvojë, ligjet sa i takon
24 dezertimit mund të jenë shumë të ashpra apo jo? Domethënë sa i
25 takon, për shembull, ndëshkimit që mund t'i nënshtrohet një

1 person i cili dezerton. Besoj që kështu ka qenë edhe në
2 ushtrinë, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Po, dezertimi në çdo ushtri është vepër penale e rëndë
4 edhe e cila ndëshkohet rëndë.

5 PY. A e dini se çfarë ndëshkimi ka pasur të parashikuar, për
6 shembull, në ushtrinë boshnjake? Domethënë, në qoftë se ndodh
7 dezertim në kohë konflikti, çfarë ndëshkimi ka pasur, në qoftë
8 se ju kujtohet?

9 PË. Për të vlerësuar ato se çfarë [E pakuptueshme] ka qenë
10 sektori juridik që është marrë me këtë çështje, dhe aty janë
11 përdorur dhe nenet të cilat janë ligje të luftës të asaj kohe
12 ose të atij shteti që e ka përcaktuar si me kushtetutë si me
13 ligje të parapara dhe sipas kësaj është dhënë verdikti i
14 dënimit ndaj një dezertori ose një ushtari i cili ka dezertuar
15 në atë kohë. Tash s'mund të them preciz se s'jam i kësaj fushe
16 për t'i ditur saktë se cilat janë ato.

17 PY. E kuptoj. Megjithatë nuk do ju befasonte të dini që
18 dënimi potencial që ishte i parashikuar sipas ligjit të
19 zbatueshëm jugosllav ishte me dënim burgimi nga 5 vjet deri në
20 dënim me vdekje. A do ishte kjo në pajtim me atë çfarë mendoni
21 ju, si e keni kuptuar ju këtë çështje?

22 PË. Po, është e saktë me ligjin e ish-Jugosllavinë, ashtu ka
23 qenë.

24 PY. Sa i takon lidhur me atë se çfarë i ka ndodhur
25 ekzaktësisht z. Kuqi, Prokurorja ju ka treguar një dokument që

1 ka titullin "Urdhëresë" dhe thotë që komandanti i zonës
2 operative të Pashtrikut, që është Komandanti Drini dhe
3 komandanti i Brigadës 123 që është Nexhmedin Kastrati, si dhe
4 Blerim Kuqi, "duhet të paraqiten në Shtabin e Përgjithshëm më
5 16 janar 1999". A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument,
6 Dëshmitar?

7 PË. Këtë dokument e kam parë në kohën përgatitore, por më
8 herët jo.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është prova P1105.

10 PY. Nuk është e nevojshme që të paraqitet në ekran për
11 momentin. Gjithsesi ju kujtohet që keni parë këtë urdhëresë
12 për këta tre individë që të paraqiteshin përpara Shtabit të
13 Përgjithshëm më datë 16 janar, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Po, këtë urdhëresë e kam parë, domethënë, në fazën
15 përgatitore, jo më herët.

16 PY. Në rregull. Dëshmia që i keni dhënë Trupit Gjykses është
17 që kur këta tre vetë mbërritën, domethënë, z. Drini, z.
18 Kastrati dhe z. Kuqi -- ju kërkoj ndjesë, ju shkuat me
19 komandant Drinin edhe Nexhmedin Kastratin për të diskutuar
20 çështje të lidhura. Kjo ka ndodhur në të njëjtën vend apo në
21 një vend tjetër, Dëshmitar?

22 PË. Në të njëjtën vend.

23 PY. Në rregull. Sa i takon asaj çfarë keni thënë juve
24 asokohe, për sa i përket kësaj situatë, ju keni shpjeguar sa
25 më poshtë lidhur me z. Kuqi. Është ajo çfarë është zbardhur në

1 dëshminë që keni dhënë që është faqja e transkriptit T17446:

2 "Kur ju keni qenë i pranishëm, kur Blerim -- keni qenë i
3 pranishëm kur Blerim Kuqi ka është paraqitur përpara
4 Shtabit?".

5 Përgjigja juaj është kjo:

6 "Po, ata erdhën bashkë, Blerim Kuqi, si dhe komandanti i
7 zonës dhe komandanti i brigadës.

8 "PY. A mund të na jepni emrat e këtyre personave sa për
9 të qenë të qartë?"

10 "PË. Komandanti i zonës ishte Ekrem Rexha dhe komandanti
11 i brigadës ishte Drini -- jo, Nexhmedin Kastrati.

12 "PË. Atëherë, me sa më kujtohet komandant Drini erdhi në
13 zyrën e drejtorisë. Ne kemi diskutuar për çështje operative.
14 Nexhmedin Kastrati shkoi në Brigadën 121 për të diskutuar
15 çështje të lidhura dhe Blerim Krasniqin -- Blerim Kuqi - më
16 falni - u la në komandë.

17 "PY. Kush ka qenë në komandë së bashku me Blerim Kuqin?"

18 "PË. Ka qenë Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Fatmir
19 Limaj."

20 Dhe në fund:

21 "PY. A ka pas një vendim për ndalimin e Blerim Kuqit?"

22 "PË. Po. Pas kësaj u mor vendimi që të ndalohej ai."

23 Për të qenë të qartë tani, ju keni qenë në një zyrë të
24 ndryshme nga z. Kuqi. Domethënë, së bashku me Drinin ti ke
25 qenë në zyrë të ndryshme nga vendi ku u la Blerim Kuqi, që

1 ishte një tjetër vend, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Kur thoni që u mor vendimi për ndalimin e z. Kuqi më pas,
4 ju nuk e dini se kush e ka nxjerrë këtë vendim, apo jo, kush e
5 ka marrë këtë vendim, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Po, në atë moment, jo.

7 PY. Nuk e dini as se kur është marrë konkretisht ky vendim,
8 apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Konkretisht atë ditë është marrë vendimi, po...

10 PY. Nëse do të shikojmë dokumentin, vendimin ose ta filloj
11 ndryshe:

12 Të shohim dokumentet konkrete që mendohet që të lidhen me
13 këtë çështje.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të shohim së pari dokumentin
15 P1106. Dhe më saktë është dokumenti SPOE00232828.

16 PY. Përsëri kjo pretendohet që të jetë një raport kundër të
17 akuzuarit Blerim Kuqi. Dua që të shikoni emrin në fund të
18 dokumentit. E di që është një dokument që nuk është
19 nënshkruar, por ju lutem shihni dokumentin -- emrin që është
20 në fund të dokumentit. Emri këtu është Fatmir Limaj në fund,
21 apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ngjashëm, në qoftë se mund të
24 shikojmë dokumentin P13444 [Sipas përkthimit]. Për
25 procesverbal kjo është SPOE0023 deri në 264 [Sipas

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts (Vazhdim)

Faqe 87

1 përkthimit]. Të kalojmë në faqen e dytë të këtij dokumenti.

2 PY. Pretendohet që data të jetë 4 qershor 1999. Sërish ky

3 është një dokument që pretendohet që të jetë nxjerrë nga

4 Prokurori i Policisë Ushtarake [Sipas përkthimit], z. Sejdiu.

5 Nuk e di në qoftë se e shikoni apo jo. Arben Sejdiu.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Le të kalojmë te fundi i faqes së

7 dytë në shqip në mënyrë të tillë që mund ta lexoni vetë,

8 Dëshmitar. Arben Sejdiu, Prokuror i Përgjithshëm Ushtarak.

9 DËSHMITARI: Po, e lexoj.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim]

11 PY. Pra, ajo çfarë po dua të them dhe dua ta konfirmoni që

12 nuk ka asgjë në këto dy dokumente që z. Selimi ka pas ndonjë

13 lidhje me vendimin për ta ndaluar z. Kuqi, apo jo? E

14 konfirmoni këtë, Dëshmitar?

15 PË. Po, qartë në këtë dokument.

16 PY. Ju nuk keni dëgjuar asnjëherë që z. Selimi të ketë

17 nxjerrë ndonjë urdhër specifik apo që të jetë përshirë në një

18 mënyrë konkrete në vendimin për ndalimin e z. Kuqi, a është e

19 saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Është e saktë; nuk kam parë asnjë urdhër.

21 PY. Faleminderit shumë, z. Zyrapi. Ky ishte edhe fundi i

22 pyetjeve të mia.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar

24 Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Ellis ose znj. Alagendra.

2 Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra:

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Mirëdita, z. Zyrapi.

5 PË. Mirëdita.

6 PY. Unë quhem Venkateswari Alagendra; do t'ju bëj pyetje në
7 emër të z. Jakup Krasniqi. Në rregull? Do t'jua them që në
8 fillim mund të ketë disa pyetje të cilat do të mendoni se mund
9 t'jua kenë bërë më përpara, por gjithsesi jam e detyruar që
10 t'ju bëj disa pyetje të ngjashme për të arritur aty ku dua të
11 arrij. Pra, mund të ketë njëfarë mbivendosjeje, por shpresoj
12 mos të jenë përsëritëse.

13 Midis 2005 dhe 2018 keni dhënë dëshmi në lëndë të
14 ndryshme përpara TPNJ-së dhe gjykatave të EULEX-it. Kështu
15 është?

16 PË. Po, saktë.

17 PY. Në ato lëndë, ju kanë thirrur si Dëshmitar, apo jo, z.
18 Zyrapi?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe nga 5 gushti i 2019 dhe 8 gushti 2019 ju ka marrë në
21 intervistë Prokuroria në këtë çështje gjyqësore -- në hetimet
22 e lidhura me këtë çështje gjyqësore, kështu është?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe kjo ka qenë hera e parë që jeni intervistuar si
25 person i dyshuar në një çështje gjyqësore, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Dëshiroj që të kalojmë tani tek e shkuara juaj, te
3 formimi juaj. Ju i keni konfirmuar z. Roberts dje se keni qenë
4 në Armatën Jugosllave, pra, në APJ-në në vitin '91, pra, nga -
5 më falni - nga viti 1981 deri në fillim të luftës në Bosnje në
6 '92, është kështu?

7 PË. Po, kështu është, saktë.

8 PY. Dhe keni arritur gradën e togerit në APJ, kështu?

9 PË. Po, saktë.

10 PËRKTHYESI: Korrigjimi i përkthyesit, jo grada e togerit,
11 e rreshterit.

12 DËSHMITARI: Më fal. Përsëriteni.

13 PËRKTHYESI: Korrigjimi i përkthyesit, jo toger, rreshter.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

15 PY. Në vitin '9 --

16 PË. Një përgjigje e mëhershme, ishte një gabim tjetër. Thotë
17 gradën e rreshterit. Në gradën e rreshterit nuk e kam pas në
18 '92, por e kam pas në përfundim, e kam pas të togerit, se e
19 kam kryer edhe shkollën e mesme, rreshter kur kam qenë, pastaj
20 akademinë dhe epror, oficer. Kështu që janë dallime këto.

21 PY. Faleminderit për sqarimin. Në vitin 1992 jeni kyçur në
22 ushtrinë boshnjake, kështu është?

23 PË. Saktë.

24 PY. Dhe keni qëndruar në ushtrinë boshnjake deri në janar të
25 '95-s?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Pra, deri në momentin që ju jeni kyçur në UÇK në maj të
3 '98-s, besoj se pajtoheni me mua nëse them që kishit 15 vjet
4 përvojë ushtarake, kështu është?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe kishit grada të larta në ushtri profesionale, kështu?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Kur keni hy në Kosovë thatë se jeni takuar me Sokol
9 Bashotën në Drenovc, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe siç e kuptonit, Sokol Bashota drejtonte drejtorinë
12 operative, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe ju vendosën në vartësi të tij?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Ai ju jepte urdhra dhe ju dërgonte të shkonit në vende të
17 ndryshme, kështu?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Në qershor, korrik dhe gusht të '98-s ju i raportonit
20 Sokol Bashotës, apo jo?

21 PË. Qershor deri në korrik, po.

22 PY. Ishte Sokol Bashota i cili ju tha se do të bëheshit
23 drejtor i drejtorisë operative, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Gjithashtu ai ju tha që t'i prezantoheshit zonave

1 operative dhe se ky do të ishte roli juaj prej atij momenti.

2 Kështu keni thënë, apo jo?

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Në atë kohë roli juaj ishte që të bënit propozime për
5 strukturën dhe emërimet?

6 PË. Po, të jepshja propozime për ato.

7 PY. Dhe kur jepshit propozime për ristrukturimin e njësive,
8 propozimet tuaja i shkonin Azem Sylës përmes Sokol Bashotës,
9 kështu?

10 PË. Me siguri. Unë kam dhënë deri te Sokol Bashota mund të
11 them. Për më tutje nuk di se si ka shku dhe si e ka mbart. Nuk
12 e di atë. Deri te Sokol Bashota, po.

13 PY. Dhe nëse mund të shohim -- është në Pjesën 2 të faqes 11
14 të dëshmisë suaj.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'i rikujtoj Avokates që ka
16 pas një sqarim për këtë në shënimin përgatitor.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. E tërheq këtë.

18 PY. E dini këtë në verën e vitit '98 që Azem Sylja ishte
19 komandant i përgjithshëm i UÇK-së, kështu?

20 PË. Po.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran
22 dokumentin me numër P847 ju lutem.

23 Të nderuar Gjykatës, ky dokument është ofruar në provën
24 gjyqësore nga Prokuroria përmes një mocioni për pranimin e
25 provave jo përmes dëshmisë gojore dhe është pranuar në

1 procesin gjyqësor me vendimin e Trupit Gjyqësor 1983 së bashku
2 me versionin në anglisht, por ne vërejmë se nuk ka një
3 përkthim të përditësuar në anglisht të këtij dokumenti dhe se
4 ky duket se është me numër SITF00243000 deri në 243003-ET
5 Revised 1.

6 Ju lutem që të nxjerrim këtë version të anglishtes. Pra,
7 do të kërkojmë, do të kërkonim që versioni i Rishikuar ET të
8 zëvendësojë versionin e mëparshëm që kemi -- që është pranuar
9 në provat gjyqësore.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtim?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëhet
14 zëvendësimi në fjalë. Pra, SITF243000 deri në 243003-ET
15 Revised 1; do të jetë pjesë e provës materiale me numër P847.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
17 Gjykatës.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, kjo është intervista e Zërit të Kosovës me z.
20 Syla, Azem Syla, me titull "UÇK-ja është krijesë e krahut
21 ushtarak të LPK-së". Dhe mban datën 2 tetor 1999.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do doja të kalojmë tani në
23 faqen që mbaron me numrat 001 [Sipas përkthimit], ju lutem.

24 PY. Në mes të faqes z. Syla i bëhet pyetje, se kush kanë qenë
25 anëtarët e parë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nuk e

1 di, a e shini?

2 PË. Cilën pjesë? Cilën pjesë, ju lutem?

3 PY. Është në të majtë. Duket se është në të majtë, pyetja e
4 dytë.

5 Ju lutem, lexojeni vetë një çast.

6 PË. Po e lexova.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Versioni në anglisht duhet që
8 të kalojë në faqen tjetër, ju lutem. Është faqja në vijim.

9 PY. Më thoni kur, pasi ta keni mbaruar së lexuari, z. Zyrapi,
10 apo e lexuat?

11 PË. E kam lexuar.

12 PY. Z. Sylja ka identifikuar këtu anëtarët e parë në këtë
13 përgjigje që ai ka dhënë intervistë, apo jo?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Dhe ai këtu nuk e ka përfshirë emrin e Jakup Krasniqit si
16 pjesë të Shtabit të Përgjithshëm të parë të UÇK-së, apo jo?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Dhe në lidhje me Sokol Bashotën, Azem Sylja ka thënë:

19 "... zëvendësi im, Sokol Bashota, u vendos në krye të
20 Shtabit të Përgjithshëm për të kryer të dyja këto detyra gjatë
21 kësaj periudhe gjer në dy takimet e Rambujesë".

22 E shihni këtë?

23 PË. Po, e lexoj.

24 PY. Dhe sipas Azem Sylës, Sokol Bashota e ka kryer këtë rol
25 si zëvendëskomandant deri në periudhën midis dy takime në

- 1 Francë kur Azem Syla u zëvendësua nga Sylejman Selimi - më
2 falni - si komandant i përgjithshëm, kështu?
3 PË. Po.
4 PY. Dëshiroj t'ju bëj tani disa pyetje për z. Jakup Krasniqi?
5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran
6 dokumentin 110500, ju lutem. I njëjti numër edhe në shqip.
7 PY. Ju jeni në dijeni, apo jo, Dëshmitar, se Jakup Krasniqi
8 ka qenë mësues i historisë nga viti '72 deri në vitin '81?
9 PË. Po, si prof -- ka punu si ...
10 PY. Dhe ka qenë i burgosur politik nga viti '81 deri në vitin
11 '91, apo jo?
12 PË. Kam dëgjuar për të, po.
13 PY. Dhe pas liritimit në '91 ishte sërish mësues i historisë
14 nga viti '91 deri në '94, apo jo?
15 PË. Me siguri, po.
16 PY. Dhe është përfshirë në sistem paralel arsimor i ngritur
17 nga, i ngritur në fillim të viteve '90, apo jo?
18 PË. Po.
19 PY. Dhe ditën e hënë na thatë se Jakup Krasniqi ishte anëtar
20 i LDK-së, besoj se ju kujtohet që e keni thënë kështu?
21 PË. Po, kam thënë.
22 PY. Nga viti '91 deri në vitin '98, ai ishte anëtar i
23 kryesisë së LDK-së dhe drejtues i degës së LDK-së në Drenas,
24 kështu?
25 PË. Po, saktë.

- 1 PY. Z. Zyrapi, Jakup Krasniqi nuk ka formim apo përvojë
2 ushtarake, apo jo?
- 3 PË. Jo.
- 4 PY. Dhe ju jeni takuar për herë të parë me Jakup Krasniqin në
5 qershor të '98-s kur është emëruar për herë të parë si
6 zëdhënës i UÇK-së, kështu?
- 7 PË. Po, saktë.
- 8 PY. Besoj se do t'ju kujtohet që asokohe kur keni hyrë në
9 Kosovë thujse askush në UÇK nuk njihej publikisht me emrin e
10 vërtetë, kështu, apo jo?
- 11 PË. Po, e saktë.
- 12 PY. Dhe pas -- pra, kur doli fillimisht në qershor të '98-s,
13 Jakup Krasniqi njihej publikisht si zëdhënës i UÇK-së me emër
14 dhe mbiemër, kështu?
- 15 PË. Po, saktë.
- 16 PY. Nuk ka përdorur asnjëherë, asnjë pseudonim, apo jo?
- 17 PË. Jo.
- 18 PY. Dhe dalja e Jakup Krasniqit si zëdhënës i UÇK-së ishte
19 shumë e rëndësishme për anëtarët e UÇK-së, por po kështu edhe
20 për vetë publikun shqiptar asokohe, apo jo?
- 21 PË. Po, saktë.
- 22 PY. Dhe një prej arsyeve për këtë është se publiku i
23 përgjithshëm kishte mundësi tashmë që t'i vendoste një emër
24 UÇK-së, pra, të kishte një lidhje me një emër mbiemër dhe UÇK-
25 në të një personi që ishte tashmë i mirënjohur në Kosovë,

1 sidomos në rajonin e Drenicës, apo jo?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Do të pajtoheshit po kështu me mua se dalja publike, e
4 pra, shpallja publikisht e z. Krasniqi si zëdhënës i UÇK-së me
5 emër dhe me mbiemër përbënte një rrezik të madh jo vetëm për
6 atë, por edhe për anëtarët e familjes së tij, apo jo?

7 PË. Po, saktë; po, ashtu.

8 PY. Dhe e ekspozonte atë dhe familjen e tij si cak për forcat
9 ushtarake dhe paraushtarake serbe, apo jo?

10 PË. Po, po, saktë.

11 PY. A jeni në dijeni z. Zyrapi, se në nëntor të '98-s familja
12 e z. Krasniqi u sulmua dhe Abedin Bujupi - siç u dëgjua -
13 është vrarë në rrugë jashtë shtëpisë ku jetonte familja e z.
14 Krasniqi?

15 PË. Po.

16 PY. Keni dëshmuar në rastin e Bellanicës përpara gjykatave të
17 EULEX-it, ju kujtohet besoj?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Në dëshminë që ju keni dhënë në atë rast, keni thënë se
20 vendndodhja se ku qëndronte zëdhënësi ishte në Berishë, Nekoc
21 dhe Negroc, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe këto ishin fshatra rreth bjeshkëve të Berishës ku
24 qëndronte z. Krasniqi deri në nëntor të '98-s, kështu është?

25 PË. Po.

- 1 PY. Dhe Negroci është fshati prej të cilit vjen vetë z.
- 2 Krasniqi, apo jo?
- 3 PË. Po, vendi i lindjes.
- 4 PY. Dhe familja e tij jetonte aty asokohe?
- 5 PË. Po.
- 6 PY. Ju personalisht e keni vizituar z. Krasniqi në shtëpinë e
- 7 tij në Negroc, apo jo?
- 8 PË. Po.
- 9 PY. Ju kanë prit mirë në mënyrë mikpritëse dhe ju kanë
- 10 shtruar dhe me hëngër në shtëpinë e z. Krasniqi dhe familjes
- 11 së tij?
- 12 PË. Po, sigurisht, po, se nuk kam qenë dhe vetë, është...
- 13 PY. Keni takuar Blerim Kuqin dhe Kurtesh Fondajn në Negroc në
- 14 qershor të '98-s, apo jo?
- 15 PË. Po, saktë.
- 16 PY. Dhe besoj se jeni në dijeni se edhe atyre iu është
- 17 shtruar bukë e janë prit me mikpritje nga familja e z.
- 18 Krasniqi dhe nga ai vetë, apo jo?
- 19 PË. Po, ashtu është.
- 20 PY. Do të keni qenë aty në korrik të '98-s kur është vrarë
- 21 Agim Qelaj?
- 22 PË. Agim Qelaj është vrarë në Rahovec në '98, po.
- 23 PY. Po ju a ishit në Negroc asokohe?
- 24 PË. Jo.
- 25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të nxjerrim në ekran

1 dokumentin me numër P00775, ju lutem. Ju lutem, të kalojmë në
2 faqen SPOE00068083, ju lutem.

3 PY. A e shihni në këtë faqe ku ju bëhet pyetja:

4 "Çfarë statusi e kishte Jakup Krasniqi ..."

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në pjesën
6 e poshtme të faqes, në të dyja këto.

7 PY. Këtu, diku nga pjesa e poshtme ju pyesin:

8 "Cili ishte roli i tij ..."

9 E shihni, z. Zyrapi?

10 PË. Po, po e lexova [E pakuptueshme].

11 PY. Ju i keni thënë Gjykatës në rastin e Bellanicës që detyra
12 e zëdhënësit ishte të informonte publikun për zhvillimet e
13 UÇK-së, kështu?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Dhe po kështu ju është bërë pyetja dhe është mu poshtë
16 kësaj:

17 "A do të thotë kjo që ai ka pasur rol edhe në lëshimin e
18 komunikatave?"

19 Dhe ju jeni përgjigjur:

20 "Jo, nuk kam dijeni për këtë."

21 Kjo është e saktë, apo jo?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Nga përvoja juaj ushtarake si oficer karriere, besoj se
24 pajtoheni me mua se detyrat e zëdhënësit janë të njëjta në çdo
25 ushtri, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Por në rastin e UÇK-së, kishte probleme. Fluksi i
3 informacionit ishte i vështirë, pra, qarkullimi i
4 informacionit, më saktë, ishte i vështirë që të kontrollohej,
5 kështu?

6 PË. Po, saktë.

7 PY. Dhe një prej problemeve asokohe ishte se shtabi lokal
8 Dukagjin, fjala bie, apo në Drenicë apo në Llap, shtabi lokal
9 fliste me mediat, kështu?

10 PË. Po, ka pas edhe aty.

11 PY. Dhe ishte e pamundur që zëdhënësi apo edhe Shtabi i
12 Përgjithshëm të ndiqte të gjitha këto media apo, pra, t'i
13 përcillte të gjitha këto media apo të reagonte ndaj
14 komunikatave apo intervistave të cilat dilnin në emër të UÇK-
15 së, apo jo?

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është pyetje spekulative, i
17 nderuar Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
19 kundërshtimi.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, besoj pajtoheni me mua se në çdo ushtri, për
22 çdo ushtri propaganda është e rëndësishme, apo jo? Sidomos në
23 një ushtri, për një ushtri vullnetare si rasti i UÇK-së, apo
24 jo?

25 PË. Po, saktë, për çdo ushtri.

1 PY. Dhe besoj se pajtoheni me mua nëse them se detyrat e
2 zëdhënësit përfshinin edhe përdorimin e propagandës në favor
3 të UÇK-së?

4 PË. Po, po është e saktë.

5 PY. Dhe regjimi serb asokohe e quante UÇK-në grup terrorist
6 dhe akuzonte në mënyrë të rreme UÇK-në se ajo kryente krime,
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Caku i propagandës së UÇK-së nuk ishte vetëm popullata
10 lokale shqiptare kur UÇK-ja asokohe kërkonte që të sigurate
11 dhe mbështetjen ndërkombëtare, apo jo?

12 PË. Po, saktë.

13 PY. Dhe për ta bërë këtë, zëdhënësi përpiqej që ta
14 portretizonte UÇK-në si një organizatë, si një forcë
15 çlirimtare, jo si një grup terrorist siç përpiqej ta
16 përshkruante Serbia, apo jo?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Dhe për të fituar mbështetjen e perëndimit, ju dhe Shtabi
19 i Përgjithshëm e kuptuat se UÇK-ja duhet që të shmangte çdo
20 veprim i cili mund ta karakterizojë si terrorist, apo jo?

21 PË. Po.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të nxjerrim në ekran
23 tashti dokumentin me numër DRS00098 deri në 99. E njëjta edhe
24 për versionin në shqip.

25 PY. Ky është një artikull në media me titull "I burgosuri për

1 rastin Panda: Agresori serb e kreu krimin e veshur me uniformë
2 të UÇK-së”.

3 Ky është një prej shembujve të këtyre veprimeve, apo jo
4 z. Zyrapi, në rastin e Pandës, që u mohua nga UÇK-ja asokohe
5 dhe vetëm shumë më vonë u konfirmua se ishte një operacion i
6 kryer nga -- në mënyrë të maskuar nga forcat armike, kështu?
7 PË. Po, saktë.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është
9 ora, shikoj orën, mos duhet të ndaloj këtu?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
11 tani pushimin e drekës.

12 Faleminderit për pjesëmarrjen sot. Dëshmitar, ju lutem,
13 mos bisedoni me askënd jashtë kësaj salle lidhur me dëshminë
14 që keni dhënë këtu në sallë. Do të rishihemi sërish këtu në
15 orën 14.30.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
18 këtë ndërprerjen e seancës deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

20 --- Seanca rifillon në orën 14.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutemi
22 silleni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, do
25 vazhdojmë me pyetjet e znj. Alagendra.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Zyrapi.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara
4 se të kaloj te pyetja e radhës, ne ju referuam dokumentit
5 DRS00098 përpara pushimit të drekës. Do kërkoja që këtë
6 dokument ta pranojmë si provë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
8 kundërshtim lidhur me këtë?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se
11 është dokument me dy faqe. Përfshini të dyja faqet, apo jo?

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
14 DRS00098 deri në 00099, plus përkthimit në shqip, pranohen si
15 prova.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i caktohet numri i
17 provës 4D00067 dhe do të klasifikohet si dokument publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
19 Është klasifikuar si publik? Ju kërkoj ndjesë.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, është publik.

21 PY. Z. Zyrapi, ju jeni në dijeni apo jo, që në korrik të
22 vitit 1998 ka pasur deklaratë publike se UÇK-ja ishte e
23 gatshme për të sulmuar Prishtinën. Siç e tha Avokatja?

24 PË. Mm -- kam dëgjuar [e pakuptueshme]

25 PY. UÇK-ja nuk e kishte asnjë kapacitet, nuk i kishte

1 kapacitetet për të sulmuar asnjë qytet, e aq më pak

2 Prishtinën. A jam e saktë lidhur me këtë, Dëshmitar?

3 PË. Po, saktë.

4 PY. Kjo ishte thjesht propagandë për ta përshkruar UÇK-në se

5 ishte më e organizuar se sa ç' ishte realisht. A është e saktë

6 kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të

9 paraqesë në ekran dokumentin që në fakt ka marrë numrin e

10 provës materiale P775. Ju lutem paraqiteni në ekran. Faqja

11 konkrete që do të doja të paraqesim në ekran është

12 SPOE0068083. Diku nga mesi i faqes.

13 PY. Në mes të faqes, Dëshmitar, ju bëhet pyetje lidhur me

14 rolin e Jakup Krasniqit gjatë vitit 1998 dhe 1999. Do t'ju

15 lexoj edhe çfarë keni thënë, Dëshmitar:

16 "Në fillim, nga muaji qershor deri në nëntor të vitit

17 1998 ai ka qenë zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

18 Nga nëntori, me ristrukturimin e Shtabit të Përgjithshëm të

19 UÇK-së, është emëruar zëvendës komandant i Shtabit të

20 Përgjithshëm për çështje politike."

21 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Në rregull. Ju i keni konfirmuar Prokurorit në seancën

24 përgatitore muajin e shkuar se me sa dini ju, komandantët --

25 zëvendëskomandantët janë caktuar në vitit 1998.

1 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Saktë.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj të paraqitet në ekran
4 dokumenti me numër 4D00011.

5 PY. Besoj ju kujtohet që këtë dokument ua tregoi Prokuroria
6 më herët, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Në rregull. Besoj se pajtoheni me mua, z. Zyrapi, që
9 tregon që gjatë ristrukturimit ka pasur dy zëvendëskomandantë.
10 A pajtoheni me mua? Një ka qenë zëvendëskomandant për
11 operativin dhe tjetri për logjistikën, për mbështetjen. A
12 Është kështu?

13 PË. Nuk thom në këtë kuptim. Nuk është kjo mbështetja
14 logjistike, se për logjistikë është komandant -- ka qenë
15 veçantë. Çfarë pjesë e -- është drejtoria për logjistikë, dhe
16 kemi pas baza të logjistikës. Kur thuhet "mbështetje",
17 mbështetje në aspektin politik por edhe në aspekte të tjera të
18 cilat mbështet ky zëvendëskomandant.

19 PY. Do e shtjellojmë këtë çështje pak më vonë. Megjithatë,
20 për momentin, sipas këtij dokumenti, i takon që ka një
21 zëvendëskomandant për operativën dhe një zëvendëskomandant për
22 mbështetjen, mbështetur në këto shënime. A është kështu? e
23 kuptoj që thatë që nuk ka mbështetje, domethënë, nuk ka të
24 bëjë domosdoshmërisht me logjistikën, e kuptoj këtë gjë. A
25 është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po. Operacionet kryesore --

2 PY. Po, vazhdoni, më falni që ju ndërpreva.

3 PË. Po, për operacionet dhe mbështetjen.

4 PY. Jakup Krasniqi është caktuar si zëvendëskomandanti për
5 mbështetjen. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Ndërkohë që Sokol Bashota ka qenë zëvendëskomandant për
8 operacionet. Kështu? Për operativën --

9 PË. Për operacionet, jo për operativën. Për operacionet.

10 PY. Po, për operacionet.

11 PË. Në periudhën nga qershori dhe shtatori i vitit 1998, si
12 anëtar dhe pastaj si shef i operacioneve, ju keni shkuar nëpër
13 zona dhe shtabet lokale për të ndihmuar komandantët për të
14 qenë të gatshëm dhe për të ndihmuar për të qenë të gatshëm për
15 nivelin e përgjithshëm të organizimit. A është e saktë kjo,
16 Dëshmitar?

17 PY. Po, saktë.

18 PË. Me ekspertizën, përvojën tuaj ushtarake, ju i keni
19 ndihmuar ata që të ndërtojnë një strukturë më të mirë dhe ta
20 zhvillonin më tepër mënyrën e funksionimit dhe organizimit të
21 tyre. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PY. Saktë.

23 PË. Një javë më përpara i thatë z. Misetiq që kur keni viset
24 -- vizituar shtabet lokale, ju nuk keni pasur autoritetin e
25 komandantit, por kishit autoritetin e një oficeri me

1 objektivin kryesor për t'i ndihmuar ata për t'u bërë më të
2 aftë, për t'i organizuar dhe për t'i ndihmuar në përgjithësi
3 ata. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PY. Po, e saktë.

5 PË. Këtë e keni bërë mbështetur në udhëzimet e drejtorisë së
6 operativës, apo jo, Dëshmitar?

7 PY. Po.

8 PY. Është e vërtetë, apo jo, z. Zyrapi, se si ish-oficer
9 ushtarak, komandantët e zonës dhe komandantët lokalë u janë
10 drejtuar juve lidhur me këshilla dhe udhëzime për çështje të
11 strukturës, organizimit dhe çështje të tjera ushtarake? A
12 është kështu?

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Gjatë seancës përgatitore, dhe pyetja që ju ka bërë
15 Prokuroria përpara një jave, ju tregua një dokument tjetër.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë që të
17 paraqisni provën materiale P01383.

18 PY. A ju kujtohet që ua kanë treguar këtë dokument Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Ky është një raport i panëshkruar i komandantit të zonës
21 së Dukagjinit që mban datën 28 korrik të vitit 1998. A është e
22 saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po, saktë.

24 PY. Juve nuk ju kujtohej që ta keni marrë këtë dokument
25 atëherë, asokohe, por i thatë Prokurorisë që je -- e ke -- e

1 keni vizituar zonën e Dukagjinit përpara kësaj date. A është e
2 saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po, e saktë.

4 PY. Keni thënë gjithashtu që ju keni ndihmuar Ramush

5 Haradinajn që të ndërtonte brigadat e sulmit dhe të

6 organizonte komandën. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

7 PË. E kam cek që e kam ndihmuar për strukturimin e brigadave,

8 po dhe -- se komanda veç ka qenë dhe e organizime edhe ma

9 herët.

10 PY. Në rregull. Sipas këtij dokumenti, Ramush Haradinaj ju ka

11 informuar juve lidhur me progresin për zbatimin e asaj çfarë

12 ju keni diskutuar bashkërisht. A është e vërtetë kjo,

13 Dëshmitar?

14 PË. Unë kah kam qenë atje, po, por në këdo moment, jo. Kësi

15 raporte nuk kam marrë.

16 PY. Po, por në qoftë se do lexosh përmbajtjen e dokumentit

17 thuhet në dokument që ai në fakte të ka informuar ty --

18 megjithatë ta bëjmë kështu më mirë. Ju lutem hidhini një sy

19 dokumentit. Lexojeni me vete. Pra

20 "... vazhdon me brigadat e mësymjes të cilat janë

21 krijuar. Pastaj në prapavijë janë formuar tre brigada sulmuese

22 të cilat janë inauguruar dhe kanë dhënë betimin."

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokate,

24 përderisa i thatë lexoni dokumentin, duhet t'i jepni mundësinë

25 dëshmitarit që ta lexojë vetë dokumentin.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Ju kërkoj ndjesë.

2 DËSHMITARI: Po.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Megjithëse dokumenti i është drejtuar Shtabit të
5 Përgjithshëm, në thelb është një dokument që ju është drejtuar
6 juve, si drejtor i drejtorisë operative, lidhur me progresin e
7 asaj çfarë ishte zbatuar në atë kohë. A është e vërtetë kjo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Po, është e saktë që i drejtohet drejtorisë operative me
10 -- unë jam informu, por nuk është që kam mbërritur. Unë [E
11 pakuptueshme] për herë të parë e kam pa këtu. Sa e sheh -- i
12 përket disa informacioneve kur kam qenë atjena, kemi bisedu me
13 komandantin e zonës për brigada, për zhvillimet e saj e të
14 gjitha.

15 Por si raport, nuk e kam marrë. Të jemi -- [E
16 pakuptueshme] shkurt, se në këtë periudhë se në këtë periudhë
17 ka pas edhe luftime. Ne nuk kemi mujt as raporte të marrim as
18 të shkruajmë raporte [E pakuptueshme]. Po folim për shtabin.

19 PY. Në rregull. Tani do të kaloj te zona e Llapit. I keni
20 thënë Prokurorisë që herën e parë kur keni shkuar në Llap ka
21 qenë pas vrasjes së Agim Çelës, ku jeni takuar me Rustem
22 Mustafën, që ka qenë komandant zone, dhe zëvendësin e tij,
23 Kadri Kastratin. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar? A të
24 kujtohet ta kesh thënë këtë?

25 PË. Po.

1 PY. Në atë rast keni pasur mundësi që të vlerësoni dhe të
2 shihni nivelin e organizimit të kësaj zone. A është e vërtetë
3 kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. Në këto biseda, këto biseda i keni organizuar me Kadri
6 Kastratin, sepse si puna juaj, edhe ai vetë kishte përvojë si
7 oficer ushtarak. Domethënë, ishte më e thjeshtë që të
8 diskutohej me të lidhur me këtë çështje. A është e vërtetë
9 kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. Në atë rast keni marrë edhe disa kërkesa lidhur me armë
12 dhe pajisje teknike. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Z. Zyrapi, ju e dini që z. Mustafa ka dhënë dëshmi
15 përpara këtij Trupi Gjykses, kështu?

16 PË. Po, kam dëgju.

17 PY. A e keni ndjekur dëshminë e tij?

18 PË. Jo, krejt.

19 PY. Në rregull. Z. Mustafa ka pranuar se ai ka parë persona
20 si puna juaj dhe z. Kadri Kastrati, para -- si persona me
21 përvojë ushtarake, për sa i takon ndihmës. Domethënë, ju ka
22 parë me vlerësim persona si puna juaj dhe z. Kastrati, sa i
23 takon ndihmës dhe përpjekjeve për ndërtimin e zonës. A jeni në
24 dijeni të kësaj, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Dëshmitar, ai ju kujtohet që keni dhënë dëshmi përpara
2 TPNJ-së, çështja Limaj, që në mes të korrikut të vitit 1998
3 keni shkuar në Dukagjin me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe
4 Jakup Krasniqin e persona të tjerë. A ju kujtohet kjo,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po, saktë.

7 PY. Në atë kohë, Ramush Haradinaj ishte komandanti i zonës,
8 apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Në atë takim, Ramush Haradinaj ju informoi lidhur me
11 strukturën e shtabit lokal në atë kohë. A është e vërtetë kjo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Ai ju tha, gjithashtu, që Nazmi Brahimaj ishte
15 zëvendëskomandant dhe Sali Veseli ishte shefi i shtabit. A
16 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Pozicionet e shtabit rajonal të Dukagjinit kanë qenë të
19 vendosur përpara kësaj vizite në Dukagjin, dhe këto pozicione
20 janë caktuar në një mbledhje më 23 qershor të vitit 1998, apo
21 jo, Dëshmitar?

22 PË. Po, saktë.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do kërkoja të paraqitej në
24 ekran prova P1364 [Sipas përkthimit].

25 PY. Ju lutem, a mund të lexoni dokumentin me mënd, Dëshmitar?

1 DËSHMITARI: Po.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

3 PY. Besoj se pajtoheni me mua se mbështetur në këtë dokument,
4 rezulton që anëtarët e shtabit operativ janë të pranishëm në
5 këtë takim dhe që ata kanë emëruar persona në pozicione të
6 tilla si komandantë, zëvendëskomandantë, shef shtabi, le --
7 asistent logjistik për zbulim-kundërzbulimin, dhe të gjithë
8 ata kanë votuar, domethënë janë bërë propozimet dhe më pas
9 është votuar nga shtabi lokal. A pajtoheni me mua lidhur me sa
10 thashë më sipër, Dëshmitar?

11 PË. Po, saktë.

12 PY. Procesverbal për takimin thotë që takimi filloi me biseda
13 ose kontribute të personave që ishin në pozicione kyçe. A
14 pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, rezulton që nuk ishte Shtabi i Përgjithshëm që
17 vendoste se kush do ishte komandanti i zonës, kështu i takon.
18 Sepse Ramushi ishte zgjedhur si komandant zone, apo jo,
19 Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me vizitën e Shtabit të
22 Përgjithshëm në Dukagjin pas ndryshimit të komandës.

23 Dëshmitar, ju nuk keni nga ta dini, ose nuk e dini se si
24 Shtabi i Përgjithshëm ishte i informuar për ndryshimet e
25 komandës. A është e saktë të thuhet kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po. Po, e saktë.

2 PY. Ju shkuat në Dukagjin dhe u takuat atje me Tahir Zemajn
3 dhe me Haradinajn. A është e saktë kjo?

4 PË. Më fal, tash cilin takim po më bën -- në cilin takim jeni
5 tu fol?

6 PY. Për takimin e dytë.

7 PË. Mirë, po takimin e dytë.

8 PY. Jakup Krasiqi nuk ka qenë i pranishëm në atë vizitë me
9 juve, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Jo në takimin e dytë.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju kërkoj që të shikoni
12 pjesën e tretë të intervistës që i keni dhënë ZPS-së në faqen
13 27. Për sekretarinë, është prova P1355.3.

14 PY. Juve ju bëhet pyetja:

15 "A e dini se kush e ka kontaktuar Azem Sylën?"

16 Dhe përgjigja që jepni ju në rreshtat 11 deri në 12 është
17 qartazi:

18 "Jo."

19 A është e saktë kjo, Dëshmitar? Dhe pastaj ju shtoni:

20 "Mendoj që ka qenë Jakup Krasniqi personi që ishte në
21 kontakt me Azim -- Azem Sylën."

22 Këtu të paktën thënë -- kështu thuhet. A pajtoheni me
23 këtë, Dëshmitar?

24 PË. Pajtohena plotësisht.

25 PY. Megjithatë, kur iu bë kjo pyetje në mënyrë të

1 drejtpërdrejtë në qoftë se ju e dini, ju jeni përgjigjur që
2 nuk e dinit se kush e ka kontaktuar Azem Sylën. Do ta ndaj në
3 dy pjesë, Dëshmitar, që ta bëj më të qartë pyetjen. Ju nuk e
4 dinit se kush ka kontakt me Azem Sylën? A është kështu, pra
5 që nuk e dini, Dëshmitar?

6 PË. Po, saktë.

7 PY. Në rregull. Kur mendo -- kur thoni që mendoj që "ka qenë
8 Jakup Krasniqi që ka qenë në kontakt me të", domethënë, ju
9 thjesht keni hamendësuar këtu. Nuk është se e keni dit me
10 siguri, apo jo?

11 PË. Varet për cilën periudhë e keni, në vitin 1998 a 1999?

12 PY. Në periudhën përreth ndryshimit të komandës, diku nga
13 viti 1998.

14 PË. Po me ndryshimin e komandës, normalisht zëvendësi
15 komandanti duhet të ketë kontakt me komandantin dhe mund të --
16 të mbajë ato kontakte. Si i kanë mbajt, unë nuk e di.

17 PY. Jo, jo, po flas për zinxhirin e komandës në atë zonë, në
18 zonën e Dukagjinit.

19 PË. Ah, në zonën e Dukagjinit. Dukagjini -- zona e Dukagjini
20 është diçka tjetër.

21 PY. Po, për atë po flas, për vitin 1998, domethënë.

22 PË. Në -- po --

23 PY. Ose më herët.

24 PË. Jo, jo.

25 PY. Atëherë po thjesht po shikoj fjalën që keni përdorur në

1 intervistën me ZPS-në, Dëshmitar. Ju thoni në intervistën tuaj
2 që:

3 "Unë mendoj se ka qenë Jakup Krasniqi personi që ka qenë
4 në kontakt me Azem Sylën."

5 Nga mënyra se si e keni -- është formuluar këtu, i takon
6 që ju nuk keni qenë njëqind për qind i sigurt lidhur me këtë,
7 apo jo, Dëshmitar? A është e saktë kjo apo jo?

8 PË. Për atë periudhë po. Q'ashtu është.

9 PY. Keni thënë gjithashtu që z. Krasniqi ka nënshkruar një
10 urdhër për të caktuar komandantin e zonës në emër të Azem
11 Sylës. Z. Krasniqi nuk ka qenë i pranishëm në vizitën në
12 Dukagjin. A pajoheni me mua lidhur me këtë, Dëshmitar? Na e
13 thatë në fakt, pak më herët që nuk ka qenë pjesë e vizitës që
14 keni bërë në Dukagjin. A është kështu?

15 PË. Saktë.

16 PY. Në atë kohë Jakup Krasniqi ka qenë thjesht zëdhënësi.
17 Asgjë tjetër. A është e vërtetë kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Ju nuk - nuk - nuk ju është treguar një urdhër me shkrim
20 ku z. Krasniqi emëronte, emëronte z. Haradinaj. A mund ta
21 konfirmoni këtë që nuk keni parë një urdhër me shkrim lidhur
22 me këtë, Dëshmitar?

23 PË. Po, saktë është.

24 PY. As nuk ju është treguar nga Prokuroria një dokument i
25 tillë i nënshkruar nga z. Krasniqi, apo jo, Dëshmitar.

1 PË. Po, drejtë.

2 PY. Tani do të kaloj te tema e Cen Deskut dhe Jakup Kra --
3 dhe Cen Deskut dhe Jakup Krasniqit. Ju keni qenë jashtë Kosove
4 kur Cen Desku dhe Jakup Kastrati janë arrestuar me 30 tetor të
5 vitit 1998, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Po, saktë.

7 PY. Në pjesën 3 të intervistës --

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Së pari do ju pyes në qoftë se
9 ju kujtohet. Në qoftë se jo, pastaj do ju tregojmë dokumentin
10 përkatës.

11 PY. Në faqen 3, faqen 34 -- në pjesën 3, faqja 34-35 të
12 intervistës së vitit 19 -- 2019, ju keni thënë që keni dëgjuar
13 lidhur me arrestimin e tyre, kur ata janë liruar. A është e
14 saktë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po, saktë.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund të paraqisni në ekran
17 provën P00093. Në minutën 00:00. Thjesht dua që të jetë e
18 ngrirë pjesa e parë e videos, domethënë përpara se të fillojë
19 transmetimi i videos, dua atë sekuencën e parë të ngrirë në
20 ekran. Nuk mendoj që është videoja e duhur kjo. Edhe një herë
21 t'ju jap numrin e referencës. Është P00093. Në qoftë se ju
22 ndihmoj më tepër që dokumenti që përndryshe identifikohet si
23 dokumenti me numër 061427-12.

24 PY. Për informimin tuaj, z. Zyrapi, kjo është video e lirimit
25 të Xhim [Sipas përkthimit] Deskut dhe të Jakup Kastratit. Këtë

- 1 personin që është në ekran, a e njihni? Thjesht na e
2 konfirmoni se kush është ky personi që duket në ekran.
- 3 PË. Po. Muj -- Sokol Bashota [E pakuptueshme].
- 4 PY. Dhe Sokol Bashota përfaqësonte UÇK-ndonjëherë në këtë
5 lirim, gjatë këtij lirimi, apo jo?
- 6 PË. Si po shifet, po.
- 7 PY. Ju asokohe nuk keni qenë në Kosovë -- më falni, në
8 momentin e arrestimit, nuk keni qenë në Kosovë. pra ju nuk
9 keni dijeni se kush e ka dhënë urdhrin për arrestimin. A është
10 kështu?
- 11 PË. Po, saktë.
- 12 PY. Dhe nuk e dini as arsyen pse janë arrestuar, apo jo?
- 13 PË. Jo.
- 14 PY. Dhe në vitin 2019 i keni thënë Prokurorisë, dhe kjo është
15 në Pjesën 3, faqe 35:
- 16 "Nuk e di se kush mund të ketë dhënë urdhrin. Nëse ka
17 qenë komandanti apo zëvendëskomandanti. Nuk e di."
- 18 Këtë keni thënë në intervistë. Pra duket qartë që
19 Prokurorisë e po i thoshit se nuk e dinit se kush e kishte
20 dhënë urdhrin, apo jo?
- 21 PË. Po, s --
- 22 PY. Pra ju thatë "a ka qenë komandanti a zëvendëskomandanti",
23 edhe këtu thjesht po - po e merrnit me mend. Nuk është se e
24 dinit, apo jo?
- 25 PË. Po, sigurisht.

1 PY. Gjithashtu në faqen 35 i keni thënë Prokurorisë se në
2 nivel të Shtabit të Përgjithshëm, pra në nivel të lartë, është
3 lëshuar -- po të ishte lëshuar përmes atij organi, do të
4 kishte qenë komandanti apo zëvendëskomandanti, po të kishte
5 ardhur puna aty."

6 Thoni, këtë e keni thënë në deklaratën tuaj, pra kur
7 thoni: "Po të kishte ardhur puna aty" do të thotë që ju nuk e
8 dinit, apo jo?

9 PË. Po, nuk e kam dit, ose është pyetur në aspekte të tillë.
10 Me rregulla duhet të ishte në atë mënyrë, ose komandanti ose
11 zëvendësi.

12 PY. Po për të qenë të qartë, z. Zyrapi, ju nuk e dini se
13 kush e ka dhënë urdhrin për arrestimin dhe përse janë
14 arrestuar, apo jo?

15 PË. Isha shumë i qartë çdo herë. Jo, nuk e kam ditur.

16 PY. Dhe asokohe, një prej problemeve ishte se ju merrnit
17 informacione se kishte incidente edhe në territore të tjera,
18 ku ushtarët po arrestonin civilë, konfiskonin materiale, dhe
19 nuk po silleshin siç duhet. Kështu është?

20 PË. Po. Pastaj, po. Është.

21 PY. E këto raste të sjelljes së -- të papërshtatshme të
22 ushtarëve të UÇK-së, siç pretendohet, nuk ishte me urdhër të
23 komandantëve të zonave apo të Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

24 PË. Po, qartë është.

25 PY. Prandaj dhe ju lëshuat një urdhër, për ta thënë siç e

1 keni thënë ju, që të gjithëve që të mbulonin gjithçka se si
2 duhej që të silleshin. Këto -- këto janë fjalët tuaja, apo jo?

3 PË. Po, qartë.

4 PY. Siç e kemi parë më herët, në dokumentin që ua tregova më
5 herët në P0 -- P775, Jakup Krasniqi është emëruar
6 zëvendëskomandant për mbështetjen më 12 nëntor të vitit 1998,
7 gjatë mbledhjes për ristrukturimin. Kështu është?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe me rolin e tij si zëdhënës, ishte që të informonte
10 publikun për zhvillimet e UÇK-së.

11 PË. Po, edhe atë detyrë e ka pas.

12 PY. Dhe në momentin e arrestimit -- në momentin e arrestimit
13 të Cen Deskut dhe të Jakup Kasttratit, z. Krasniqi ka qenë
14 zëdhënës, apo jo?

15 PË. Po, deri atëherë nuk ka qenë ristrukturimi. Domethënë,
16 ristrukturimi është bërë më vonë, domethënë. Po.

17 PY. A jeni gjithashtu në dijeni, Dëshmitar, që z. Shaun Bryne
18 nga KDOM-i amerikan në Kosovë, ka dhënë dëshmi se ai po -- ai
19 kishte të bënte me -- pra është marrë, le të themi me Sokol
20 Bashotën për lirimin e Cen Deskut dhe Jakup Kasttratit? Jeni në
21 dijeni për këtë?

22 PË. Më herët nuk e kam dit, gjatë asaj periudhe, por më vonë
23 po, kemi dëgjuar gjatë dëshmive.

24 PY. Në rregull. Tani, në Pjesën 3, faqe 8 të intervistës suaj
25 të vitit 2019, keni thënë se pas luftimeve në Rahovec, kemi

1 hetuar me njësitë lokale. A është e saktë kjo? Është - kemi
2 kaluar tani në Rahovec. Është në Pjesën e 3, faqja 5 e
3 intervistës suaj.

4 PË. Lutem pak më qartë, dhe po dalim në Rahovec. Po, po çka
5 është pyetja?

6 PY. Në Rahovec.

7 PË. Mirë.

8 PY. Kërkoj ndjesë. Pra kemi kaluar tani në Rahovec dhe ju
9 thatë që pas het -- luftimeve në Rahovec, keni bërë hetime me
10 njësitë lokale. Kështu?

11 PË. S -- nuk po e kuptoj pyetjen, qysh me thanë hetimet. Çka
12 apet?

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund t'ju kaloj te Pjesa e 3 e
14 intervistës suaj, faqe 6. Fillon te faqja 5 dhe vazhdon në
15 faqen 6, besoj.

16 PY. Pas ngjarjeve në Rahovec, Dëshmitar, ju keni shkuar dhe
17 keni folur, keni biseduar me shtabet lokale. E kam të saktë?

18 PË. Po, edhe gjatë luftimeve, unë kam bisedu me shtabet
19 lokale. Se pa ta s'kam mujt të organizoj edhe mbrojtjen e --
20 frontin e mbrojtjes prej Rahovecit në drejtim të Malishevës.

21 Në qoftë se e keni kë -- për këtë çështje. Çka ka ndodh në
22 Rahovec.

23 PY. Patjetër.

24 PË. Apo ndonjë pyetje tjetër se nuk e kuptoj se tash edhe
25 hetimi ka shumë kuptime. Po.

1 PY. Jo e kam fjalën që keni pyetur. Sokol Bashota ishte një
2 prej tyre që ju ka dhënë informacione kur keni mbërritur aty,
3 apo jo?

4 PË. Po. Po.

5 PY. Dhe ju thatë që nuk e keni raportuar informacionin që
6 keni marrë në Rahovec te të tjerët në Shtabin e Përgjithshëm
7 asokohe, kështu?

8 PË. Është e saktë për anëtarët e Shtabit, kanë qenë aty kur
9 kemi marrë informacion nga shtabet lokale, dhe e kanë ditur
10 një pjesë e madhe e tyre se çfarë ka ndodh. Kështu që s'kemi
11 pas kujt t'i raportojmë më tutje.

12 PY. Por nuk keni mbajtur një dokumentim me shkrim të
13 informacionit që ju keni marrë asokohe, apo jo?

14 PË. Jo, e sigurt. Në atë kohë s'kam pas mundësi as për vete
15 me u kujdes, e lere më për shkrimet e raporteve, në atë
16 ofensiva dhe në ato momente.

17 PY. Dhe në faqen 6 të intervistës suaj, nëse mund ta lexoj ju
18 është bërë pyetja:

19 "Shtabi i Përgjithshëm a ka marrë më vonë ndonjë
20 raportim, si të thuash më pas në kohë, se çfarë kishte ndodhur
21 në Rahovec dhe ju jeni përgjigjur

22 "Nga ajo që di, jo, sepse na duhej që të merreshim edhe
23 me sulme të tjera, dhe duhej të zgjidhnim edhe probleme të
24 tjera në territore të tjera."

25 Ju kujtohet që keni thënë kështu?

1 PË. Po, saktë, ashtu është.

2 PY. Dhe këtu vijoni të thoni që informacioni që ju keni i
3 është dhënë dhe Sokol Bashotës, ashtu sikurse edhe juve.
4 Kështu? Nga shtabi lokal.

5 PË. Po.

6 PY. Ju vetë nuk e dinit nëse Sokol Bashota e kishte informuar
7 dikë tjetër lidhur me informacionin që ai kishte marrë. Këtë
8 nuk keni nga ta dini?

9 PË. Jo.

10 PY. Në Pjesën 2 të intervistës suaj në vitin 2019 - jam në
11 Pjesën 2, faqen 24, për Trupin Gjykues, ju keni thënë që ishte
12 përgjegjësia e komandantëve të zonave që të informonin
13 zëdhënësin Jakup Krasniqin lidhur me suksesin e sulmeve.

14 Do t'ju them kështu, z. Zyrapi, se komandantët e zonave
15 nuk i kanë raportuar Jakup Krasniqit. Do të pajtoheshit me mua
16 në këtë?

17 PË. Edhe një herë pyetjen edhe -- se nuk e kuptova mirë çfarë
18 --

19 PY. Në intervistën tuaj të vitit 2019 i keni thënë ZPS-së se
20 komandantët e zonave kishin për përgjegjësi që të informonin
21 zëdhënësin Jakup Krasniqin lidhur me suksesin e sulmeve.
22 Kështu? Tani unë do të thosha kështu, që komandantë zonave nuk
23 i kanë raportuar Jakup Krasniqit. A pajtoheni me mua nëse do
24 të thosha kështu?

25 PË. Jo, raportet janë bërë nga komandantët e zonave, janë

1 dërguar. Edhe kur kanë qenë në takime, kanë raportuar edhe
2 është raportuar zëdhënësi.

3 PY. E kam fjalën për periudhën e verës së vitit 1998, kur
4 Jakup Krasniqi ishte ende zëdhënës. Në atë periudhë jam, z.
5 Zyrapi.

6 PË. Mirë, mirë, tash e kuptoj se duhet data në qoftë se
7 ceken, atëherë e di periudha cila është. Po, verës -- në atë
8 kohë nuk ka qenë zëvendës. Nuk ka qenë zëdhënës.

9 PY. [Nuk ka përkthim].

10 PY. Pra ka qenë zëdhënës asokohe.

11 PË. Po, qartë.

12 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se ka një gabim në
14 transkriptim, të nderuar Gjykatës. Ju lutem që ta korrigjojmë.
15 Zoti -- ai tha se ishte zëdhënës asokohe, jo zëvendës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund -- mund
17 t'ia bëni pyetjen sërish.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull.

19 PY. Asokohe, z. Zyrapi, z. Jakup Krasniqi ka qenë zëdhënës,
20 jo zëvendëskomandant. Kështu?

21 PË. Po, kështu është.

22 PY. Pra, komandantët e zonave nuk i raportonit - nuk i
23 raportonin zëdhënësit Jakup Krasniqi. Kështu?

24 PË. Po, kështu është.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dua të kalojmë tani në faqen

1 24, Pjesa 2, të intervistës suaj.

2 PY. Ju është bërë pyetja në qoftë se do të kishte qenë
3 përgjegjësia e komandantëve të zonave për t'ia komunikuar
4 rezultatet Shtabit të Përgjithshëm dhe këtë asokohe këtë do ta
5 kishin bërë përmes zëdhënësit. Përgjigja juaj është:

6 "Kështu duhet të ketë qenë se asokohe zonat nuk mund të
7 komunikonin mes -- me shtabin."

8 Po besoj se këtu bëhet fjalë për një gabim, apo jo?

9 PË. Në atë kohë është e vërtetë që s'ka mujt shtabi --
10 sidomos në kohën e verës së vitit 1998, kont -- të kemi
11 kontakte ose të raportohet në atë mënyrë. Si gjithnjë edhe
12 shtabi ka qenë i shpërndarë në të gjitha zonat edhe nuk ka
13 qenë i koncentrum në një vend për me mujt me marrë raportet
14 ose për t'i raportuar dikush.

15 PY. Pyetja ime më shumë përqendrohet te ajo që ju keni thënë
16 se duhet të ketë qenë kështu, në kuptimin që komandantët e
17 zonave raportonin përmes zëdhënësit. Mirëpo kjo nuk ka ndodhur
18 kështu, apo jo? Asokohe?

19 PË. Qartë. Po.

20 PY. Do të kaloj tani tek ajo që ju thatë lidhur me hetimet,
21 kur ju kanë intervistuar Prokuroria. Është në Pjesën 3, faqja
22 13 të intervistës suaj. Edhe këtu po flasim për këtë periudhë.
23 Dakord, z. Zyrapi.

24 Ajo që thoni këtu është kështu:

25 "Unë personalisht nuk kisha kohë që të merresha me këtë

1 problem apo të hetoja çdo incident që kishte ndodhur më parë.”

2 Ju kujtohet që e keni thënë kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Kjo është e vërtetë, e saktë, apo jo?

5 PË. E saktë.

6 PY. Dhe diku më poshtë ju thoni se:

7 “Asokohe e kisha të vështirë -- ishte e vështirë”.

8 E keni fjalën për hetimet që mund të kryeni, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Ju shpjeguat vështirësitë që kishit për të hetuar
11 incidentet për të cilat jeni informuar. Ju i keni thënë
12 Prokurorisë që nuk e ke -- nuk ishte përgjegjësia juaj asokohe
13 për të hetuar, duke pasur parasysh edhe përgjigjet që keni
14 dhënë, apo jo?

15 PË. Çka e di -- e kam shpjegu edhe atë që nuk a kanë e
16 drejtorisë operative me hetue.

17 PY. Në rregull. Do të vijoj. Kemi kal -- po kalojmë tani më
18 datë 28 nëntor, kur ju thoni se keni lëshuar urdhrin. Në
19 Pjesën 4, faqe 15, ju keni thënë se i vizitonin vetë zonat,
20 merrnit ankesa lidhur me arrestime të civilëve. Po i kthehem
21 kësaj periudhe tani. Dhe thoni se këto ankesa nga zonat duhej
22 t'i ishin raportuar përm -- te komandanti Azem Sylja. Ju
23 kujtohet që keni thënë kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Pra ju po i merrnit këto ankesat nga zonat kur shkonit

1 nga vendi në vend, nga zona në zonë, apo jo? Po, po,
2 normalisht kjo i duhej të ishte komanduar komandantit Azem
3 Syla. E kam të saktë këtë?

4 PË. Po.

5 PY. Ju personalisht. Z. Zyrapi, nuk mund të kishit nga ta
6 dinit nëse komandantët e tonave ia raportnin këto ankesa
7 dikujt tjetër. Është kështu?

8 PË. Po, kështu është.

9 PY. Në Pjesën 4, faqe 19 të intervistës suaj me ZPS-në thoni
10 pastaj se keni raportuar këto shqetësime komandantit edhe
11 zëdhënësit. Ju kujtohet që keni thënë kështu?

12 PË. Po.

13 PY. A është e vërtetë që në nëntor të vitit 1998 keni qenë ju
14 që i e keni lëshuar këtë urdhër të 28 nëntorit të vitit 1998?

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Referenca është 1D00029.

16 PY. Dëshironi ta shikoni këtë dokument?

17 PË. Jo, s'ka nevojë ta shoh, por është -- unë e kam
18 nënshkruar atë dokument.

19 PY. Më 3 korrik i keni thënë Trupit Gjykues se ishte
20 komandanti i përgjithshëm Syla me të cilin jeni konsultuar, si
21 shef shtabi, përpara se të lëshonit këtë urdhër. Kështu është?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Dhe keni qenë shumë i qartë kur keni folur me Prokurorinë
24 se ishte -- se vetëm me komandantin e përgjithshëm jeni
25 konsultuar para se ta lëshonit atë dokument. Jo me Jakup

1 Krasniqin, apo jo?

2 PË. Po, shumë qartë kam thënë atë. Atëherë e tani po e them
3 të njëjtën.

4 PY. Faleminderit. Kalojmë tani te Pjesa 5 e intervistës suaj.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Pjesa 5, faqe 12, për
6 procesverbalin.

7 PY. Ku flitet për situatën e kolaboracionistëve. Keni dhënë
8 dëshmi edhe për këtë. Besoj se ju kujtohet, z. Zyrapi?

9 Në faqen 5 [Sipas përkthimit], faqe 12, ju thoni këtu se
10 keni diskutuar për këtë situatë me Azem Sylën, dhe pastaj ia
11 keni komunikuar urdhrin anëtarëve të tjerë të Shtabit të
12 Përgjithshëm në mbledhjen e nëntorit të 98 -- në një mbledhje
13 të nëntorit të vitit 1998. A është saktë kjo?

14 PË. Po, pasi u shkrua, domethënë, ky urdher, tani është kom -
15 - komunikuar edhe të tjerëve.

16 PY. Dhe e -- ju e keni thirrur atë mbledhje me këtë qëllim,
17 apo jo?

18 PË. Jo veç me këtë qëllim. Ka pasur edhe qëllime të tjera,
19 domethënë, të raportimit, por në to kanë qenë edhe këto. Por
20 më shumë kanë qenë edhe raportime të tjera.

21 PY. Prokuroria ju ka pyetur a u pajtuan të gjithë me ju apo
22 pati edhe kundërshtime në këtë mbledhje, dhe ju jeni
23 përgjigjur këtu:

24 "Nuk më kujtohet vërtetë kjo pjesë."

25 Thjesht dua që të sigurohet z. Zyrapi që pas 25 vjetësh

1 që është e vërtetë që ju nuk mund të jeni të sigurt se kush ka
2 qenë në atë mbledhje, kush është pajtu apo kush nuk është
3 pajtu me atë vendim, apo jo?

4 PË. Po, saktë.

5 PY. Edhe besoj se është e vërtetë që në mbledhje të tilla, jo
6 vetëm në atë mbledhje, ju ishit eksperti ushtarak
7 profesionist. Ju kishit formim dhe përvojë ushtarake në këto
8 mbledhje, apo jo?

9 PË. Po, nga aspekti ushtar, po.

10 PY. Dhe pasi jeni konsultuar me komandantin e përgjithshëm,
11 dhe tani jam në faqen 11, të Pjesës 5 të intervistës suaj, ju
12 keni thënë se pasi jeni konsultuar me komandantin e
13 përgjithshëm ju keni dhënë udhëzime se si do të duhej që të
14 zhvilloheshin gjërat më pas dhe se si duhej vepruar në të
15 ardhmen, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm në
18 përgjithësi mbështeteshin tek ju si profesionisti ushtar për
19 çështje të tilla, apo jo?

20 PË. Në aspektet ushtarake, po.

21 PY. Dhe pasi u lëshua ky urdhër ju vijoni këtu të thoni se
22 keni bërë disa takime pasuese me komandantët e zonave për të
23 shpjeguar këtë urdhër dhe për të diskutuar dhe për çështje të
24 tilla siç është nevoja e shtabeve, kërkesat e tyre dhe
25 organizimin e ushtrisë, kështu?

1 PË. Po, takimet kanë qenë masanej me komandantët e shtabeve -
2 - të zonave dhe këtu janë diskutuar dhe shumë kërkesa të
3 tjera, por ndër to ka qenë edhe kjo.

4 PY. Tani, më 3 korrik javën që shkoi, z. Misetic, ju tregoi
5 një dokument, marrëveshja midis FARK-ut dhe UÇK-së e
6 nënshkruar në emër të UÇK-së. Ju kujtohet ky dokument?

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po më mirë ta nxjerrim në
8 ekran. Është dokumenti me numër DHT03873 deri në 3877.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mund të sqaroj për
10 procesverbalin që ky dokument ka marrë një numër të provës
11 materiale 1D00166. Faleminderit shumë.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Referenca specifike është
14 DHT03876 në anglisht dhe në shqip është 061170, ju lutem.
15 Është faqja 34 [Sipas përkthimit] e versionit PDF. Faqja 4, jo
16 34 [Sipas përkthimit], ju kërkoj ndjesë.

17 PY. Ju kujtohet që jua kanë treguar këtë dokument z. Zyrapi?

18 PË. Po.

19 PY. Ky dokument tregon përbërjen e një strukture të re të
20 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për të cilën është rënë
21 dakord përmes këtyre bisedimeve, është kështu?

22 PË. Po, kështu është.

23 PY. Dhe sipas këtij dokumenti, propozohet Agim Çeku si
24 komandant; dy zëvendëskomandantë, Sokol Bashota dhe Ismet
25 Alija. Kështu është apo jo?

1 PË. Po, kështu është, saktë.

2 PY. Dhe Jakup -- dhe emri i Jakup Krasniqit nuk del në këtë
3 dokument, apo jo?

4 PË. Është saktë. Q'ashtu.

5 PY. Dhe duket se nuk ishte parashikuar asnjë rol për Jakup
6 Krasniqin në Shtabin e Përgjithshëm në tetor 1998. Është
7 kështu kjo?

8 PË. Me ndryshimet ato, bisedimet që ka qenë, po, por ai ka
9 pas veç rolin e vet atëhere si zëvendës në atë kohë [E
10 pakuptueshme].

11 PY. Po, ishte zëdhënësi asokohe. Dhe ai vijoi të ishte
12 zëdhënësi gjatë gjithë -- gjatë gjithë kohës, z. Zyrapi. Se më
13 duket se nuk doli përgjigja juaj. Mund ta përsërisni prapë
14 përgjigjen?

15 PË. Po. Në q'atë kohë, jo, nuk ka qenë si zëvendës.

16 PY. Dhe personi kryesor sipas këtij dokumenti që
17 konsiderohej, pra, që mendohej të ishte në postin e
18 zëvendëskomandantit ishte Sokol Bashota, apo jo?

19 PË. Po.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shoh se
21 sa ka shkuar ora.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë tani
23 një pushim pesë minuta, Dëshmitar. Jo, më falni, dhjetë
24 minuta.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
2 ndërprerjen e seancës për dhjetë minuta.

3 --- Pauza fillon në orën 15.29

4 --- Seanca rifillon në orën 15.40

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
6 sillni dëshmitarin në sallë, Sekretar.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
9 Alagendra, do vazhdoj me pyetjet e veta, z. Zyrapi.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

11 PY. Z. Zyrapi tani do të kalojmë, do t'ju bëj disa pyetje që
12 kanë të bëjnë me Azem Sylën. Në rregull?

13 Ju jeni takuar me Azen Sylën në Tiranë në pranverën e
14 vitit 1998 përpara sesa të shkonit në Kosovë, apo jo,
15 Dëshmitar?

16 PË. Po, saktë.

17 PY. Sipas Shënimit Përgatitor 2 të Prokurorisë, paragrafi 16
18 deri në 17, ju thoni që keni qenë jashtë Kosovë në periudhën e
19 shtatorit 1998 deri në nëntor të 1998. A është e vërtetë kjo,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Ju thoni se ndërkohë që keni qenë jashtë Kosove nuk keni
23 pas kontakt me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm brenda
24 Kosovës, përfshirë këtu dhe Jakup Krasniqin. A është e saktë
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Në paragrafin 17, te Shënimi Përgatitor numër 2 thuhet
3 dhe do lexoj:

4 "Për zhvillimet që kanë ndodhur në Kosovë në atë kohë,
5 burimi juaj i informacionit ka qenë Azem Syla."

6 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo është e paplotë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet mund
9 të vazhdoni, znj. Alagendra.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

11 PY. Tani në përgjigje të pyetjeve të z. Mistic më datë 4
12 korrik -- do përsëris dhe një herë pyetjen se nuk e kemi
13 përgjigjen që dhatë në procesverbal, ju kërkohet ndjesë z.
14 Zyrapi.

15 Atëherë për zhvillimet që po ndodhnin në Kosovë në atë
16 kohë burimi juaj i informacionit ishte Azem Syla. A është e
17 saktë kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Në përgjigje të pyetjes së z. Mistic më datë 4 korrik,
20 ju konfirmuat se si shef shtabi ju i keni raportuar Azem Sylës
21 dhe keni marrë udhëzime prej tij, a është e saktë kjo,
22 Dëshmitar?

23 PË. Përsëriteni pyetjen dhe një herë? Në cilën periudhë?

24 PY. E kam fjalën për periudhën kur keni qenë shef i shtabit
25 ju?

1 PË. Po.

2 PY. Gjatë asaj periudhe, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

3 Në përgjigje të pyetjes nga z. Mistic më datë 4 korrik
4 keni thënë që i keni raportu Azem Sylës dhe keni marrë
5 udhëzime prej tij. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po. Kjo e kam thënë në një pjesë.

7 PY. Në 2019 i keni thënë Prokurorisë se Azem Sylë ka qenë në
8 Kosovë në dhjetor të vitit 1998. A është e saktë kjo,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Përsëri ai ka qenë në Kosovë edhe në janar të 1999, aty
12 afër periudhës së masakrës së Reçakut, a është e saktë kjo,
13 Dëshmitar?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Azem Sylë ka qenë gjithashtu në Kosovë në shkurt të 1999
16 përpara negociatave në Rambuje, a është e saktë kjo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Në shkurt? Nuk e di. Nuk më kujtohet për në shkurt. Në
19 shkurt ka qenë mbas kur kanë ardhë nga Rambujeja, po. Po ma
20 herët nuk e di.

21 PY. Por ai është larguar nga Kosova për të marrë pjesë në
22 bisedimet e Rambujesë, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po kur kanë ardhë herën prej Rambujesë që kanë qenë kur
24 jemi taku me komandantët, po, pi atyjit ka shku, se kanë ardhë
25 së bashku me delegacionin dhe pi atyjit kanë fluturu kanë shku

1 tutje prej Kosovës. Po më herët nuk e di.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju kërkoja që të shikojmë
3 Pjesën 14 të intervistës së dhënë për ZPS-në, atëherë është
4 dokumenti 10355.14, në faqen 9.

5 PY. Mund t'jua lexoj, Dëshmitar, çfarë keni thënë. Ju kërkoj
6 ndjesë. Ajo çfarë thoni ju këtu është që:

7 "Ai u kthye përsëri në shkurt përpara se të fillonin
8 bisedat në Rambuje dhe pastaj ai shkoi në Rambuje dhe pastaj u
9 kthye, në mos gabohem nga fundi i shkurtit dhe më pas nuk u
10 kthye më."

11 Domethënë, ju flisni që ai ka ardhur përpara dhe pas. Ju
12 kujton ndonjë gjë kjo pjesë e deklaratës tuaj, Dëshmitar?

13 PË. Po. Unë them para ka qenë edhe janari.

14 PY. Në rregull. Tani do t'ju tregoj disa prej fotografive që
15 ju treguan edhe të martën, z. Zyrapi.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
17 paraqesë në ekran provën materiale P01402.

18 PY. Ju kujtohet që këtë fotografi ua treguan më herët dhe që
19 identifikove atje veten tënde së pari, z. Thaçi dhe pastaj z.
20 Selimi, ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, saktë. Po, saktë.

22 PY. Në rregull. Dëshmia juaj është që kjo fotografi është
23 bërë në qeverisjen e përkohshme në fshatin Fshati i Ri? A të
24 kujtohet që e ke thënë këtë, Dëshmitar?

25 PË. Po, e kam thënë në objektin në Fshatin e Ri.

1 PY. Faleminderit që më korrigjove. Pas tyre, domethënë, pas
2 personave që janë ulur a e shikoni një raft me libra,
3 Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Përpara librave, a e shikoni një aparat polaroid, që
6 është në mes të tavolinës, nuk e di e shikoni këtu, Dëshmitar?

7 PË. Jo.

8 PY. Janë këto fotografitë që janë tek rafti te librat,
9 Dëshmitar?

10 PË. A te librat, po. Po.

11 PY. Drejt të majtës së rafteve, domethënë, aty te librat që
12 janë të treguara.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani
14 të paraqesë dokumentin 1403.

15 PY. Edhe këtë fotografi jua treguan më herët dhe ti ke thënë
16 që kjo fotografi është bërë në të njëjtin vend si fotografia
17 më herët, a është saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po. Ashtu kam thënë sa më kujtohet.

19 PY. Shohim të njëjtin raft me libra në sfond, apo jo,
20 Dëshmitar? Pajtoheni me mua?

21 PY. Po, shofim libra të njëjtë.

22 PY. Dua që të jeni pak më konkret. Bëhet fjalë për të njëjtin
23 raft me libra siç jua tregova dhe në fotografinë e mëparshme?

24 Është i njëjti raft me libra, po apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po ai si më duket, po.

1 PY. Në rregull.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit
3 të paraqesë në ekran fotografinë 1404.

4 PY. Së pari, a ju kujtohet që jua kanë treguar këtë
5 fotografi, Dëshmitar?

6 PË. Po, po.

7 PY. Më 2 korrik ju keni identifikuar vendin ku është bërë kjo
8 fotografi dhe keni thënë që kjo është shtëpia e bardhë në
9 Divjakë. A ju kujtohet kjo? A pajtoheni që në këtë fotografi
10 shfaqet i njëjti raft librash me të njëjtin konfigurim
11 librash, a pajtoheni me mua, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Kur keni thënë që kjo fotografi është bërë në një vend
14 tjetër, mos ndoshta jeni gabuar?

15 PË. Pikë së parit, unë kur kam thënë që këto, unë kam thënë
16 përafërsisht që mund të jetë në këto vende, po s'kam thënë
17 sigurt që janë këto vende. Këtu që është e sigurtë, po ka
18 mundësi edhe atë.

19 PY. Në rregull. Domethënë, është e mundur që të keni bërë
20 gabim, kështu?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
22 përgjigjur dëshmitari. Prisni një çast, Avokate.

23 DËSHMITARI: Ka mundësi. Ka mundësi, unë e kam thënë edhe
24 atëherë kur e kam spjegue, kam thënë që mendoj që janë këto,
25 po jo 100 për qind i sigurt.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Sa për ta konfirmuar, asnjë nga fotografitë që unë sapo
3 ju tregova nuk ka një datë të stampuar diku, a është e saktë
4 kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. Pra, ju nuk do jeni në gjendje për të konfirmuar se kur
7 konkretisht janë bërë këto fotografi, a është e saktë kjo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Po, mesa më kujtohet kam thënë diku ka mujt me qenë ka
10 nëntori. Nëntori, dhjetori që janë bërë këto fotografi. Por
11 datën jo, nuk e kam cekë se nuk e di. Nuk muj me kanë i
12 sigurt.

13 PY. T'i kthehem përsëri dëshmisë tuaj që ristrukturimi i
14 Shtabit të Përgjithshëm ka filluar diku rreth 12 nëntorit të
15 1998. Është e saktë, apo jo, që pas kësaj periudhe Shtabi i
16 Përgjithshëm u stacionua në Divjakë?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Kjo do kishte qenë hera e parë kur Shtabi i Përgjithshëm
19 ishte i stacionuar në një vend fiks, kështu, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Përpara kësaj, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm gjatë
22 gjithë kohës ishin në lëvizje, për shkak të ofensivës serbe,
23 pasi ishte e pamundur që të kishit një shtab permanent apo
24 fiks apo të kishit një vend fiks ku të qëndronin, a është e
25 saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Kur keni mbërritur në Divjakë, nuk është se ka pas ndonjë
3 sistem administrate, apo jo, Dëshmitar?

4 PË. Po, s'ka pas kurrëgjë.

5 PY. Në nëntor të 1998, si rezultat i periudhës relativisht të
6 qetë, për shkak të marrëveshjes së pushimit të luftimeve,
7 Shtabi i Përgjithshëm kishte mundësi që të punonte lidhur me
8 organizimin e vet të brendshëm. A është e vërtetë kjo,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, e vërtetë.

11 PY. Me vijimin e këtij procesi gjithkush po bënte ç'mundej pa
12 pasur domosdoshmëri një ndarje të qartë të roleve dhe
13 përgjegjësi. A pajtoheni me këtë, dëshmitar?

14 PË. Po, deri në këtë moment po.

15 PY. Kur jeni intervistuar në vitin 2011, keni dhënë një
16 përshkrim të vendit në Divjakë, ky përshkrim i vendit që
17 përbëhej nga tre shtëpitë. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Keni thënë që ishte një shtëpi e bardhë ku qëndronte
20 Jakup Krasniqi së bashku me Ramë Bujën dhe z. Grabovci, me
21 Adem Grabovcin. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, është e vërtetë. Aty ka qenë në shtëpinë e bardhë,
23 domethënë, z. Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Adem Grabovci
24 nganjëherë dhe Sokol Dobruna.

25 PY. Në rregull. Pastaj ka pasur një tjetër ndërtesë ku keni

1 qëndruar ju së bashku me persona të tjerë të drejtorisë

2 operative, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po. Ndërtesa tjetër ka qenë ku kam qenë unë. Së bashku ka
4 qenë drejtoria operative edhe drejtoria e komunikimit ose
5 ndërlidhjes.

6 PY. Në atë ndërtesë, në atë godinë, përveç teje, ka qenë dhe
7 Naim Maloku, apo jo?

8 PË. Kur e ceka drejtori operative dhe Naim Maloku ka qenë në
9 drejtori operative. Z. Maloku, z. Sali Veseli dhe anëtarët e
10 tjerë të drejtorisë operative.

11 PY. A mund ta përsërisësh edhe një herë emrin e dytë se nuk e
12 kapi transkriptuesi, z. Zyrapi?

13 PË. Naim Maloku, Sali Veseli që ka qenë në drejtori
14 operative.

15 PY. Edhe Musë Jashari ka qenë anëtar i drejtorisë operative?

16 PË. Jo. Unë e ceka më herët drejtoria, ai Musë Jashari ka
17 qenë drejtor i drejtorisë së komunikimit, të ndërlidhjes dhe
18 unë kur e ceka në këtë objekt kam qenë unë, drejtoria
19 operative dhe drejtoria e komunikimit, Musë Jashari.

20 PY. Në rregull. Po ai ka qenë me ty në atë ndërtesë, kështu,
21 Dëshmitar?

22 PË. Po, po.

23 PY. Ka qenë dhe dikush që quhej Safet Syla, apo jo, në atë
24 ndërtesë ka qenë edhe ky personi me emrin Safet Syla, kështu,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po. Po, ka qenë.

2 PY. A ju kujtohet z. Zyrapi që në shtëpinë e bardhë ka pasur
3 një kompjuter dhe një printer?

4 PË. Po. Kompjuteri po.

5 PY. A ju kujtohet një person me emrin Ahmet Morina që të ketë
6 qenë në Divjakë në atë kohë?

7 PË. Po, s'ëm kujtohen emrat e tjerë. E di që kanë qenë plot.
8 Plot ka pas apo emrat bash emrat të gjithëve, jo.

9 PY. Nëse ju ndihmon për të kujtuar më mirë, ai është personi
10 që merrej me administratën, domethënë, ishte personi që
11 shtypte dokumente. Nuk e di, e bëni dot lidhjen se kush ka
12 qenë ky person? Është personi që kryesisht e përdorte
13 kompjuterin që ishte aty?

14 PË. Muj me kenë ajo punë. Po nuk po më vjen ndërmend. Me të
15 vërtetë me thënë të drejtën.

16 PY. Kishte edhe persona të tjerë të cilët shpesh dilnin e
17 hynin nga shtëpia e bardhë, a është e saktë kjo, dëshmitar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Mesa dini ju kompjuteri atje nuk është se kishte një
20 fjalëkyçe, fjalëkalim, apo jo?

21 PË. Më fal. Edhe një herë pyetjen? Për çka është puna?

22 PY. Domethënë, ideja është që nuk kishte një fjalëkalim për
23 të përdorur kompjuterin. Çdo kush që ulej aty, që donte ta
24 përdorte kompjuterin mund ta përdorte, a pajtoheni me mua
25 lidhur me këtë?

1 PË. Nuk e di. Nuk muj me dit me thënë as me thënë mundet a
2 s'mundet. Se nuk kam qenë aty afër me ditun se kush po e
3 përdorë dhe qysh po përdoret.

4 PY. Pra, nuk e dini ju konkretisht se kush ka përgatitur ose
5 kush ka shkruar çfarë dokumenti në atë kompjuter. Do ishte
6 përshkrim i saktë ky, Dëshmitar?

7 PË. Saktë.

8 PY. Por fillimisht anëtarë të drejtorisë operative dhe ata e
9 kanë përdorur këtë godinë, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Si mendoni e kanë përdorur këtë?

11 PY. Fillimisht po them që ka pas një periudhë në fillim fare
12 që ajo godinë ose ajo ndërtesë përdorej dhe nga personat e
13 drejtorisë operative, domethënë, që përdornin kompjuterin që
14 ishin te shtëpia e bardhë, e kam fjalën për shtëpinë e bardhë
15 që përdorej dhe nga persona që ishin të drejtorisë operative,
16 kështu?

17 PË. A të jemi më të kjartë, me qenë më kjartë për atë punë.
18 Thatë se kur po më qitni pyetjen, po mendoni objektin. Objekti
19 a diçka tjetër e tjetër është kompjuteri. Unë nuk e di. Ka
20 mundësi me u përdorë edhe pse do të --

21 PY. Jo, jo. Po flas për përdorimin e kompjuterit tani, për
22 kompjuterin konkretisht, për këtë e kam fjalën.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E morët
24 përgjigjen. Ju përgjigj dëshmitari pyetjes, Avokate.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

1 PY. Më vonë, drejtoria operative, tek shtëpia e dytë ku keni
2 qenë ju edhe aty ju kishit kompjuterin tuaj më vonë, a është e
3 saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Jo, nuk kam pas kompjuter unë. Unë kam pasun makinë të
5 shkrimit mekanike, të thjeshtë domethënë.

6 PY. Dhe kjo përdorej nga Safet Sylja, kështu?

7 PË. Ajo është tjetër, pjesa që u përdorte Safet Sylja është
8 mbasi i është dhënë, është gjetun kur ka qenë koha e
9 trajnimeve, derisa janë bë trajnimet dhe është përdorë ai edhe
10 kompjuter. Ai është më vonë. Domethënë, mund të them si kanë
11 fillu trajnimet e të mbahen si me oficerët e ndërlidhjes ashtu
12 edhe komandë, batalionet dhe tjerëve për atë kohë, po, q'atë
13 kohë ka qenë aty, po.

14 PY. A mund ta thoni se kur ka qenë kjo kohë, kjo periudhë,
15 Dëshmitar?

16 PË. Këto si kemi fillu trajnimet diku prej janarit, shkurtit,
17 në q'atë kohë ka pas kompjuter drejtoria e komunikimit që ka
18 mbajt edhe trajnimet, po që ka bë shënimin dhe dokumenteve të
19 veta që i ka prodhuar.

20 PY. A ishte dhe dikush me emrin Shqipe Ahmeti aty në atë
21 kohë, Dëshmitar?

22 PË. Po, Shqipe Ahmeti ka qenë në shtab.

23 PY. Do ishte e saktë të thuhet që Safet Sylja dhe Shqipe
24 Ahmeti ishin personat që e kanë përdorur këtë kompjuter, siç
25 edhe kompjuterin e mëparshëm që përmendëm në periudhën e janar

1 edhe shkurt të 1999, a është e saktë të thuhet kjo, Dëshmitar?
2 PË. Po. Në shkurt, në janar, shkurt në kohën e trajnimeve po.
3 PY. A është e mundur, z. Zyrapi, që përpara janarit apo
4 shkurtit të 1999, që kompjuteri në shtëpinë e bardhë të jetë
5 përdorur gjithashtu edhe nga persona nga drejtoria operative,
6 në qoftë se ata do të kishin pasur ndonjë dokument për të
7 printuar?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është spekulative. Është pyetje
9 që u bë dhe e mori përgjigjen më përpara.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
11 kundërshtimi.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

13 PY. Do e bëj ndryshe pyetjen. Z. Zyrapi, a jeni në dijeni të
14 dokumenteve që duhej që të printoheshin dhe të shkruheshin në
15 kompjuterë, domethënë, së pari të shkruheshin në kompjuter
16 pastaj të printoheshin në periudhën përpara janarit dhe
17 shkurtit të 1999 nga drejtoria operative? A jeni në dijeni,
18 keni dijeni lidhur me këtë temë?

19 PË. Po, është një kohë kur është bërë ristrukturimi, kur kemi
20 bë përkthimet e detyrave dhe përgjegjësive të drejtorive, po,
21 se s'ka pas kompjuter tjetër, kam pas edhe makinën e shtypit
22 për q'atë është përdorë edhe nganjëherë edhe atje që të
23 shtypen ato për mujt me ju shpërnda drejtorive. Është e
24 kjartë.

25 PY. A kishit dijeni nëse aso kohe përdreshin *floppy disks*?

1 Po kaloj tani periudhën janar, shkurt, ishte e mundshme që të
2 përdorej *floppy disks* për të transferuar informacion midis
3 kompjuterëve, kompjuterit që ishte në drejtori edhe në
4 shtëpinë e bardhë? Mund të ketë ndodhur, apo jo?

5 PË. Jo, nuk e di këtë. Nuk kam dijeni në të.

6 PY. Ju kujtohet dikush me emrin, që aty ka qenë dikush emrin
7 Isa Krasniqi?

8 PË. Po.

9 PY. Ishte nga Kosova Press --

10 PË. Radio Kosova e Lirë ose Kosova Press.

11 PY. Dhe shpesh ndodhej në Divjakë, apo jo?

12 PË. Po, shpesh e kam pa.

13 PY. Edhe ai e kishte mundësinë që ta përdorte atë kompjuter
14 dhe e ka përdorur, apo jo?

15 PË. Nuk e di atë. Nuk është e imja të ruaj kompjuterin kush
16 ta përdorë.

17 PY. Po, e kuptueshme. Ditën e martë të javës që shkoi - dhe
18 është transkripti i 2 korrikut, faqja 17460 - Prokurorisë i
19 thatë se keni rihyrë në Kosovë në nëntor të 1998 dhe keni
20 sjellë me vete edhe një sërë vulash të cilat ju i kishit bërë
21 në Shqipëri. Ju kujtohet kjo?

22 PË. Po. Kur kam ardhun kemi pas do vula që janë bë atje në
23 Shqipëri, që nuk kanë qenë më herët, për shembull, drejtorive
24 të Shtabit të Përgjithshëm.

25 PY. Dhe sipas jush ju kishit vulën e shtabit, të drejtorive,

1 të zonave dhe të drejtorisë operative, kështu?

2 PË. Sa më kujtohet kur kemi hy kemi pas do, po cilat kanë
3 qenë krejt nuk më kujtohet tash.

4 PY. Po shoh përgjigjen tuaj të 2 korrikut, pikërisht tani. Të
5 martën e javës që shkoi. Kështu thatë atë dite gjithsesi.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të nxjerrim në ekran
7 dokumentin P000622. Ju lutem të kaloni në pjesën e poshtme,
8 aty ku duket nënshkrimi dhe vula, ju lutem. Faqja tjetër, ju
9 lutem.

10 PY. Jua kanë treguar këtë dokument të martën që shkoi dhe ju
11 konfirmuat se është një urdhër që ju e keni nënshkruar dhe aty
12 është vula e Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

13 PË. Po, saktë.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, nxirrni në ekran
15 tani P631, ju lutem. Ju lutem në fund të faqes ose në faqen
16 tjetër -- jo është në pjesët e poshtme të faqes.

17 PY. Edhe kjo është nënshkrimi juaj, z. Zyrapi dhe vula është
18 ajo e Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Tani do të kaloj tek deklarata juaj e vitit 2019.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është faqja e tretë e Pjesës
22 6.

23 PY. I keni thënë Prokurorisë në vitin 2019 dhe po citoj se:

24 "Nuk e kisha vulën e Shtabit të Përgjithshëm. Vulën e
25 mbante komandanti dhe zëvendëskomandanti."

1 A është e mundshme që të keni bërë një gabim këtu kur i
2 keni thënë këto fjalë në vitin 2019, z. Zyrapi?

3 PË. Jo, aspak. Është saktë qysh e kam thënë unë.

4 PY. Po ne shohim dokumente që janë nënshkruar dhe janë
5 vulosur me vulën e Shtabit të Përgjithshëm nga ju, z. Zyrapi.
6 Prandaj dhe pyetja që unë kam është kjo: Kur thatë që nuk e
7 kishit vulën e Shtabit të Përgjithshëm, mbase ka qenë gabim?
8 Është e mundshme?

9 PË. Jo, jo, nuk është gabim. Shumë mirë e kam thënë. Është
10 vula e Shtabit të Përgjithshëm e nënshkrume. Kthema pak faqen
11 e parë. Kthema faqen e parë të këtij dokumenti? Shikoni nalt
12 protokollin 105/111, është protokollin i komandantit të shtabit
13 ose zëvendësit. Këto urdhrat për të shkuar për me i marrë
14 zonat, u dasht të shkohet përmes, domethënë, në koordinim me
15 komandantin ose zëvendësin. Për q'atë vuloset me vulën e
16 Shtabit të Përgjithshëm me u vulos dhe është protokolu me
17 protokollin e Shtabit të Përgjithshëm. Po të siç kanë vetëm
18 për mu ose veç unë me e bërë e kisha pas --

19 PY. Po. Faleminderit për sqarimin.

20 PË. Po, të lutem.

21 PY. Faleminderit për sqarimin. Por ju e kishit mundësinë që
22 ta përdornit këtë vulë siç e tregojnë këto dy dokumente që
23 sapo jua treguam, apo jo?

24 PË. Vetëm atëherë kur u dasht të shkohet urdhri nëpër zonat
25 kur ishte në koordinim me komandantin ose me zëvendësin. Po.

1 PY. Jo, pyetja ime është shumë e thjeshtë, z. Zyrapi. Kemi
2 parë këto dy dokumente. Ju i keni nënshkruar. Ju i keni vendos
3 vulën e Shtabit të Përgjithshëm. Pra, do të thotë që e kishit
4 që kishit qasje në vulën e Shtabit të Përgjithshëm. E thënë
5 shumë thjeshtë, apo jo?

6 PË. Të kesh qasje është diçka tjetër, por kur është në
7 bashkëpunim me zëvendësin dhe me komandantin unë normalisht që
8 vulolet dhe e ai e vulos, nuk e kam vulos unë. Edhe është e
9 saktë që, po, është përdorë për këto punë dhe shumë mirë e
10 shpjegova se pse është përdorë.

11 PY. Gjatë seancës përgatitore ju kanë treguar disa dokumente
12 të cilat ju i keni identifikuar se janë nënshkruar nga Jakup
13 Krasniqi. Ju kujtohen këto, z. Zyrapi?

14 PË. Po, m'i kanë treguar disa dokumente.

15 PY. E di që përgjigja është e qartë, por besoj që edhe ju do
16 të pajtoheshit me mua nëse unë do të thosha që ju nuk jeni
17 ekspert për shkrimin e dorës? Për të njohur, pra, për të
18 njohur shkrimin e dorës të personave?

19 PË. Është e saktë. Nuk jam ekspert për atë punë.

20 PY. Ju sapo na e thatë se ju dhe z. Krasniqi ndodheshit në
21 godina të ndryshme dhe ju nuk mund të shikonit se çfarë
22 ndodhte në godinën tjetër, kështu?

23 PË. Po mund t'i shikoj të gjitha çka ndodhin. Ajo është e
24 saktë.

25 PY. Po. Disa prej këtyre dokumenteve na keni thënë se i keni

1 parë për herë të parë këtu dhe jua ka treguar Prokuroria,
2 kështu?

3 PË. Po, ka. Është e vërtetë.

4 PY. Pra, a do të ishte e saktë, nëse do të thosha se këtu i
5 keni parë për herë të parë, keni parë nënshkrimin, keni
6 identifikuar se ishte i Jakup Krasniqit, por ju vetë fizikisht
7 nuk keni qenë i pranishëm kur këto dokumente të jenë
8 nënshkruar?

9 PË. Unë s'kam thënë asnjëherë që kam qenë prezent kur janë
10 nënshkruar dokumente të tillë. Është e vërtetë ajo punë.

11 PY. Absolutisht. Thjesht po e konfirmoj këtë gjë, z. Zyrapi.
12 Kur ju e identifikuat nënshkrimin e Jakup Krasniqit në
13 dokumentet të cilat Prokuroria jua tregoi këtë e bëtë thjesht
14 nga që patë emrin të shtypur aty me Jakup Krasniqi apo nga që
15 nënshkrimi qartë shkruante Jakup Krasniqi. Kështu është?

16 PË. Pikë së pari, nënshkrimin e njof se veç këto dokumente po
17 dhe shumë dokumente tjera që unë i kam pas edhe, për shembull,
18 dhe lëvizja e lirë e identifikimit ka qenë nënshkrimi i Jakup
19 Krasniqit që ka qenë për mua për me lëvizë në zona për muj me
20 u identifikue. Edhe nënshkrimi është shumë i kjartë dhe unë e
21 njoh nënshkrimin e z. Jakup Krasniqit në atë kohë. Dhe kështu
22 që unë e identifikoj simbas nënshkrimit që e njoh në atë kohë.
23 Kjo është për çka kam identifikue dhe e kam thënë.

24 PY. Ju thoni që e njihni shumë mirë nënshkrimin e z.
25 Krasniqi, kështu?

1 PË. Po, folëm për atë kohë e kam njoh shumë mirë se e kam
2 pasur edhe në dokumentin që e kam mbajtur çdoherë pranë vetit
3 duke pas nënshkrimin e tij.

4 PY. Thjesht për kureshtje, ky dokument për liri lëvizje nuk
5 është se jua treguam bashkë me këto dokumentet e tjera që të
6 krahasoni nënshkrimin? Thjesht për ta ditur. Se ju po
7 mbështeteni në një dokument që është nënshkruar për liri
8 lëvizjeje. Jua dhanë edhe këtë dokument së bashku me
9 dokumentet e tjera për të bërë një krahasim me nënshkrimet e
10 z. Krasniqi në momentin që Prokuroria jua tregojë këtë
11 dokument?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari e
13 ka dhënë përgjigjen.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
15 kundërshtimi juaj.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, kalojmë tani tek
17 dokumenti SPOE00225249, kërkoj që të paraqitet në ekran, ju
18 lutem.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për
20 procesverbalin, ky dokument është caktuar numri i provës
21 materiale me numër P00626. Faleminderit.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem kaloni
23 në pjesën e poshtme.

24 PY. Gjatë seancës përgatitore, z. Zyrapi, jua kanë treguar
25 këtë dokument dhe ju e identifikuat se ky është nënshkrimi i

1 z. Jakup Krasniqi, kështu është?

2 PË. Po.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të nxjerrim në ekran
4 tani dokumentin me numër P11175, ju lutem. Për këtë qëllim të
5 jenë versioni shqip i të dyja dokumenteve krah për krah. Pra,
6 dokumenti tjetër është P11175 bashkë me dokumentin P626, ju
7 lutem. Ju lutem, të shohim nënshkrimin.

8 PY. Pyetja ime është shumë e thjeshtë, z. Zyrapi. Mund t'ju
9 përgjigjeni me po ose me jo. A është e vërtetë që këto dy
10 nënshkrime në këto dy dokumente janë të ndryshme?

11 PË. Po, këtu po shifën që janë të ndryshme.

12 PY. Dëshiroj të kaloj tani në periudhën e ristrukturimit.

13 Periudha e 12 nëntorit të 1998.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund t'i heqim këto dokumente
15 nga ekrani. Faleminderit.

16 PY. Ju keni dhënë dëshmi, z. Zyrapi, ditën e hënë se procesi
17 i ristrukturimit ka filluar më datë 12 nëntor të vitit 1998
18 dhe ka vazhduar gjatë gjithë dhjetorit, janarit dhe shkurtit,
19 por nuk arriti të përfundonte kurrë. Ju kujtohet që keni thënë
20 kështu?

21 PË. Po, saktë.

22 PY. Dhe është e vërtetë që do t'i duhej kohë Shtabit të
23 Përgjithshëm që të ishte një entitet funksional, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe kur ju keni hyrë në Shtabin e Përgjithshëm në vitin

1 1998, qershor 1998, ju ishit i vetmi anëtar me përvojë të
2 mëparshme ushtarake në atë shtab. A është e vërtetë kjo?

3 PË. Po, unë dhe Agim Qelaj.

4 PY. Po. Që të kemi datën, Agim Qelaj është vrarë në korrik të
5 1998, kështu është?

6 PË. Po.

7 PY. Kur Shtabi i Përgjithshëm është ristrukturuar në nëntor
8 të 1998, sërish ju ishit i vetmi profesionist ushtarak në atë
9 shtab, a është kështu?

10 PË. Jo veç unë, po kam pastaj Sali Veselin, Naim Malokun, e
11 tjerët, si po folim si profesionist ushtarakë.

12 PY. Atëherë të jem më specifik. Që përveç jush dhe oficerëve
13 në drejtorinë operative, ju ishit, më saktë, profesionistët
14 ushtarakë në drejtorinë operative, oficerët e karrierës, e kam
15 të saktë?

16 PË. Po, saktë.

17 PY. Dëshiroj që të fillojmë tani me Azem sylën, komandantin e
18 përgjithshëm, ai nuk kishte ndonjë formim ushtarak, apo jo?

19 PË. Po, saktë, nuk ka pasur.

20 PY. Sokol Bashota, zëvendëskomandant për operacionet, as ai
21 nuk kishte formim ushtarak?

22 PË. Jo.

23 PY. Dhe z. Thaçi?

24 PË. Jo.

25 PY. Nuk ishte oficer i stërvitur, apo jo?

- 1 PË. Jo.
- 2 PY. Ishte student para lufte, apo jo?
- 3 PË. Po.
- 4 PY. Jakup Krasniqi, as ai nuk kishte njohuri ushtarake se
5 ishte arsimtar, apo jo?
- 6 PË. Po, e saktë.
- 7 PY. Dhe z. Rexhep Selimi edhe ai nuk kishte formim ushtarak,
8 apo jo?
- 9 PË. Po, ashtu është.
- 10 PY. Edhe ai ishte student para lufte, apo jo?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Sokol Dobruna ju na thatë se ishte jurist me profesion,
13 por nuk kishte formim ushtarak, kështu?
- 14 PË. Po, kështu është.
- 15 PY. Dhe pa i marrë të gjithë një për një, unë thjeshtë ceka
16 disa emra: Adem Grabovci, Kadri Veseli, Xhavit Haliti, Ramë
17 Buja, as ata nuk kishin përvojë ushtarake, apo jo?
- 18 PË. Po, saktë është.
- 19 PY. Fatmir Limaj, Lahi Brahimaj, Pal Luzha dhe Ahmet Alaqi
20 nuk ishin oficerë me formim ushtarak, apo jo, nuk kishin
21 përvojë ushtarake?
- 22 PË. Nuk kanë qenë oficerë karriere, jo.
- 23 PY. Dhe është e vërtetë se asnjë prej këtyre individëve nuk
24 kishin as përvojën, as kualifikimet për të mbajtur ndonjërin
25 prej këtyre posteve po të ishte një ushtri e rregullt, apo jo?

1 PË. Po të ishte një ushtri e rregullt, sigurisht që jo.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë do të
3 kaloj tani në një pjesë tjetër. Po mbase duhet të vijojmë
4 nesër?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Dëshmitar, do t'ju lejojmë të largoheni tani. Do të
7 ritakohemi nesër në orën 9.00. Do të zhvillojmë vetëm një
8 seancë me ju nesër, do të përfundoni deri në orën 11.00 nesër.

9 Ju lutem mos harroni të mos flisni me askënd për dëshminë
10 tuaj këtu brenda kësaj salle që keni dhënë këtu në këtë sallë
11 sot. Nëse dikush ju afrohet për të folur me këtë, na informoni
12 menjëherë.

13 Tani mund të dilni nga salla e gjyqit.

14 Falënderoj edhe Avokatin Kujdestar.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
18 Smith. Kam një pyetje për Avokaten Mbrojtëse të Krasniqit.

19 Znj. Alagendra, kompjuteri që u tregua sot në provat
20 materiale P1402, 3 dhe 5, duket se është shumë e rëndësishme
21 për provat që ju dëshironi të paraqitni. Ju lutem mund ta
22 ndihmoni Trupin Gjykses të kuptojë rëndësinë e këtij
23 kompjuteri në veçanti për provat tuaja dhe kjo vlen edhe për
24 kundërshtimin e vazhdueshëm lidhur me këtë zyrë, pra dhe me
25 lidhjen e mundshme midis të dyjave, pra, me këtë kompjuter dhe

1 tjetrin.

2 Ju lutem na e shpjegoni mbase jo sot por nesër lidhur me
3 këtë.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Patjetër. Nesër që në fillim
5 në mëngjes.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Emerson po.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, desha që të them diçka për
10 procesverbalin. Kam nja dy pika të shkurtra për të ngritur në
11 fund të pyetjeve që do bëjë znj. Alagendra përpara pyetjeve
12 plotësuese nga pala që ka thirrur dëshmitarin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se ju
14 deshët të flisnit për këtë në fund të ditës sot?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Kërkoj ndjesë është diçka e
16 cila ka dalë sot.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. I nderuar
18 Gjykatës, sot ka lëshuar një urdhër gojarisht lidhur me dy
19 parashtrime të protokolluara më përpara që janë 2279 dhe 2312.
20 Është e drejtë se këto janë që të dyja këto janë kërkuar nga
21 Mbrojtja e jonë dhe Mbrojtja e Selimit lidhur me caktimin e
22 një seance dëgjimore për këto argumente. Arsyeja pse e
23 kërkojmë këtë seancë dëgjimore është këto dy çështje, sipas
24 mendimit tonë, kërkojnë një trajtim sekuencial.

25 Sipas parashtrimit tonë, mocioni që ky Trup Gjykses duhet

1 të japë, prej të cilit ky Trupi Gjykses duhet të japë mendim
2 dhe duhet të vendosë është një mocion nga ZPS-ja për të
3 ndryshuar listën e provave materiale. Nëse ZPS-së i përmbushet
4 kjo kërkesë, atëherë lindin dhe probleme të tjera.

5 Nëse ZPS-së nuk i miratohet ky mocion atëherë asnjë pikë
6 tjetër nuk lind. Atëhere edhe këto pika, këto probleme lindin
7 vetëm nëse i miratohet kërkesa ZPS-së. Nëse ky material
8 lejohet që të shtohet në listën e provave materiale, atëherë
9 janë çështjet e pranueshmërisë dhe/ose jo të përjashtimit të
10 cilat lindin.

11 Prandaj ne parashtrojmë që është e parakohshme në këtë
12 moment që të ketë një mocion sipas rregullës 138 nga ana e
13 Mbrojtjes për të kërkuar përjashtimin e materialit që ende nuk
14 është pranuar në listën e provave materiale.

15 I nderuar Gjykatës, sot në mëngjes tha që nëse Mbrojtja
16 dëshiron që të shtojë parashtrime duke pasur parasysh këtë
17 vendim të Panelit të Gjykatës së Apelit, këtë ta bëjë deri të
18 martën. Prandaj dua që të sqarojmë se çfarë kishte parasysh
19 Trupi Gjykses për cilat parashtrime lidhur me ndryshimet të
20 cilat do jenë të lejueshme në këtë fazë. Kjo është thjesht në
21 përgjigje të kërkesës të ndryshuar në listën e provave
22 materiale. Ne parashtrojmë se kjo është një çështje që ende
23 nuk ka marrë zgjidhje hë për hë, prandaj dhe Trupi Gjykses nuk
24 mund të sjellë paraprakisht në kohë pikërisht këtë parashtrim
25 nga ana e Mbrojtjes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
2 ne thjesht po kërkojmë që nëse dikush dëshiron që t'i
3 përgjigjet mocionit të tyre për të pranuar këto prova, këtë ta
4 bëjë sipas afateve. Vetëm kaq.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkëlqyeshëm. Faleminderit.
6 Thjesht nga që Mbrojtja e Thaçit ka një mocion më vete lidhur
7 me përjashtime dhe kjo u përmend gjithashtu nga Trupi Gjykses
8 dhe për këtë e kemi fjalën edhe ne.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju mund të
10 parashtoni një argument edhe për këtë nëse dëshironi, por nuk
11 jeni i detyruar.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Desha të informoj Trupin Gjykses që
14 kemi pasur një diskutim para disa muajsh ose para disa javësh
15 apo para disa muajsh sa i takon qasjes nga Mbrojtja e
16 Krasniqit për një sërë parashtimesh të protokolluara mbi të
17 cilat mbështeten këto pika.

18 Thjesht desha ta informoj Trupin Gjykses që ne kemi bërë
19 një kërkesë pas këtij shkëmbimi me të nderuarin Gjykatës
20 Mettraux, dhe besoj që duke filluar nga dita e hënë do të
21 fillojmë që të marrim disa parashtime të protokolluara, nja
22 78 parashtime të tilla të protokolluara. Sigurisht, deri të
23 martën, ne nuk mund të bëjmë parashtimin e kërkuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne thjesht
25 duam të dimë se cili është qëndrimi i të gjithëve sa i takon

1 kërkesës për pranimin e një grupi provash materiale,
2 përfshihen apo jo. Për këtë do marrim vendim.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Në këtë fazë ato nuk janë kërkuar
4 ende që të pranohen në provat materiale. Është thjesht që
5 shtohen në listën e provave materiale.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë, shumë
7 e qartë. Nuk e di se pse duhet ta bëjmë kaq të komplikuar.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është më
9 shumë një kureshtje, është diçka e cila ka të bëjë me atë se
10 çfarë do të ndodhë javët e ardhshme dhe pas pushimit të
11 drekës. Pra, kjo kërkon një përgjigje nga Prokuroria lidhur me
12 këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse mund të
14 përgjigjeni?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Desha që të them nuk ka asnjë
16 ndryshim sa u takon -- do të doja fillimisht të dija nëse ka
17 apo jo ndonjë ndryshim nga çmuarjet kohore të Mbrojtjes së
18 Krasniqit në fillim, pastaj mund të përgjigjemi.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Siç e thamë të nderuar
20 Gjykatës neve do të përdorim të gjithë seancën nesër, që janë
21 dy orë. Dhe mund t'i kthehemi dhe çmuarjes së mëparshme duke
22 pasur parasysh edhe vëllimin e konsiderueshëm të materialeve
23 që është përdorur me këtë dëshmitar. Kështu që mund të
24 vazhdojmë dhe javën tjetër, pra, të hënën me shumë gjasë.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pra, në bazë të kësaj Dëshmitari

1 4260 është një dëshmitar që kërkon shumë pak kohë, po ai
2 s'është i disponueshëm javën e ardhshme. Dy dëshmitarët të
3 cilët janë të disponueshëm në bazë të këtyre çmuarjeve nuk
4 mendojmë se mund të përfundojnë brenda ditës. Dhe plus që kemi
5 vënë re që për të martën pas dreke është paracaktuar dhe
6 mbajtja e seancës për shqiptimin e aktgjykimit në çështjen
7 Shala.

8 Fillimisht ne kishim menduar që mund të fillonim me këtë
9 dëshmitar të martën mbas dreke pastaj përfundonim, po duke
10 pasur parasysh që nuk do të ndodhë kështu, atëherë propozimi
11 është që të mos thërrasim një dëshmitar të dytë javën e
12 ardhshme duke pasur parasysh dhe seancat.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ajo që dua të
14 them është që të martën na është hequr kjo seancë e fundit për
15 shkak të shqiptimit të vendimit në një çështje tjetër, nuk
16 kemi ç'bëjmë për këtë.

17 Sqaron kjo?

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, e qartë. Për javën e ardhshme.
19 Po besoj për javën e fundit do të doja që të dinim -- a javën
20 që shkoi kemi kërkuar informacion edhe për dëshmitarët që do
21 të vijnë pas pushimit të verës. Dhe znj. Lawson, një koleg i
22 znj. Lawson ka sugjeruar se deri këtë të mërkurë do të kemi
23 ndonjë informacion. Do të donim të dinim shumë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase nesër
25 mund ta marrim këtë informacion.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do ta dërgoj me email pas kësaj
2 seance. Thjesht na duhej të merrnim vesh se çdo të ndodhte
3 javën e ardhshme para se të jepnim një përgjigje, por do ta
4 japim përgjigjen për bllokun e ardhshëm me email sonte në
5 mbrëmje. Dhe pastaj do të bëjmë parashtrimin e protokolluar
6 normal për këtë tre mujorin javën e ardhshme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një gjë
8 tjetër sa i takon çështjes së dokumentit udhërrëfyes. Pra, ju
9 keni dy mundësi. Ose që të çlironi të gjithë dokumentin për
10 Mbrojtjen ose mund të redaktoni disa pika? Sa kohë ju duhet
11 për redaktimet nëse do të duhet?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, kemi marrë udhëzimet e Trupit
13 Gjykues me email. Do të ketë një parashtrim të protokolluar
14 brenda afatit që u përcaktua me email që më duket se ishte
15 data 15.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të kemi
17 diçka para datës, pra, deri në datë 15, do marrim dhe vendim
18 me shpresë që të ketë efekt para pushimit.

19 --- Seanca mbyllet në orën 16.36

20

21

22

23

24

25